



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

ANALIZA VJETORE 2019





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mars 2020

©Agjencia e Prokurimit Publik

Agjencia e Prokurimit Publik



PËRMBAJTJA

SHKURTIME	5
PËRKUFIZIME	6
1. HYRJE	7
1.1. QËLLIMI I VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK	7
2. TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI	9
2.1. STATISTIKA NË LIDHJE ME REGJISTRAT E PARASHIKIMEVE TË KRIJUARA NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK PËR VITIN 2019	10
2.1. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK TË SHPALLURA GJATË VITIT 2019	13
2.3. STATISTIKA PËR PROCEDURAT KONKURRUESE TË PROKURIMIT, TË ZHVILLUARA NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK	14
2.3.3. STATISTIKA SIPAS NJOFTIMEVE TË FITUESIT	21
2.3.4. STATISTIKA PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA	24
2.3.5. STATISTIKA MBI PËRQINDJEN E KURSYER NGA PROCEDURAT E KRYERA NË SISTEMIN ELEKTRONIK	27
2.3.6. PROCEDURA KONKURRUESE MBI 800.000 LEKË TË ANULLUARA GJATË VITIT 2019	28
2.4. TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT ME NEGOCIM PA SHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS	31
2.5. MARRËVESHJET KUADËR	38
2.6. PROCEDURAT E PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL	42
2.7. STATISTIKA NË LIDHJE ME PROCEDURAT E KRIJUARA NË SISTEMIN ELEKTRONIK	45
2.8. SISTEMI DINAMIK BLERJE BILETA TRANSPORTI AJROR NDËRKOMBËTAR	46
2.9. STATISTIKA NË LIDHJE ME AUTORITETET KONTRAKTORE QË KANË KRIJUAR PROCEDURA NË SISTEMIN ELEKTRONIK	47
2.10. STATISTIKA NË LIDHJE ME OFERTAT E DORËZUARA NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK	48
2.11. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME KONCESION/PPP GJATË VITIT 2019	52
2.12. STATISTIKA NË LIDHJE ME PROCEDURAT E ANKANDIT PUBLIK TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2019	53
3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2018	54
3.1. NDRYSHIMET LEGJISLATIVE	54
3.1.1. HARTIMI I PROJEKTLIGJIT "PËR PROKURIMIN PUBLIK"	54
3.1.2. NDRYSHIME NË DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT	55
3.1.3. UDHËZIME, REKOMANDIME DHE NJOFTIME TË APP	56
4. TREGUES TË VEPRIMTARISË KËSHILLUESE DHE PËRFAQËSUESE TË APP GJATË VITIT 2018	59
4.1. PRAKTIKAT E SHQYRTUARA PËR DHËNIE MENDIMESH, KËSHILLA APO UDHËZIMESH	59
4.2. SHQYRTIMI I RASTEVE PËR PËRJASHTIMIN E OPERATORËVE EKONOMIKË	61
5. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË VERIFIKIMIT TË PROCEDURAVE	65
5.1. VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË	65
5.2. SHQYRTIMI I RAPORTEVE TË ORGANEVE AUDITUESE	68
5.3. GJETJET DHE PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA GJATË PROCESIT TË VERIFIKIMIT	69
5.4. MASAT ADMINISTRATIVE DHE RAPORTIMI	74
5.4.1. MASAT ADMINISTRATIVE	74
5.4.2. RAPORTIMI I MASAVE	76



6. PUBLIKIMI I VENDIMMARRJES	78
7. PËRFAQËSIMI I APP NË PROCESET GJYQËSORE	79
8. TREGUESIT E VEPRIMTARISË KOORDINUESE DHE ASISTUESE TË APP DHE MONITORIMIT TË KONTRATAVE	83
8.1. VEPRIMTARIA KOORDINUESE DHE ASISTUESE	83
8.2. TË DHËNA MBI ZBATIMIN E KONTRATAVE	86
8.2.1. MONITORIME NË KUADËR TË TASK FORCËS ANTIKORRUPSION	89
9. INTEGRIMI EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE TË TJERA	90
9.1. INTEGRIMI EUROPIAN	90
9.2. BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË HUAJA	92
9.3. BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË TJERA NË SHQIPËRI	93
10. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE DHE PUBLIKIMIN	95
10.1. VEPRIMTARIA E PUBLIKIMIT	95
10.2. ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK	96
10.2.1. OBJEKTIVAT E SEKTORIT TË ADMINISTRIMIT TË DHËNAVE DHE STATISTIKAVE	96
10.2.2. GARANTIMI I ECURISË SË PUNËS PËR TË GJITHË PËRDORUESIT E SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK (SPE) DHE SISTEMIT TË ARKIVËS ELEKTRONIKE SAE).	98
10.2.3. DHËNIA E ASISTENCËS TEKNIKE BRENDA DHE JASHTË APP	98
10.2.4. KRIJIMI I PËRDORUESVE TË RINJ PËR VITIN 2019	100
10.2.5. STATISTIKA TË TJERA NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK	102
10.2.5.1. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE	102
10.2.5.2. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS 24 ORËVE.	104
10.2.5.3. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS DITËVE TË JAVËS.	105
10.2.5.4. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS MUAJVE TË VITIT.	106
10.2.5.5. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS NDËRFAQEVE MË TË KLIKUARA NË PORTALIN E APP.	107
10.2.5.6. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS FJALËVE KYC MË TË PËRDORURA PËR KËRKIMIN E PORTALIT TË APP.	108
10.2.5.7. AKSESIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK SIPAS SHFLETUESVE DHE SISTEMEVE OPERATIVE.	109
10.2.5.8. AKSESIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK SIPAS SISTEMEVE OPERATIVE DHE LLOJIT TË PAJISJEVEMË TË PËRDORURA NGA PËRDORUESIT	111
10.2.5.9. PËRDORIMI I APLIKACIONIT MOBILE	114
11. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS	114
11.1. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	114
11.2. AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR KONFLIKTIN E INTERESIT	114
11.3. KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT	114
11.4. AKTIVITETET NË DREJTIM TË FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË STAFIT TË APP DHE SPECIALISTËVE TË PROKURIMIT PUBLIK PRANË AUTORITETEVE KONTRAKTORE	115
11.4.1. PJESËMARRJA NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE	115
11.4.2. TRAJNIMET E PUNONJËSVE TË PROKURIMEVE PRANË AUTORITETEVE KONTRAKTORE	116
11.5. GJENDJA FINANCIARE E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2019	117



SHKURTIME

AK - Autoritet Kontraktor

APP - Agjencia e Prokurimit Publik

ASPA - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

ATRAKO - Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

BB - Banka Botërore

BNJP - Buletini i Njoftimeve Publike

BOE – Bashkim i Operatorëve Ekonomikë

OE - Operator Ekonomik

ILDKPKI - Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit

KVO - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

KPA - Kodi i Procedurave Administrative

KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit

KM - Këshilli i Ministrave

KPP - Komisioni i Prokurimit Publik

LAP - Ligji për Ankandin Publik

LPP - Ligji i Prokurimit Publik

MK-Marrëveshje Kuadër

NJP- Njësi Prokurimi

OQB - Organi Qendror Blerës

PBB- Produkt i Brendshëm Bruto

PPP - Partneriteti Publik Privat

QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit

SA - Strategjia Antikorrupsion.

SAE - Sistemi i Arkivës Elektronike

SMFP - Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike

SPE- Sistemi i Prokurimit Elektronik



PËRKUFIZIME:

Në funksion të interpretimit të kësaj analize, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

Fondi limit i prokuruar - Vlera pa TVSH, që përllogaritet nga autoriteti kontraktor në çastin e publikimit të njoftimit të kontratës ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një publikim i tillë.

Vlera e fituar – Vlera e ofertës së shpallur fituese.

Fond i kursyer - Diferenca midis fondit limit të prokuruar dhe vlerës së fituar

Procedurë elektronike - Procedurë prokurimi e zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik.

Procedurë konkurruese- Procedurë prokurimi e zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, pas publikimit të njoftimit të kontratës.

Procedurë prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës – Lloj procedure e cila zhvillohet në rrugë elektronike dhe përdoret në rrethana të vecanta të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik.

Shtesë kontrate me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës- Lloj procedure prokurimi, me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, bazuar mbi një kontratë ekzistuese të lidhur nëpërmjet një procedure të mëparshme prokurimi konkurruese, që përdoret për plotësimin e nevojave në fillim të çdo viti, deri sa të kryhen procedura normale prokurimi, në një vlerë deri në 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare.

Procedura të reja me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës – Procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, që ndiqen nga Autoriteti Kontraktor në një nga situatat e parashikuara nga LPP, përveç rasteve të shtesave të kontratave.

Procedura të papërfunduara (anulluara) - Procedura prokurimi që nuk janë finalizuar me njoftim fituesi

Prokurime elektronike - Procedurat e prokurimit që zhvillohen nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Pezullim - Ndërprerje e zhvillimit të procedurës së prokurimit në rastet kur ka ankesa në Autoritetin Kontraktor apo në Komisionin e Prokurimit Publik.

Asistim/koordinim- Proces i zhvilluar në kuadër të dhënies së asistencës autoriteteve kontraktore, të cilat ndërmarrin një procedurë prokurimi, sa i takon hartimit të dokumentave të tenderit.

Verifikim- Proces i zhvilluar pas përfundimit të procedurës së prokurimit me finalizimin e një kontrate për të verifikuar nëse procedura e prokurimit e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor është kryer në përputhje me parashikimet ligjore.

Monitorim kontrate- Procesi i monitorimit të implementimit të kontratës së nënshkruar nga ana e autoriteteve kontraktore nëpërmjet raporteve të dërguara nga ana e tyre.



1. HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim “APP”) dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2019 deri në 31 Dhjetor 2019.

APP e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9874/2008 “Për anandin publik”, i ndryshuar.

Struktura dhe organika e institucionit është miratuar me Urdhrin Nr. 54, datë 15.03.2019 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”.

Raporti paraqet në mënyrë të detajuar edhe të dhëna statistikore në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi, përfshirë sistemin elektronik të prokurimit.

1.1. QËLLIMI I VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

Agjencia e Prokurimit Publik ka si qëllim kryesor të veprimtarisë së saj, garantimin e mirëfunksionimit të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, duke u fokusuar në drejtimit e mëposhtme:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit rregullator;
- Monitorimi i vazhdueshëm i procedurave të prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktore;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i Sistemit Elektronik të Prokurimit;
- Ngritja e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit në Autoritetet Kontraktore;
- Dhënia e asistencës së vazhdueshme për Autoritetet Kontraktore;
- Rritja e efikasitetit të prokurimit publik.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2019, APP ka vijuar punën intensive për implementimin e reformave për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, veçanërisht sa i takon:

- rritjes së transparencës dhe reduktimit të procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje para-prake të njoftimit të kontratës. Kështu, gjatë vitit 2019 numri i këtyre lloj procedurave është ulur ndjeshëm, nga 9.4% të procedurave të fituara në vitin 2018, në 3.2 %;
- asistencës së vazhdueshme për autoritetet kontraktore, ku përveç udhëzimeve dhe rekomandimeve të përgjithshme për mirëzbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, në fokus ka qenë edhe asistimi lidhur me përgatitjen e dokumentave të tenderit;
- identifikimit të problematikave, nëpërmjet verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit, pas fazës së nënshkrimit të kontratës, si një ndër shtyllat kryesore të veprimtarisë së APP;
- mbledhjes së të dhënave mbi ecurinë e zbatimit të kontratave, nëpërmjet raportimit të autoriteteve kontraktore, me qëllim identifikimin e problematikave që hasen gjatë fazës së zbatimit të kontratës, si një fazë e rëndësishme përmbyllëse e gjithë procesit të prokurimit.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, APP ka nxjerrë në mënyrë të vazhdueshme rekomandime të ndryshme drejtuar AK-ve me qëllim zbatimin në mënyrën e duhur të legjislacionit të prokurimit, si dhe ka punuar për hartimin e akteve të reja ligjore dhe dokumentave të tjerë strategjikë, si më poshtë:

1. Është punuar intensivisht dhe ka përfunduar hartimi i projektligjit të ri për prokurimin publik. Ky projektligj është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me SIGMA/OECD dhe transponon direktivat e BE-së në fushën e prokurimit, konkretisht (i) direktivën 2014/24 për prokurimet klasike (ii) direktivën 2014/25 për prokurimet në sektorët utilitarë dhe (iii) direktivat për rishikimin.



Projektligji i ri sjell një sërë risish në këtë fushë, ndër të cilat theksohen, përcaktimi i kriterëve për prokurim të qendrueshëm, rregulla të posaçme për prokurimet e shërbimeve sociale, përdorimi i kriterit të vlerësimit oferta ekonomisht më e favorshme, rregullimi i pavleshmërisë së kontratave dhe dëmshpërblimeve, vendosja e një mekanizmi për menaxhimin e implementimit të kontratave publike që aktualisht mungon, etj. Projektligji është në fazën e konsultimit publik.

2. APP ka punuar, gjithashtu, për hartimin e një strategjie të dedikuar për prokurimin publik, e cila përcakton objektivat kryesore në drejtim të përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në vend, përfshirë koncesionet dhe PPP-të, prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, blerjen e përqendruar dhe rishikimin e ankesave.
3. Është finalizuar projektligji për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ky projektligj është shumë i rëndësishëm, duke patur parasysh që aktualisht kjo fushë rregullohet vetëm me akte nënligjore. Pritet që projektligji të dërgohet në KM për miratim.
4. APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me OSBE për hartimin e një plani për profesionalizimin e prokurimit publik, proces mjaft i rëndësishëm, i cili synon forcimin e kapaciteteve administrative dhe rritjen e performancës në prokurim.



2. TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI

Prokurimi publik është një nga fushat kryesore të veprimtarisë shtetërore dhe një nga proceset më të rëndësishme në menaxhimin e financave publike. Sikundër tregohet edhe nga shifrat dhe të dhënat e përpunuara në këtë kuadër, fondi buxhetor i shpenzuar për prokurime publike në vendet e rajonit për vitin 2018 shkon mesatarisht nga 8-10% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Konkretisht sikundër paraqitet edhe në Grafikon nr. 1 më poshtë, sipas të dhënave të publikuara rezulton se:

- 1- **Kosova:** Sipas raportit të Komisionit European, në vitin 2018, Prokurimi Publik arriti në 9.6% të PBB, me një vlerë prej 631.6 Milionë Euro.¹
- 2- **Serbia:** Sipas raportit të Komisionit European, në vitin 2018, Prokurimi Publik arriti në rreth 8% të PBB, duke pësuar një rritje të lehtë nga përqindja e vitit 2017, kur Prokurimi Publik zinte 7.7% të PBB.²
- 3- **Mali i Zi:** Sipas raportit të Komisionit European, bazuar në ta dhëna paraprake, në vitin 2018, Prokurimi Publik zë 9.1% të PBB, krahasuar me 10% dhe 11.8% në 2 vitet e mëparshme.³
- 4- **Maqedonia e Veriut:** Sipas raportit të Komisionit European, në vitin 2018, Prokurimi Publik, përfaqëson 9% të PBB⁴
- 5- **Shqipëria:** Sipas raportit vjetor të vitit 2018, publikuar nga APP, prokurimi publik për vitin 2018 zinte rreth 7.8% të PBB.⁵

Grafiku 1



Burimi: Të dhëna të marra nga Raportet e Komisionit European për vendet e Rajonit

Ndërkohë, nga përpunimi i të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe bazuar në të dhënat e siguruar nga INSTAT dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë⁶ mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), rezulton se, për vitin 2019 fondi total limit i prokuruar zë 6.5% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).

1 European Commission (2019), Kosovo Report, pg. 64

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

2 European Commission (2019), Serbia Report, pg. 59

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-serbia-report.pdf>

3 European Commission (2019), Montenegro Report, pg. 59

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-montenegro-report.pdf>

4 European Commission (2019), North Macedonia Report, pg. 61

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>

5 Analiza vjetore 2018, APP, pg. 10

6 Sipas parashikimeve zyrtare paraprake për 2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

(<http://www.financa.gov.al/buxheti-2020/>), Produkti i Brendshëm Bruto për vitin 2019 është: 1,705,246,000,000




Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin të dhënat në lidhje me raportin fond total limit i prokuruar-PBB:

Tabela 1

Treguesi makroekonomik	Vlera (në miliardë Lekë)
PBB- Produkti Brendshëm Bruto	1,705,246,000,000
Fondi total limit i publikuar në Republikën e Shqipërisë	110,664,365,109
Fondi total limit i publikuar në Republikën e Shqipërisë në raport me PBB (në %)	6.5%

Grafiku 2



2.1. STATISTIKA NË LIDHJE ME REGJISTRAT E PARASHIKIMEVE TË KRIJUARA NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK PËR VITIN 2019

Që prej Janarit 2018, Regjistrat e Parashikimeve dhe Realizimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik përgatiten elektronikisht dhe publikohen në sistemin e prokurimit elektronik. Automatizimi i këtyre dy regjistrave ka pasur një rëndësi shumë të madhe për rritjen e përgjegjësisë së Autoriteteve Kontraktore në planifikimin e nevojave që do të prokurojnë gjatë vitit në vijim, si dhe operatorët ekonomikë arrijnë që në kohë reale të kenë informacion mbi të gjitha procedurat dhe fondet publike që do të prokurohen gjatë vitit, duke rritur në mënyrë të dukshme transparencën në lidhje me përdorimin dhe mirëmenaxhimin e fondeve publike.

Gjithashtu, APP arrin të identifikojë të dhënat për prokurimet e planifikuara për t'u kryer nga autoritetet kontraktore në kohë reale. Nga të dhënat e Regjistrat Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit për vitin 2019, rezulton se janë miratuar dhe publikuar rreth 38 732 elementë të regjistrave për parashikimin e prokurimeve dhe ndryshimet në regjister të kryera gjatë vitit nga autoritetet kontraktore.

Konkretisht, detajimi i elementëve në Regjistrin Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit është si më poshtë :



Tabela 2


Tipi i Kontratës	Lloji i procedurës së prokurimit	2019
Punë	Kontrata mbi 800.000 lekë	1963
	Prokurim me vlerë të vogël	791
	Negociim, pa njoftim	44
Mallra	Kontrata mbi 800.000	3610
	Prokurim me vlerë të vogël	9479
	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	6561
	Amendament për nevojat e fillim vitit	47
	Negociim, pa njoftim	53
Shërbime	Kontrata mbi 800.000	2707
	Prokurim me vlerë të vogël	6554
	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	6385
	Amendament për nevojat e fillim vitit	46
	Sistem Dinamik Blerje Bileta	355
	Negociim, pa njoftim	137
Totali Elementë të regjistrit të publikuar		38732

Nga monitorimi i përgatitjes së Elementeve të Regjistrit të Parashikimeve dhe Realizimeve në SPE në periudhën Janar – Dhjetor 2019, rezulton se për periudhën Janar – Dhjetor 2019, janë 38732 elemente të parashikuara në Rregjistrë dhe të publikuara, nga të cilat 5843 janë elemente të anuluar.

Formë grafike, të dhënat paraqiten si më poshtë vijon:

Grafiku 3

Numri i elementëve në Regjistrin Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit





Nga Elementet e parashikuara në Regjistrë, të cilët nuk janë anuluar nga autoritetet kontraktore është ky detajim (32889 elementë të pa anuluar):

- 20270 janë elemente parashikuara në Regjister që janë realizuar apo përfunduar me kontrata,
- 8040 janë elemente të parashikuara në rregjister, që janë në proces realizimi apo publikuar,
- 4579 janë elemente të parashikuara në rregjister, që janë të pa realizuara apo kaluar afati.

Nga elementet e parashikuara në regjister **që nuk janë anuluar**, të cilat janë realizuar apo janë në proces realizimi rezulton se, 6193 janë elemente të modifikuara apo ndryshuar.

Formë tabelore, të dhënat paraqiten si me poshtë vijon:

Tabela 3

Elementet e Regjistrave te parashikuara periudha Janar – Dhjetor 2019	
Elementë në Regjistrë të realizuara	20270
Elementë në Regjistrë në proces realizimi	8040
Elementë në Regjistrë të pa realizuara apo kaluar afati	4579
Elementë në Regjistrë të anuluar	5843
Elemente të Regjistrit të ndryshuara	6193

Ndryshimet në rregjistrin e parashikimeve, që konceptohet si Performanca e Rregjistrit të Parashikimeve, të shprehura në përqindje si raport i elementëve **të ndryshuara ndaj totalit të** elementëve me statusin të realizuara dhe në proces realizimi ($6193/38,732 \times 100$), paraqiten në masen 15,9 %.


Tabela 4

Performanca e Rregjistrave te Parashikimit	
	Numri Elemente
Total Numri i elementeve të Rregjistrave të Parashikimit	38,732
Numri i elementeve të Rregjistrave të Parashikimit të Ndryshuara	6,193
Performanca ose % e elementeve të Ndryshuara ($6193/28310 \times 100$)	15.9%

Sic vërehet me lart, rreth 84.1% e elementeve që janë Elemente të Regjistrit të miratuara (të parashikuara e të realizuara, si dhe në proces realizimi) janë pa ndryshime.

Në diagramën e mëposhtme paraqitet performance e elementeve të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2019:

Grafiku 4





2.1. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK TË SHPALLURA GJATË VITIT 2019

Në këtë seksion paraqiten të dhënat e detajuara, lidhur me procedurat e prokurimit, përfshirë procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe procedurat me vlerë të vogël, të zhvilluara në Republikën e Shqipërisë, gjatë vitit 2019.

Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat kryesore për prokurimin elektronik dhe procedurat negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, si dhe raportet në përqindje dhe fondi i kursyer në total, për vitin 2019, paraqiten si më poshtë:

Tabela 5

Procedura konkurruese dhe Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit për Periudhën Janar - Dhjetor 2019	
Numri Total i Procedurave/lotet të publikuara konkurruese	7384
Fondi total limit i për procedurat/lotet e publikuara konkurruese (vlera në lekë pa TVSH)	110,664,365,109
Numri Total i procedurave/lotet të cilat kanë vazhduar	5216
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të cilat kanë vazhduar (vlera në lekë pa TVSH)	92,191,716,425
Numri Total i Procedurave/lotet të fituara konkurruese	5703
Fondi total limit i prokuruar i procedurave/lotet të fituara konkurruese (vlera në lekë pa TVSH)	87,958,991,776
Vlera totale e fituar e procedurave/lotet të fituara konkurruese (vlera në lekë pa TVSH)	80,122,989,108
Numri Total i Procedurave me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	192
Fondi total limit i prokuruar për procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (vlera në lekë pa TVSH)	2,338,820,945
Vlera totale e fituar për procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (vlera në lekë pa TVSH)	2,280,708,225
% që zë nr i procedurave me negociim pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara (konkurruese + negociim pa shpallje)	3.2%
% që zë fondi limit i prokuruar për procedurat me negociim pa shpallje ndaj fondit total limit të prokuruar për procedurat e fituara (konkurruese + negociim pa shpallje)	2.6%
% që zë vlera e fituar për procedurat me negociim pa shpallje ndaj vlerës totale të fituar për procedurat e fituara (konkurruese + negociim pa shpallje)	2.8%
Numri Total i Procedurave/lotet të fituara (konkurruese + negociim pa shpallje)	5895
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të fituara/lotet (konkurruese + negociim pa shpallje) vlera në lekë pa TVSH	90,297,812,721
Vlera totale e fituar i procedurave/lotet të fituara (konkurruese + negociim pa shpallje) vlera në lekë pa TVSH	82,403,697,333
% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të prokuruar	91.3%
Vlera totale e kursyer në lekë pa TVSH	7,894,115,388
% që zë Vlera totale e Kursyer ndaj Fondit total limit të prokuruar	8.7%



Sikurse vërehet nga tabela e mësipërme, numri total i procedurave konkurruese të shpallura në sistemin elektronik të prokurimit për vitin 2019 është **7,384**.

Gjithashtu, nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave që kanë përfunduar me njoftim fituesi në sistem për vitin 2019 është 5703, ndërsa numri i procedurave të shpallura të vijuara për vitin 2019 është 5216. Kjo diferencë mes numrit të procedurave të shpallura që kanë vijuar (5216) me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistem (5703), shpjegohet me faktin se në fund të vitit 2018 janë publikuar një numër i lartë procedurash, të cilat janë finalizuar me fitues në vitin 2019, konkretisht **487** procedura prokurimi.

Sa i takon numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për vitin 2019 janë zhvilluar gjithsej 192 të tilla, të cilat përbëjnë **3,2%** të numrit total të procedurave të fituara (konkuruese+negocime pa shpallje).

Gjithsesi, sikundër rezulton edhe nga Tabela nr. 2, fondi limit i prokuruar me këtë lloj procedure (2,338,820,945 lekë) është shumë më i ulët, krahasuar me fondin limit total të publikuar në procedurat elektronike konkurruese (110,664,365,109 lekë).

Sa i takon, raportit të mësipërm në vlerë, procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës zenë **2,8% të fondit total** për procedurat e fituara (konkuruese+negocim pa shpallje).

Në vijim, paraqiten të dhënat e detajuara lidhur me procedurat e prokurimit, përfshirë të dhënat mbi shtesat e kontratave të nënshkruara nëpërmjet përdorimit të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe raportin e tyre me numrin total të procedurave të fituara.

2.3. STATISTIKA PËR PROCEDURAT KONKURRUESE TË PROKURIMIT, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik

Në këtë pjesë të analizës vjetore, do të pasqyrohen dhe interpretohen të dhënat mbi numrin e procedurave të prokurimit publik mbi vlerën 800.000 mijë lekë, të cilat janë shpallur për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik.

Gjithashtu, në këtë pjesë do të pasqyrohen të dhënat respektive për numrin e njoftimeve të fituesve dhe numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

**2.3.1. Statistika sipas Tipit të kontratës**

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2019 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratës, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP është 7.384 (1.016 më pak se në vitin 2018). Konkretisht, numri i procedurave sipas kontratave paraqitet si më poshtë:

Tabela 6

Njoftime Procedurash Viti 2019					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Proce- durës	Numri i njofti- meve proce- durave	Lloji i Proce- durës	Numri i njofti- meve proce- durave	Lloji i Proce- durës	Numri i njofti- meve proce- durave
Shërbim Kon- sulence dhe Konkurs Projek- timi	93	Shërbim Kon- sulence dhe Konkurs Projek- timi	-	Shërbim Kon- sulence dhe Konkurs Projek- timi	-
E hapur Ndër- kombëtar	14	E hapur Ndër- kombëtar	33	E hapur Ndër- kombëtar	-
Procedure e hapur lokal	698	Procedure e hapur lokal	1,558	Procedure e hapur lokal	528
Kërkesë për Propozim	1,305	Kërkesë për Propozim	2,473	Kërkesë për Propozim	680
E kufizuar Lokal	-	E kufizuar Lokal	1	E kufizuar Lokal	-
E kufizuar Nder- kombetar	-	E kufizuar Nderkombetar	1	E kufizuar Nderkombetar	-
TOTALI	2,110	TOTALI	4,066	TOTALI	1,208



Ndërkohë, numri i procedurave sipas tipit të kontratës për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018 paraqitet si më poshtë:

Tabela 7

Publikime Procedura Konkurruese Janar -Dhjetor sipas Tipit të kontratës		
Viti	2018	2019
Shërbime	2,542	2,110
Mallra	4,475	4,066
Punë	1,383	1,208
Numri Total i Procedurave	8,400	7,384
Vlera totale Fondi limit	129,819,994,300	110,664,365,109

Siç vërehet nga të dhënat e përpunuara, numri i procedurave të shpallura është 12,1% më i vogël se në vitin 2018. Gjithashtu, për vitin 2019 numrin më të madh të procedurave të shpallura e zënë procedurat për prokurimin e mallrave me 4066 procedura të shpallura në total ose 55.1% të procedurave të shpallura (409 më pak se në vitin 2018), duke vijuar me procedurat për prokurimin e shërbimeve 2110 (432 më pak se në vitin 2018) dhe të punëve civile 1208 (175 më pak se në 2018).

Shpallja në vitin 2019 të një numri më të vogël procedurash se në vitin 2018, shpjegohet me faktin se në fund të vitit 2018 janë publikuar një numër i lartë procedurash, ku përmendim se vetëm në muajin dhjetor janë publikuar 1196 procedura, nga të cilat shumica prej tyre janë finalizuar me fitues dhe me kontrata të nënshkruara në vitin 2019.

Vlen të theksohet se, në evidentimin e këtyre numrave ndikojnë disa faktorë, të tillë si:

- Rekomandimi i autoriteteve kontraktore për fillimin e menjëhershëm në fund të vitit 2018 të procedurave të prokurimit për objektet (mall/punë/shërbim) të parashikuara për vitin 2019, përsa kohë që fondet i kanë të parashikuara dhe në çdo rast brenda kufirit buxhetor për vitin 2019, kjo me qëllim edhe të rritjes së performancës së menaxhimit të fondeve nga autoritetet kontraktore, si dhe mirëfunksionimin në tërësi të sistemit të prokurimit publik. Efektet pozitive të këtij rekomandimi u reflektuan në numrin më të lartë të procedurave konkurruese të përfunduara me fitues gjatë vitit 2019, krahasuar me një vit më parë.
- Rekomandimi i autoriteteve kontraktore për përdorimin e “Marrëveshjes Kuadër” me afate kohore 1 ose 2 vjeçare, për kategori mallrash dhe shërbimesh të zakonshme me natyrë të përsëritur, duke siguruar mbulimin e nevojave të vazhdueshme gjatë gjithë kohës për autoritetet. Vlen të theksohet fakti se, janë finalizuar numër i konsiderueshëm Marrëveshjes Kuadër të cilat, janë shpallur në vitin 2018 dhe kanë mbuluar nevojat e AK-ve në vijim. Efektet pozitive të këtij rekomandimi, u reflektuan në numrin shumë më të ulët të procedurave me negociim pa shpallje të zhvilluara nga AK gjatë vitit 2019, krahasuar jo vetëm me një vit më parë, por me gjithë dhjetëvjeçarin e fundit.
- Informatizimi i regjistrit të parashikimeve, ku autoritetet kanë detyrimin që në elementët përkatës të parashikojnë kohën e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e këtij planifikimi, duke shmanjur ndryshimet e shpeshta në regjistrë.

**2.3.2. Statistika sipas llojit të procedurave**

Në formë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2019, dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Tabela 8

Numri total i procedurave të shpallura të ndarë sipas llojit të procedurave për Periudhën Janar - Dhjetor 2019	
Numri Total i Procedurave të shpallura	7,384
Fondi total limit i procedurave të shpallura (vlera në lekë pa TVSH)	110,664,365,109
Numri i procedurave Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi	93
Fondi limit i procedurat Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi (vlera në lekë)	1,231,302,997
Numri i procedurave E hapur ndërkombëtare	47
Fondi limiti procedurat E hapura ndërkombëtare (vlera në lekë)	12,791,070,118
Numri i procedurave E hapur lokal	2,784
Fondi limit i procedurave E hapur lokale (vlera në lekë)	82,703,647,164
Numri i procedurave Kërkesë për propozim	4,458
Fondi limit i procedurave Kërkesë për propozim (vlera në lekë)	11,038,980,409
Numri i procedurave I kufizuar Lokal	1
Fondi limit i procedurave I kufizuar Lokal (vlera në lekë)	81,016,850
Numri i procedurave I kufizuar Nderkombetar	1
Fondi limit i procedurave I kufizuar Nderkombetar (vlera në lekë)	2,800,347,570



Tabela 9

Statistika Publikime Procedura Prokurimi te vazhduara sipas 3 mujoreve Viti 2019

Nr.	Emertimi	Nr. Proce- dura / Lote Publikuara	Fondi limit Leke pa TVSH	% Numrit te proce- durave/ loteve te 3 mujorit ndaj totalit	% e Fondit Lim- it te 3 mujorit ndaj totalit
1	Publikime Procedura Prokurimi ne SPE 3 mu- jori I-re viti 2019	1945	27,155,038,466	37,3%	29,5%
2	Publikime Procedura Prokurimi ne SPE 3 mu- jori II-te viti 2019	1650	26,900,268,264	31,7%	29,2%
3	Publikime Procedura Prokurimi ne SPE 3 mu- jori III-te viti 2019	816	23,134,751,076	15,6%	25,1%
4	Publikime Procedura Prokurimi ne SPE 3 mu- jori IV-te viti 2019	805	15,001,658,619	15,4%	16,2%
5	TOTALI	5216	92,191,716,425	100%	100%

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, në tremujorin e I-rë dhe të II-të kemi numrin më të madh të procedurave të shpallura dhe te vazhduara që zënë 69 % të totalit. Po kështu edhe fondi limit i procedurave të shpallura e te vazhduara në tremujorin e I-rë dhe të II-të ka zënë 58,7 % të totalit, ç'ka tregon një trend pozitiv të realizimit të procedurave të prokurimit publik.

Grafiku 5






Megjithëse grafiku i mësipërm është tregues i faktit që përqindja më e madhe e procedurave zhvillohet në 6 mujorin e parë të vitit, AK duhet të ndërgjegjësohen akoma më shumë për të rritur ndjeshëm përqindjen e procedurave që zhvillohen në 3 mujorin e parë të vitit. Për këtë kërkohet një koordinim më i mirë dhe me procesin e buxhetimit dhe detajimit të fondeve, kryesisht sa i përket investimeve publike.

Grafiku i mëposhtëm paraqet, përqindjen e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2019:

Grafiku 6



Sa i takon llojit të procedurave të zhvilluara për vitin 2019, sikundër vërehet të dhënat e mësipërme numrin më të madh të procedurave e zë procedura “kërkesë për propozim” me 4458 procedura të shpallura ose 60,4% të numrit total të procedurave të shpallura.

Më poshtë paraqitet shpallja e procedurave të prokurimit për vitin 2019 sipas llojit të procedurës krahasuar vitin 2018.

Tabela 10

Publikime Procedura Konkurruese Janar -Dhjetor, sipas llojit të procedurës së prokurimit		
Viti	2018	2019
I Hapur Lokal	3651	2784
Kërkesë për Propozim	4508	4458
Shërbim Konsulence	226	93
I Hapur Nderkombetar (mbi Kufi)	15	47
I kufizuar Lokal	-	1
I kufizuar Nderkombetar	-	1
Numri I Procedurave	8400	7384
Vlera totale Fondi limit	129,819,994,300	110,646,365,109


Ajo që vërehet nga të dhënat e kësaj table, është fakti se për vitin 2019 rezultojnë të shpallura një numër më i madh i procedurave “I Hapur Ndërkombetar” (47 procedura), që janë në numër më të madh se procedurat “I Hapur Ndërkombetar” (15 procedura) të shpallura në vitin 2018.

Kjo rritje e numrit të procedurave “I Hapur Ndërkombetar” vjen si pasojë e përdorimit të “Marrëveshjes Kuadër” me afate kohore disa vjecare, e cila për shkak të fondit limit për mbulimin e nevojave të vazhdueshme për të gjitha vitet e MK, detyron autoritetet të zhvillojnë procedurën konkurruese “I Hapur Ndërkombetar”.



Në grafikun e më poshtëm, paraqiten me grafik numri i procedurave të publikuara në mënyrë krahasimore sipas llojit të procedurës, respektivisht në vitin 2018 dhe 2019.

Grafiku 7



Në tabelën e mëposhtme paraqitet vlerat e fondit limit për procedurat e shpallura në vitin 2019 krahasuar me vlerat e fondit limit për procedurat e shpallura në vitin 2018.

Tabela 11


Vlerat e fondit limit, sipas Llojit të Procedura Konkurruese Janar -Dhjetor		
Viti	2018	2019
I Hapur Lokal	106,464,677,794	82,703,647,164
Kërkesë për Propozim	12,003,189,179	11,038,980,409
Shërbim Konsulencë	2,573,195,311	1,231,302,997
I Hapur mbi Kufi	8,778,932,016	12,791,070,118
I kufizuar Lokal	-	81,016,850
I kufizuar Nderkombetar	-	2,800,347,570
Vlera totale Fondi limit	129,819,994,300	110,646,365,109

Nga analiza e vlerave krahasuese të paraqitura në tabelën nr. 10, vërehet se ka një rënie të vlerës së prokuruar në vitin 2019, krahasuar me atë të prokuruar në vitin 2018. Duhet theksuar se kjo ulje e vlerës së prokuruar shpjegohet me rritjen e ndjeshme të numrit të Marrëveshjeve Kuadër, më shumë se 1 vjeçare, që do të thotë se një pjesë e fondeve publike të kontraktuara gjatë vitit 2019, janë prokuruar me Marrëveshje Kuadër që në vitin 2018.



Në grafikun e më poshtëm, paraqiten numri i procedurave të publikuara në mënyrë krahasimore dhe vlerat e fondit limit, respektivisht për vitin 2018 dhe 2019.

Grafiku 8



2.3.3. STATISTIKA SIPAS NJOFTIMEVE TË FITUESIT

Numri total i njoftimeve të fituesit të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2019 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratave, shërbim, mall, punë, është 5703 (587 më shumë se në vitin 2018). Kjo rritje finalizimi të procedurave me njoftim fituesi tregon efektet pozitive që kanë sjellë masat e ndërmarra nga APP, veçanërisht rekomandimet për fillimin e menjëhershëm të procedurave të prokurimit për objektet (mall/punë/shërbim) të parashikuara për vitin 2019.

Në formë tabelore, të dhënat për procedurat e prokurimit elektronik, të ndara sipas tipit të kontratës të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2019 janë si më poshtë:

Tabela 12

Njoftime Fituesi-Viti 2019					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të Fituesit	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të Fituesit	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të Fituesit
Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	98	Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	-	Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	-
E hapur Ndërkombëtar	3	E hapur Ndërkombëtar	23	E hapur Ndërkombëtar	-
Procedure e hapur lokal	465	Procedure e hapur lokal	1,250	Procedure e hapur lokal	512
Kërkesë për Propozim	1,043	Kërkesë për Propozim	1,738	Kërkesë për Propozim	571
TOTALI	1,609	TOTALI	3,011	TOTALI	1,083



Ndërkohë, njoftimet e fituesit sipas llojit të procedurës, fondit limit të prokuruar dhe vlerës së fituar për procedurat e vitit 2019 paraqiten si më poshtë:

Tabela 13


Të dhëna për procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues Viti 2019						
Llojet e procedurave	Numri Total i Procedurave	Fondi limit total i publikuar (vlera në Lekë)	Vlera totale e ofruar (Fituar) (vlera në Lekë)	% që ze fondi i ofruar ndaj fondit limit të publikuar	Fondi total i kursyer (vlera në Lekë)	% që ze fondi i kursyer ndaj fondit limit të publikuar
I Hapur Lokal	2,227	71,488,533,298	64,675,561,654	90,5%	6,812,971,644	9,5%
Kërkesë për Propozim	3,352	8,885,981,773	8,056,211,490	90,7%	829,770,283	9,3%
Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	98	792,554,697	762,874,274	96,3%	29,680,423	3,7%
E hapur Ndërkombëtar	26	6,791,922,008	6,628,341,690	97,6%	163,580,318	2,4%
TOTAL	5,703	87,958,991,776	80,122,989,108	91,1%	7,836,002,668	8,9%

Sikundër vërehet nga të dhënat e mësipërme përqindja më e lartë e kursimit të fondit limit të publikuar, është tek procedura “I Hapur Lokal”, që zë edhe vlerën më të madhe për procedurat e zhvilluara këtë vit.

Lidhur me përqindjen “në dukje të ulët” të kursimit të fondit limit të evidentuar tek procedura “I Hapur Nderkombëtar”, sqarojmë se në këtë lloj procedure është përdorur kryesisht “Marrëveshja Kuadër”, ku Vlera totale e ofruar (Fituar) për efekte statistikore përlllogaritet e njëjtë me Fondin limit total të publikuar, për arsye se “Marrëveshjet Kuadër” shoqërohen me një numër të madh minikontratash sipas nevojave të autoriteteve kontraktore për një periudhë kohore 1 ose 2 vjeçare.

Diagrama e mëposhtme paraqet, raportin në përqindje të numrit të njoftimeve të fituesve në procedurat e prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik për 2019.

Grafiku 9



Shpallja e procedurave në kohën e planifikuar gjatë vitit 2019, është një faktor ndikues në rritjen e numrit të procedurave të përfunduara me fitues krahasuar me vitin 2018. Po kështu, ndikim ka pasur edhe roli asistues i APP në drejtim të hartimit të dokumentave të tenderit, për procedurat e prokurimit të shpallura nga autoritetet kontraktore, në funksion të mirëzbatimit të kërkesave ligjore të prokurimit, duke shmangur gjithashtu zvarritjen e procesit.




Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e fituesve të 2019 krahasuar me 2018.

Tabela 14

Njoftime Fituesi Procedura SPE Janar –Dhjetor		
Viti	2018	2019
Numri i Procedurave	5,116	5,703
Vlera totale Fondi limit	98,121,497,542	87,958,991,776
Vlera totale e Prokuruar	91,795,077,416	80,122,989,108

Në grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e fituesve të 2019 krahasuar me 2018.

Grafiku 10





Gjatë vitit 2019 APP ka analizuar dhe cilin nga dy kriteret e parashikuara nga ligji, kanë përdorur AK-të për vlerësimin e ofertës fituese. Të dhënat e kësaj analize pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 15

Statistika Procedura fituar me oferta ekonomikisht më e favorshme ndaj Totalit Viti 2019							
Nr.	Emërtimi	Nr. Procedura / Lote	Fondi limit Leke pa TVSH	Fondi Prokuruar Leke pa TVSH	% Numrit të procedurave perkatese ndaj totalit	% e Fondit Limit perkates ndaj totalit	% e vleres perkatese te fituar ndaj totalit
1	Procedura te fituara me oferta ekonomikisht më e favorshme viti 2019	98	792,554,697	762,874,274	1,7%	0,9%	0,9%
2	Procedura te fituara bazuar ne ofertat me çmimin më te ulët viti 2019	5605	87,166,437,080	79,360,114,834	98,3%	99,1%	99,1%
5	TOTALI	5703	87,958,991,776	80,122,989,108	100%	100%	100%

Ky është një tregues që na shërben për të inkurajuar dhe udhëzuar AK-të për përdorimin e metodës së vlerësimit “Procedura te fituara me oferta ekonomikisht më e favorshme”. Për këtë qëllim, në draft ligjin e ri të prokurimit publik, është vënë theksi në përdorimin e kësaj metode vlerësimi në të gjitha rastet që është e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së kontratave publike.

2.3.4. STATISTIKA PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2019 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratave, shërbim, mall, punë, i publikuar në faqen zyrtare të APP është 4538.



Njoftimet e kontratave të nënshkruara sipas llojit të procedurave dhe tipit të kontratave paraqiten si më poshtë:

Tabela 16

Njoftime Kontratash të nënshkruara Viti 2019					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i kontratave të nënshkruara	Lloji i Procedurës	Numri i kontratave të nënshkruara	Lloji i Procedurës	Numri i kontratave të nënshkruara
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	88	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	--	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	--
E hapur Ndërkombëtar	4	E hapur Ndërkombëtar	13	E hapur Ndërkombëtar	0
Procedure e hapur lokal	414	Procedure e hapur lokal	583	Procedure e hapur lokal	532
Kërkesë për Propozim	935	Kërkesë për Propozim	1,394	Kërkesë për Propozim	575
TOTALI	1,441	TOTALI	1,990	TOTALI	1,107

Njoftimet e kontratave të nënshkruara sipas vlerës totale dhe tipit të llojit të procedurës paraqiten si më poshtë:

Tabela 17

Të dhëna për procedurat e prokurimit të përfunduara me Kontrata të nënshkruara Viti 2019						
Llojet e procedurave	Numri i kontratave të nënshkruara	Fondi limitotal i prokuruar (vlera ne Leke pa TVSH)	Vlera totale e fituar (Kontraktuar) (vlera ne Leke pa TVSH)	% që ze vlera e fituar ndaj fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer (vlera ne Lekepa TVSH)	% që ze fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar
I Hapur Lokal	1,529	63,298,131,293	57,291,278,581	90,5%	6,006,852,712	9,5%
Kërkesë për Propozim	2,904	8,232,885,525	7,445,739,765	90,4%	787,145,760	9,6%
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	88	699,797,403	674,572,582	96,4%	25,224,821	3,6%
I hapur Ndërkombëtar	17	3,568,822,470	3,399,664,411	95,3%	169,158,059	4,7%
TOTALI	4,538	75,799,636,691	68,811,255,339	90,8%	6,988,381,352	9,2%




Lidhur me ndryshimin e përqindjeve të kursimit ndaj fondit limit të evidentuar tek “Njoftimet e Kontratave të Nënshkruara” krahasuar me përqindjet e kursimit ndaj fondit limit të evidentuar tek “Njoftimet e Fituesve”, sqarojmë se ky ndryshim vjen për faktin se në numrin e kontratave të nënshkruara në vitin 2019 janë të përhira dhe kontrata për të cilat procedurat e prokurimit janë zhvilluar gjatë 2018.

Prandaj përqindjet e kursimit ndaj fondit limit të evidentuar tek “Njoftimet e Kontratave të Nënshkruara” ndryshojnë krahasuar me përqindjet e kursimit ndaj fondit limit të evidentuar tek “Njoftimet e Fituesve”.

Grafiku i mëposhtëm paraqet, numrin e njoftimeve të lidhjes së kontratave në procedurat e prokurimit publik, të ndara sipas tipit të kontratës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2019:

Grafiku 11



Gjithashtu, po nga tabelat e mësipërme rezulton se, numri i kontratave të nënshkruara, 4538 në total, është më i vogël se numri i njoftimeve të fituesve 5703 (diferenca midis numrit të fituesve me kontrata të nënshkruara është 1165).

Kjo diferencë sikurse e theksuam me sipër shpjegohet me argumentin se afati kohor nga momenti i shpalljes së fituesit deri në lidhjen e kontratës është 60 ditë dhe nga nënshkrimi i kontratës në hedhjen në sistem të njoftimit të kontratës së nënshkruar është 5 ditë (kontratat mund të lidhen që në ditën që është shpallur fituesi, por mund të mos jënë hedhur ende në SPE deri në datën 31 Dhjetor 2019, datë e cila është marrë referencë për përpunimin e të dhënave).




Në tabelen dhe grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e kontratave të nënshkruara për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

Tabela 18

Kontrata të Nënshkruara Janar - Dhjetor		
Viti	2018	2019
Numri i Kontratave	4489	4,538
Vlera totale Fondi limit	90,091,037,223	75,799,636,691
Vlera totale e Prokuruar	83,943,950,697	68,811,255,339

Grafiku 12



Sa më sipër, vlen të theksohet fakti se në vitin 2019 janë nënshkruar 49 kontrata më shumë se në vitin 2018, dhe kjo shpjegohet me argumentin se shumë procedura të shpallura fituese në vitin 2018, kanë vazhduar me lidhjen e kontratave në vitin 2019, sepse afati kohor nga momenti i shpalljes së fituesit deri në lidhjen e kontratës është 60 ditë.

2.3.5. STATISTIKA MBI PËRQINDJEN E KURSYER NGA PROCEDURAT E KRYERA NË SISTEMIN ELEKTRONIK

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik të zhvilluara në sistemin elektronik gjatë vitit 2019, fondin limit përkatës, numrin e procedurave të anuluar, numrin e procedurave të vazhduara, numrin e procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar



përkatës, si dhe kursimin në përqindje.


Tabela 19

Procedura prokurimi të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik në periudhën Janar - Dhjetor 2019	
Numri Total i procedurave të publikuara	7384
Fondi total limiti procedurave të publikuara (vlera në lekë)	110,646,365,109
Numri Total i proceduravetëpapërfundura (anulluar, etj)	2168
Fondi totallimit i proceduravetëpapërfundura (anulluar, etj) (vlera në lekë)	18,454,648,684
Numri Total i procedurave të cilat kanë vazhduar	5216
Fondi totallimit i procedurave të cilat kanë vazhduar (vlera në lekë)	92,191,716,425
Numri Total i Procedurave të fituara	5703
Fondi totallimit i procedurave të fituara (vlera në lekë)	87,958,991,776
Vlera totale e fituar (vlera në lekë)	80,122,989,108
% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të procedurave të fituara	91.1%
Fondi total i kursyer (vlera në lekë)	7,836,002,668
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit total limit të procedurave të fituara	8.9%

2.3.6. PROCEDURA KONKURRUESE MBI 800.000 LEKË TË ANULLUARA GJATË VITIT 2019

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se në vitin 2019, nga 7384 procedura të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, 2168 janë anuluar me vlerë 18,454,648,684 lekë, ndërkohë që në vitin 2018 numri total i procedurave të anuluar ishte 2353 procedura me vlerë 17,230,003,380 lekë. Pra, numri i procedurave të anuluar në vitin 2019 është më i ulët se numri i procedurave të anuluar në vitin 2018. E shprehur kjo në përqindje rezulton se në vitin 2019 numri i procedurave të anuluar është 7,9% më i vogël se në vitin 2018.

Grafiku 13





Nga analizimi i të dhënave rezulton se, rreth 1315 procedura të anuluar janë lote, të cilat zënë në total 41.8 % të anulimeve të procedurave të shpallura me lote.


Tabela 20

Lloji procedurës së shpallur në sistem	Numri
Procedura prokurimi pa lote të shpallura	4237
Procedura prokurimi pa lote të shpallura, të anuluar	853
% që zë numri i procedurave pa lote të anuluar ndaj numri të procedurave të prokurimit të shpallura pa lote	20.13 %
Procedura prokurimi me lote të shpallura të shpallura	3147
Procedura prokurimi me lote të shpallura Lote, të anuluar	1315
% që zë numri i procedurave me lote të anuluar ndaj numri të procedurave të prokurimit të shpallura me lote	41.79 %

Në grafikun e më poshtëm paraqitet në % anulimi i procedurave sipas mënyrës së shpalljes në sistem procedurave me lote/ pa lote:

Grafiku 14

% e procedurave të anuluar sipas llojit të shpalljes së procedurës (pa lote/ me lote)



Sa më sipër, vërehet se lotet e anuluar zënë një përqindje më të lartë të numrit të procedurave me lote, të shpallura në sistem.

Nga analizimi i objekteve të procedurave të anuluar rezulton se, mbi 50% të anulimeve të procedurave me lote i takojnë procedurave për blerje të medikamenteve dhe materialeve të shërbimit shëndetësor, ku kryesisht janë anuluar ato lote që prokurohen për sasi me vlera të vogla të medikamenteve apo një pjesë e konsiderueshme e procedurave të anuluar i takon edhe shërbimit të transportit për mësues dhe nxënës, sepse në këto procedura kërkohet transport në zona të largëta, që shpesh nuk paraqesin interes për operatorët ekonomikë.



Gjithashtu, rreth 173 procedura/lote janë të anuluar brenda 7 ditëve nga dita e shpalljes së procedurës në sistem, të cilat përbëjnë rreth 7.97 % të anulimeve në total dhe janë anulime të cilat vinë kryesisht nga gabimet në plotësimin/kryerjen e hapave të procedurës në sistem nga autoritetet kontraktore.

Megjithatë, megjithëse numri i procedurave ka ardhur në rënie në vitin 2019, duhet të vijojë puna me Autoritetet Kontraktore që të marrin masa për të shmangur sa më shumë problematikat që çojnë në anulimin e procedurave të prokurimit, me qëllim rritjen e efikasitetit të procesit.


Nga analizi i të dhënave rezulton se, sipas përcaktimeve të kryera në sistem nga autoritetet kontraktore në lidhje me anulimet për procedurat e shpallura konkurruese sipas arsyeve ligjore të përcaktuara në legjislacion:

Tabela 21

Arsyeja e Anullimit të deklaruar në sistem	Numri i procedurave të anuluar
Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit	550
Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave "b" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 64 të LPP	81
Në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë	2
nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore	745
Për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik	279
Të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar	51
Te tjera	460
Totali	2168



Anullimi i procedurave konkurruese sipas arsyeve ligjore të përcaktuar në legjislacion



2.4. TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT ME NEGOCIM PA SHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT të kontratës

Përveç procedurave konkurruese të prokurimit publik, të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, autoritetet kontraktore, nëse ndodhen në kushtet e parashikuara nga ligji, mund të kryejnë dhe procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me qëllim plotësimin e nevojave të tyre.

Si rezultat i ndryshimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 918/2014, "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike", i cili ka hyrë në fuqi në datën 04.01.2018, të gjitha procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake, pas kësaj date edhe përgjatë vitit 2019, janë zhvilluar vetëm në sistemin e prokurimit elektronik.



Të dhënat për procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake, krahasuar me procedurat konkurruese, për vitin 2019 paraqiten si më poshtë:


Tabela 22

Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për Periudhën Janar-Dhjetor 2019	
Numri Total i Procedurave të fituara konkurruese	5,703
Vlera totale e procedurave të fituara konkurruese	80,122,989,108
Numri total i Procedura vetë fituara Negocim pa shpallje	192
Vlera totale e fituar negocimpashpallje	2,280,708,225
% që zë numri i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj numrit total të procedurave të fituara (konkurruese+negocim pa shpallje)	3.2%
% që zë vlera e fituar për procedurat me negociim pa shpallje ndaj Fondi total të fituar (konkurruese+negocim pa shpallje) për procedurat e fituara	2.8%
Numri Total i Procedurave të fituara (konkurruese+negocimpashpallje)	5,895
Vlera totale e fituar procedurave të fituara (konkurruese+negocimpashpallje)	82,403,697,333
Nr.Total i Procedurave të Reja me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	162
Vlera totale e fituar e Procedurave të Reja me Negocimpashpallje paraprake të njoftimit të kontratës	1,885,650,678
% që zë nr i Procedurave të Reja me negociim pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara (konkurruese+negocim pa shpallje)	2.7%
% që zë vlera totale e fituar e Procedurave të Reja me negociim pa shpallje ndaj vlerës totale të fituar (konkurruese+negocim pa shpallje)	2.3%
Nr.Total i Shtesave të Kontratave me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	30
Vlera e fituar për Shtesat e Kontratave me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	395,057,547
% që zë nr i Shtesave të Kontratave me negociim pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara (konkurruese+negocim pa shpallje)	0.5%
% që zë vlera e fituar e Shtesave të Kontratave me negociim pa shpallje ndaj vlerës totale të fituar (konkurruese+negocim pa shpallje)	0.5%

Numri total i procedurave me negociim pa shpallje të zhvilluara gjatë vitit 2019 është **192** (339 procedura më pak se në vitin 2018 që ishin 531 procedura me negociim pa shpallje paraprake), ose **3.2%** e numrit total të procedurave të prokurimit të vijuar me fitues.




Grafiku 16



Ndërkohë, sa i përket vlerës së prokuruar me procedurën me negociim pa shpallje, është edhe më ulët, pasi zë vetëm 2.8 % ndaj fondit të prokuruar me procedura konkurruese.

Grafiku 17



Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.




Tabela 23

Negocime Janar - Dhjetor		
Viti	2018	2019
Numri i Procedurave	531	192
Vlera totale Fondi limit	4,009,588,377	2,338,820,945
Vlera totale e Prokuruar	3,964,472,127	2,280,708,225

Në grafikun e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

Grafiku 18



Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës të detajuar sipas tipit të kontratës, për vitin 2019.

Tabela 24

Negocime pa shpallje të përfunduara, Janar – Dhjetor 2019			
Lloji i procedurës	Nr	Fondi limit	Fondi Prokuruar
Shërbimi i Ruajtjes	53	160,526,001	157,900,331
Shërbime te tjera	64	587,960,944	573,587,126
Mallra	37	366,594,514	363,023,850
Punë	38	1,223,739,486	1,186,196,919
TOTAL	192	2,338,820,945	2,280,708,225



Të dhënat e në lidhje me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës të shprehura sipas kontratave të reja apo shtesa kontrate për vitin 2019, detajohen si më poshtë:

Tabela 25

Shtesa Kontrate	30	395,468,211	395,057,547
JO Shtesa Kontrate	162	1,943,352,734	1,885,650,678

Sikurse rezulton nga tabela, numri total i shtesave të kontratave të nënshkruara gjatë vitit **2019** është **30** ose 15,6% e procedurave me negociim pa shpallje të zhvilluara në total, ndërsa **162** procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës janë procedura të reja që janë zhvilluar bazuar në një nga rastet e tjera të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik, sic janë situatat emergjente 142 procedura ose 73,9 % , situatat e ekskluzivitetit apo të drejtës së autorit 14 procedura, ose 7.3%.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten procedurat e prokurimit negociime pa shpallje te paraprake të detajuar sipas Bazës ligjore të përdorur nga autoritetet kontraktore:

Tabela 26

Detajimi i Procedurave Me Negocim pa shpallje sipas Bazës Ligjore të përdorur				
Emertimi	Numri Procedurave te detajuara sipas Bazes Ligjore	% e Numrit te Procedurave te detajuara sipas Bazes Ligjore ndaj Totalit	Fondi limit detajuar sipas Bazes Ligjore	% e Fondi limit detajuar sipas Bazes Ligjore ndaj Totalit
Mungesë konkurrence në 2 procedura të njëpasnjëshme (Neni 33, pika 2/a)	2	1,0%	5,193,000	0,2%
Të drejta ekskluzive ose të drejtë autori (Neni 33, pika 2/b)	14	7,3%	98,811,312	4,2%
Nevoja ekstreme shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme (Neni 33, pika 2/c)	146	76,1 %	1,800,358,145	77%
Mallra të prodhuara për qëllime kërkimi, ekperimentimi, studimi ose zhvillimi (Neni 33, pika 3/b)	5	2,6%	115,639,316	5,0%
Lëvrime shtesë nga furnizuesi i mëparshëm (Neni 33, pika 5/a)	25	13,0%	318,819,172	13,6%
TOTAL	192	100,0%	2,338,820,945	100,0%


Sa i takon raportit të këtyre procedurave me numrin total të procedurave të fituara (konkurrense+negociime pa shpallje), procedurat me negociim pa shpallje paraprake zënë në total 0,5%, ndërkohë që procedurat e reja të finalizuara nëpërmjet kësaj lloji procedure përbëjnë 2.8%.

Sikurse rezulton nga tabela e mëposhtme numri i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për vitin 2019 është ulur në mënyrë të ndjeshme krahasuar 11 vitet e fundit 2009-2019.



Grafiku 20

Numri i procedurave Fituara me Negocime pa shpallje si dhe numri i procedurave te Fituara 2009-2019



Vlen të theksohet se, minimizimi i rasteve të përdorimit të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, ka ardhur si rezultat i rekomandimeve dhe njoftimeve të vazhdueshme nga Agjencia e Prokurimit Publik që të marren masat për publikimin e procedurave konkurruese në kohë, mundësisht Marrëveshje Kuadër për shërbime/mallra të vazhdueshme, pikërisht që autoritet kontraktore të mos gjenden pa shërbim/ mall në fillim vitit.

Gjithashtu, zhvillimi i kësaj procedure prokurimi në sistemin e prokurimit elektronik, që nga pasqyrimi në zërin përkatës të regjistrin të parashikimeve, ku autoritet kontraktore duhet të përshkruajnë edhe arsyet që detyrojnë përzgjedhjen e kësaj procedure sipas kushteve ligjore, ka mundësuar shmangien e përdorimit të procedurës së prokurimit “negocim pa shpalljen paraprake të njoftimit të kontratës”, vetëm në rastet kur autoritetet kontraktore përballen me domosdoshmërinë e plotësimit të nevojave të tyre.

Konkretisht, numri i elementëve “Negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” të dërguara për publikim në sistemin e prokurimit elektronik, paraqitet si më poshtë:

Tabela 27

Të dhënat për rregjistrin e parashikimeve dhe ato të realizuara Procedura Negocime pa Shpallje Periudha Viti 2019		
Emertimi	Numri i procedurave (elementeve)	Fondi limit leke pa TVSH
Numri Total i Proçedurave (elementeve) dhe Fond Limit te parashikuara ne Rregjister	234	2,695,753,643
Numri Total Proçedurave dhe Fond Limit te pa realizuara nga Rregjisteri	44	363,627,412
Numri Total Proçedurave dhe Fond Limit te realizuara nga Rregjisteri	190	2,332,126,231
% Numri Total i Proçedurave dhe Fond Limit te realizuara ndaj atyre te parashikuara ne Rregjister	81%	86%
Numri Total Proçedurave dhe Fond Limit te parashikuara në Rregjister por që nuk janë realizuar, pasi nuk plotësonin kushtet e parashikuara nga legjislacioni i prokurimit	446	3,447,746,765



Nga të dhënat statistikore të nxjerra nga SPE për kontratat me negociim pa shpallje kemi referuar 192 procedura me fond limit 2,338,820,945 leke pa TVSH, ndërsa sipas regjistrarit rezultojnë 190 procedura me fond limit 2,332,126,231 leke pa TVSH. Diferenca në numër procedurash është si rezultat i publikimit në vitin 2019, të 2 (dy) kontratave për procedurat e shpallura në 2018 dhe lidhur kontrata në 2019.

Sikundër vërehet nga të dhënat e mësipërme vlerat më të larta të procedurave me negociim pa shpallje paraprake është periudha Prill - Qershor dhe Dhjetor 2019 si rezultat i termetit.

Procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontrates me rrugë shkresore, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 "Për Shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë"

Tabelat e mëposhtme paraqesin të dhënat mbi procedurat me negociim pa shpallje paraprake të zhvilluara në formë shkresore për shkak të Tërmetit të datës 26 Nëntor 2019.

Tabela 28

Statistika Kontratat me Proçedurë Negocim pa Shpallje të Njoftimit të Publikuara në Buletin e Muajit Dhjetor 2019 për TËRMETIN				
	Nr.Total i Proc.te fituara	Fondi total limit i prokuruar	Vlera Kontrates pa TVSH	Fondi kursyer
Publikuar Dhjetor 2019	5	11,206,201	11,163,548	69,653

Tabela 29

Kontratat me Proçedurë Negocim pa Shpallje Paraprake të Njoftimit të Publikuara në Buletin e Muajit Dhjetor 2019 për TËRMETIN	
Nr.Total i Proç.te fituara	5
Fondi total limit i prokuruar	11,206,201
Fondi total i ofruar pa tvsh	11,163,548
% që zë fondi total i ofruar ndaj fondit limit të prokuruar	99,4%
Fondi total i kursyer	69,653
% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar	0,6 %

Tabela 30

Negocime pa shpallje për TËRMETIN të përfunduara, Dhjetor 2019			
Lloji i procedurës	Nr	Fondi limit	Fondi Prokuruar
Shërbim	3	9,032,079	9,016,608
Mallra	1	798,700	783,500
Punë	1	1,375,422	1,363,440
TOTAL	5	11,206,201	11,163,548



Nga sa më sipër, rezulton se në total gjatë muajit dhjetor 2019 janë publikuar në buletin e njoftimeve publike vetëm 5 procedura në formë shkresore nga të cilat 3 për kontrata shërbimi, 1 kontratë mallrash dhe 1 punë.

2.5. MARRËVESHJET KUADËR

Gjatë vitit 2019, bazuar në udhëzimet e APP rezulton se, autoritetet kontraktore kanë përdorur në mënyrë masive procedurat e prokurimit me Marrëveshje Kuadër, për mallra dhe shërbime të vazhdueshme, fokusuar kryesisht në shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, furnizime të natyrave të ndryshme, si dhe mirëmbajtje e riparime të ndryshme në automjete e pajisje.

Këto të dhëna janë një tregues konkret i punës dhe iniciativave të APP për të stimuluar përdorimin e Marrëveshjes Kuadër, si një instrument i rëndësishëm për përmbushjen e nevojave të vazhdueshme të autoriteteve kontraktore nëpërmjet procedurave transparente dhe konkurruese, dhe veçanërisht në eliminimin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake.

APP ka nxjerrë rekomandime të vazhdueshme për autoritetet kontraktore për përdorimin e marrëveshjeve kuadër, si dhe ka organizuar trajnime të herëpashershme, me qëllim udhëzimin e tyre mirëmbatimit të këtij mekanizmi.

Konkretisht, të dhënat në lidhje me përdorimin e këtij instrumenti, paraqiten si më poshtë:

Tabela 31

Publikime Marrëveshje Kuadër të vazhduara Janar-Dhjetor 2019		
Lloji i procedurës	Numër	Fondi total Limit i prokuruar (leke pa TVSH)
I Hapur Lokal	265	14,555,927,716
Kërkesë për Propozim	489	1,679,790,021
I hapur mbi kufi	9	6,455,300,336
TOTAL	763	22,691,018,074

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me publikime Marrëveshje Kuadër që kanë vazhduar në sistem për vitin 2019.

Tabela 32

Marrëveshje Kuadër që kanë vazhduar Janar - Dhjetor 2019	Numri i procedurave (jo Lote)	Fondi limit total
Ruajtje objektesh	211	2,880,181,812
Shërbime të ndryshme	192	5,370,820,795
Blerje Mallra të ndryshme	349	13,333,554,599
Punë Civile	11	1,106,460,868
TOTAL	763	22,691,018,074



Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me publikime Marrëveshje Kuadër për vitin 2019, krahasuar me publikime Marrëveshje kuadër të vitit 2018.


Tabela 33

Publikime Marrëveshje Kuadër Janar - Dhjetor		
Viti	2018	2019
Numri i Procedurave	627	763
Vlera totale Fondi limit	14,150,116,480	22,691,018,074

Një tregues tjetër që vihet re nga tabela e mësipërme është rritja në numër dhe fondit limit të procedurave të shpalluara me Marrëveshje Kuadër zhvilluar në periudhën Janar–Dhjetor 2019 (763 procedura me fond limit **22,691,018,074** leke) krahasuar me numrin dhe fondin limit të procedurave të zhvilluara në periudhën Janar–Dhjetor 2018 (627 procedura me fond limit 14,150,116,480 lekë).

Në grafikun e mëposhtme paraqiten të dhënat krahasuese të vitit 2019, me të të dhënat e vitit 2018, respektivisht në numër dhe në vlerë.

Grafiku 21



Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me publikime Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistem për vitin 2019.



Tabela 34

Procedura prokurimi Marrëveshje Kuadër përfunduara me fitues Viti 2019						
Lloji procedurës	Numri Procedurave	Fondi limit total (vlera ne Leke)	Fondi total i ofruar (vlera ne Leke)	% që ze fondi i ofruar ndaj fondit limit të prokuruar (vlera ne Leke)	Fondi total i kursyer	% që ze fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar
I Hapur Lokal	296	14,575,264,779	13,874,247,155	97,0%	701,017,624	4,8%
Kërkesë për Propozim	508	1,706,098,205	1,627,679,987	95,4%	78,418,217	4,6%
I Hapur mbi kufi	8	5,029,522,395	5,018,645,391	99,5%	10,877,004	0,5%
TOTAL	812	21,310,885,379	20,520,572,534	96,3%	790,312,845	3,7%

Diferenca midis numrit të procedurave të shpallura me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistem, shpjegohet me faktin se në fund të vitit 2018 janë publikuar një numër i lartë procedurash, që janë shpallur fituese në vitin 2019. Për konkretizim, i referohemi faktit se vetëm në muajin Dhjetor 2018 janë publikuar 95 procedura me fond limit 2,700,362,169 lekë, të cilat janë shpallur fituese në vitin 2019.

Lidhur me përqindjen “në dukje të ulët” të kursimit të fondit limit të evidentuar tek procedura “I Hapur mbi Kufi”, sikurse e kemi sqaruar edhe më sipër në procedurën e prokurimit “Marrëveshja Kuadër”, për efekte statistikore Vlera totale e Fituar, përlllogaritet e njëjtë me Fondin limit total të publikuar, për arsye se “Marrëveshjet Kuadër” shoqërohen me një numër të madh minikontratash sipas nevojave të autoriteteve kontraktore për një periudhë kohore 1 ose 2 vjeçare.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistem për vitin 2019, krahasuar me Marrëveshje kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistem për vitit 2018.

Tabela 35


Procedura prokurimi Marrëveshje Kuadër krahasuese të përfunduara me fitues Janar – Dhjetor		
Viti	2018	2019
Numeri I Procedurave	565	812
Vlera totale Fondi limit	11,140,731,183	21,310,885,379
Vlera totale e Prokuruar	10,706,583,131	20,520,572,534

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistemin e prokurimit elektronik është 812 (**247** procedura Marrëveshje Kuadër më shumë krahasuar me vitin 2018). Rritje e cila vjen si rezultat i rekomandimeve të vazhdueshme të APP për përdorimin e marrëveshjes kuadër nga autoritetet kontraktore sidomos për rastet e shërbimeve të vazhdueshme si dhe në fund të vitit 2018 janë publikuar një numër i lartë procedurash, të cilat janë finalizuar me shpalljen dhe publikimin e njoftim fituesit gjatë vitit 2019.



Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat krahasuese të vitit 2019, me të dhënat e vitit 2018, respektivisht në numër dhe vlerë.

Grafiku 22



Përsa i përket minikontratave të nënshkruara në bazë të Marrëveshjeve kuadër, të dërguara për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike gjatë 2019 rezultojë të dhënat e mëposhtme:

Tabela 36

MINI Kontrata te referuara nga publikimet ne Buletinet e Vitit 2019	
Numri i Mini Kontratave	Vlera e Konrates
746	523,564,377



2.6. PROCEDURAT E PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL

Gjatë vitit 2019 kufiri i prokurimeve me vlerë të vogël ka vazhduar të jetë deri në 800.000 mijë lekë.

Numri i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2019 dhe fondet përkatëse, paraqiten si më poshtë:

Tabela 37

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël Janar-Dhjetor 2019	
Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël te publikuara per vitin 2019	17179
Fondi total limiti publikuar për procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël (vleranë lekë)	4,906,240,484
Numri Total i Procedurave të papërfundura (anulluar, etj)	3827
Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi	13257
Fondi total Limit për procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	4,099,367,872
Vlera totale e fituar në procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	3,525,664,030
% që zë vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të procedurave të përfunduara me fitues	86%
Fondi total i kursyer (vleranë lekë)	573,703,842
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit total limit të procedurave të përfunduara me fitues	14%

Po të krahasojmë numrin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të përfunduara me fitues në vitin 2019 (13,257), me numrin respektiv në vitin 2018 (14,923), rezulton se gjatë vitit 2019 në numër janë përfunduara me fitues më pak procedura.

Tabela 38

Procedura Prokurime me Vlerë të Vogël Krahasime Janar - Dhjetor		
Viti	2018	2019
Numri I Procedurave prokurim me vlerë të vogël	14,923	13,257
Vlera e kursyer	589,163,108	573,703,842
Vlera e Prokuruar	3,722,230,375	3,525,664,030
Vlera totale Fondi limit	4,331,393,483	4,099,367,872



Një tregues tjetër shumë i rëndësishëm që rezulton nga të dhënat në tabela, është diferenca midis fondit, me të cilin janë shpallur procedurat, me fondin, me të cilin janë fituar ato dhe konkretisht kursimi është 14%, i cili duhet të konsiderohet normal.

Nga krahasimi i të dhënave të vitit 2019 dhe atyre respektive të vitit 2018, rezulton se numri i procedurave prokurim me vlerë të vogël të anuluar në vitin 2019 (3827) është shumë më i vogël, krahasuar me ato të anuluar në vitin 2018 (4610).


Gjithashtu, po të krahasojmë vlerat respektive, rezulton gjithashtu se fondi i procedurave prokurim me vlerë të vogël të anuluar në vitin 2019 (965,358,287), është më i vogël se fondi i procedurave prokurim me vlerë të vogël të anuluar në vitin 2018 (1,090,670,275).

Tabela 39

Anullime Procedura Prokurim me Vlerë të Vogël Krahasime Janar - Dhjetor		
Viti	2018	2019
Numri i Procedurave	4610	3827
Vlera totale Fondi limit	1,090,670,275	965,358,287

Në grafikun e më poshtëm, paraqitet krahasimi i të dhënave mbi procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të anuluar gjatë vitit 2019 me atyre respektive të vitit 2018.

Grafiku 23



Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm, kemi një ulje të konsiderueshme të numrit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të anuluar, krahasuar me vitin 2018, konkretisht rreth 16.98 % më pak procedura të anuluar në 2019.




Gjithashtu, sa i takon , prokurimeve me vlerë të vogël, vlen të theksohet se edhe monitorimi mënyrë të vazhdueshme nga APP, e cila nëpërmjet evidentimit të problematikave përkatëse ka udhëzuar autoritetet drejt mirëzbatimit të kërkesave ligjore, çka ka përmirësuar procesin edhe në këtë drejtim.

Në tabelën dhe grafikun e më poshtëm jepen në % anulimet e procedurave e prokurimit me vlerë të vogël sipas arsyeve ligjore të deklaruar (selektuar) në sistem nga autoritetet kontraktore:

Tabela 40

Nr.	Arsyeja e Anullimit	Numri i Procedurave të Anulluara Prokurim me vlerë të vogël
1	Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit	278
2	Nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore	595
3	Për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik	533
4	Të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar	626
5	Të tjera	1795
Totali		3827

Grafiku 24



**2.7. STATISTIKA NË LIDHJE ME PROCEDURAT E KRIJUARA NË SISTEMIN ELEKTRONIK**

Numri total i procedurave të prokurimit të vijuara me fitues, duke përfshirë edhe prokurimet me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik **për vitin 2019, është 20641**, të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 41


Lloji i procedurës	Numri Total i Procedurave/ lote të elektroniketë përfunduara me fitues	Vlera totale e fituar në procedurat e prokurimit të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)
Procedura Prokurimi konkurruese mbi 800.000 lekë	5073	80,122,989,108
Prokurimit me Vlerë të Vogël	13257	3,525,664,030

Në diagramën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të prokurimeve me vlerë të vogël, ndaj procedurave të prokurimit mbi vlerën 800.000 lekë, ku, sikurse dhe nga treguesit e analizuar më sipër, del qartë volumi më i madh që zënë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ndaj procedurave të tjera.

Grafiku 25

Raporti në % i numrit të procedurave të vijuara prokurim me vlerë të vogël, ndaj procedurave të prokurimit të vijuara mbi vlerën 800.000 lekë

■ Procedura Prokurimi konkurruese mbi 800.000 lekë ■ Prokurimit me Vlerë të Vogël




Megjithatë, pavarësisht se në raportin në numër dominojnë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, duhet theksuar se në raportin në vlerë, dukshëm dominojnë procedurat e prokurimit mbi vlerën 800.000, duke qenë se raporti është në të kundërt; fondi i prokuruar me procedurë prokurimi me vlerë të vogël zë rreth 4 %, kurse fondi i prokuruar me procedura të tjera zë rreth 96 %.



Grafiku 26

Raporti në % i fondi i prokuruar me procedurë prokurimi me vlerë të vogël me fondin e prokuruar me procedura mbi 800.000 lekë

■ Procedura Prokurimi konkurruese mbi 800.000 lekë ■ Prokurimit me Vlerë të Vogël



2.8. SISTEMI DINAMIK BLERJE BILETA TRANSPORTI AJROR NDËRKOMBËTAR

Autoritetet kontraktore përdorin Sistemin e thjeshtuar Dinamik të Blerjeve, si një mënyrë për të siguruar blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar.

Sikurse është parashikuar në udhëzimin përkatës të APP, autoritetet kontraktore kanë zbatuar procedurën, duke marrë në konsideratë për realizimin e shërbimit të gjithë operatorët ekonomikë të kualifikuar.

Numri i procedurave të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të zhvilluara gjatë vitit 2019 dhe fondet përkatëse, paraqiten si më poshtë:

Tabela 42

Sistemi dinamik blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar	
Numri Total i procedurave blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar	2990
Numri Total i Procedurave të papërfundura (anulluar, etj)	373
Numri Total i procedurave blerje e biletave të cilat kanë vazhduar	2617
Vlera totale e fituar në procedurat blerje e biletave të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	376,386,987

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen në % anulimet për sistemin dinamik, bileta të transportit ajror ndërkombëtar sipas arsyeve ligjore të deklaruar (selektuar) në sistem nga autoritetet kontraktore:



Tabela 43

Nr.	Arsyeja e Anullimit	Numri i Procedurave të Anulluara
1	asnje nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit	29
3	nuk është paraqitur asnje ofertë brenda afateve kohore	18
4	për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa-parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik	80
5	të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar	85
6	Te tjera	161
	Totali	373

Grafiku 27



2.9. STATISTIKA NË LIDHJE ME AUTORITETET KONTRAKTORE QË KANË KRIJUAR PROCEDURA NË SISTEMIN ELEKTRONIK

Numri total i autoriteteve kontraktore aktive që kanë krijuar procedura prokurimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2019 është 1337 (51 më pak se në 2018), ndërsa numri i autoriteteve kontraktore që kanë krijuar procedura prokurimi mbi 800.000 lekë është 560 (30 më pak se në 2018), të cilët janë të përfshirë brenda numrit 1337.

Nga analizimi i të dhënave rezulton se, numri i Autoriteteve Kontraktore që kanë realizuar në sistem vetëm procedura prokurimi me vlerë të vogël është 693, në krahasim me numrin e autoriteteve kontraktore që kanë zhvilluar edhe procedura të tjera prokurimi që është 644 autoritete kontraktore.



Tabela 44

Lloji i procedurës së prokurimit të shpallur në SPE	Numri i Autoriteteve Kontraktore
vetem Prokurim me vlere te vogel	693
të tjera	644
Totali	1,337

Gjithashtu, më poshtë paraqitet të dhëna Statistike për Operatorët Ekonomike fitues të procedurave të zhvilluara në SPE për viti 2019:

Tabela 45

Nr.	Emertimi	Numer Operatorë ve Ekonomike	Nr. Procedura / Lote	Fondi limit Leke pa TVSH	Fondi Prokuruar Leke pa TVSH	% e Fondit Limit ndaj totalit	% e vleres se fituar ndaj totalit
1	Operatorë Ekonomike të shpallur fitues viti 2019	568	4960	56,277,207,573	51,765,044,287	63.98%	64.61%
2	Operatorë Ekonomike Te huaj Fitues	5	8	198,853,854	183,690,241	0.23%	0.23%
3	Procedura/Lote fituar si Bashkim Operatorësh	500	735	31,482,930,349	28,174,254,580	35.79%	35.16%
	Totali	1,073	5703	87,958,991,776	80,122,989,108	100.00%	100.00%

2.10. STATISTIKA NË LIDHJE ME OFERTAT E DORËZUARA në sistemin E PROKURIMIT ELEKTRONIK

Numri total i ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në procedurave e shpallura në sistem nga Autoriteteve Kontraktore për vitin 2019 paraqitet në tabelën e mëposhtë me:

Tabela 46

Numri i Ofertave në sistem	
Numri i Ofertave të dorëzuara në sistem	178317
Numri i Procedurave ne sistem	27553
Mesatarja e ofertave ne sistem	4

Në mënyrë të detajuar numri i ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit mbi vlerën 800.000 lekë, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si dhe në procedurat e prokurimit Sistem Dinamik, Blerje bileta të transportit ndërkombëtar, jepet në tabelën e mëposhtme, konkretisht:



Tabela 47

Numri i Ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit të shpalluara në sistem	
Numri i Procedurave /Loteve të Prokurimit	7384
Numri i Ofertave të dorëzuara Procedurat /Lotet e Prokurimi	17512
Mesatarja e ofertave për Procedurë Prokurimi/Lote	2.37
Numri i Procedurave të prokurimit me vlerë të vogël	17179
Numri i Ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël	150073
Mesatarja e ofertave për Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël	8.74
Numri i procedurave Sistem Dinamik, Blerje bileta të transportit ndërkombëtar	2990
Numri i Ofertave të dorëzuara në procedurat Sistem Dinamik, Blerje bileta të transportit ndërkombëtar	10732
Mesatarja e ofertave për procedurat Sistem Dinamik, Blerje bileta të transportit ndërkombëtar	3.59

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja e ofertave në prokurimet me vlerë mbi 800.000 lekë është 2.37 oferta për procedurë, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël kjo mesatare shkon 8.74 oferta për procedurë, ndërsa në procedurat Sistem Dinamik, Blerje Biletash kjo mesatare shkon rreth 3.59 oferta për procedurë.

Në tabelën e mëposhtme tregohet numrit i ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit me vlerë mbi 800.000 lekë, nga operatorët ekonomikë sipas llojit të procedurës:

Tabela 48

Lloji i Procedurës së prokurimit	Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri Total i ofertave të dorëzuara	Numri mesatar i ofertave
Shërbim Konsulence	Shërbime	91	357	3.92
Konkurs Projektimi	Shërbime	2	10	5.00
E Hapur INT	Shërbime	14	23	1.64
	Mallra	33	78	2.36
E Hapur	Punë	528	3165	5.99
	Shërbime	698	1293	1.85
	Mallra	1558	2325	1.49
Kërkesë për Propozim	Punë	680	2269	3.34
	Shërbime	1305	4186	3.21
	Mallra	2473	3799	1.54
E Kufizuar INT	Mallra	1	6	6.00
E Kufizuar	Mallra	1	1	1.00
Totali		7384	17512	2.37



Në tabelën e mëposhtme, paraqitet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit me vlerë mbi 800.000 lekë **sipas tipit të kontratës**:

Tabela 49

Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri total i ofertave të dorëzuara	Numri mesatar i ofertave
Mallra	4066	6209	1.53
Punë	1208	5434	4.50
Shërbime	2110	5869	2.78
Totali	7384	17512	2.37

Sikurse rezultojnë nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja më e lartë e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë është në tipet e kontratave **“Punë”** dhe **“Shërbime”**, që zënë dhe **45 %** të numrit të procedurave të shpalluara.


Nga analizimi i procedurave të vijuar me njoftim fituesit, rezultojnë se mesatarja e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në autoritetet kontraktore, ndara sipas numrit total të ofertave që kanë pasur, është si më poshtë:

Tabela 50

Numri i ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit	Nr i AK	Mesatarja e ofertave
AK që kanë mbi 600 oferta	3	4.27
AK që kanë nga 300 oferta deri në 600 oferta	5	5.76
AK që kanë nga 100 oferta deri në 300 oferta	26	4.49
AK që kanë deri në 100 oferta	504	4.27

Në diagramën e mëposhtme mesatarja e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në autoritetet kontraktore të grupuara sipas numrit të ofertave të dorëzuara në procedurat e vijuar me fitues.

Grafiku 28




Në tabelën dhe grafikun e mëposhtme paraqiten të dhënat në lidhje me mesataren e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në autoritetet kontraktore sipas numrit të procedurave të vijuar:



Tabela 51

Mesatarja sipas numrit të procedurave të vijuara	Numri i procedurave	Mesatarja e ofertave
AK me 1 procedure të vijuar	180	5.33
AK me 2 deri ne 5 procedura të vijuara	172	3.99
AK me 6 deri ne 10 procedura të vijuara	65	3.91
AK me 11 deri ne 20 procedura të vijuara	51	3.09
AK me 21 deri ne 30 procedura të vijuara	24	2.86
AK me 31 deri ne 40 procedura të vijuara	8	2.22
AK me mbi 41 procedura të vijuara	4	1.53

Grafiku 29



Në tabelën dhe grafikun e më poshtme paraqiten të dhënat në lidhje me mesataren e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në autoritetet kontraktore me 1 të procedurë të vijuar me fitues dhe mbi 2 procedura të vijuara:


Tabela 52

	Autoritete Kontraktore	Mesatarja e ofertave
AK qe kane bere 1 procedure	180	5.33
AK qe kane bere mbi 2 procedura	324	2.93

Nga analizimi i të dhënave rezulton se, Autoritetet Kontraktore që kanë zhvilluar në sistem 1 procedurë prokurimi mbi 800.000 lek, e kanë mesataren e ofertave më të lartë se sa , autoritetet kontraktore që kanë zhvilluar në sistem më shumë se 2 procedura prokurimi. Ky raport në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë:



Grafiku 30



Përsa i përket procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, në tabelën e mëposhtme tregohet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë, sipas tipit të kontratës:

Tabela 53

Lloji i Procedurës	Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri total i ofertave të dorëzuara	Numri mesatar i ofertave
Prokurim me vlerë të vogël	Mallra	11717	122220	10.43
	Shërbime	4956	24065	4.86
	Punë	506	3788	7.49
Totali		17179	150073	8.74

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja më e lartë e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë është në tipet e kontratave **“Mallra”** që zënë 68 % të procedurave prokurim me vlerë të vogël të shpalluar në sistem dhe **“Punë”**, që zënë dhe 3 % të procedurave prokurim me vlerë të vogël të shpalluar në sistem të shpallura në sistem.

2.11. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME KONCESION/PPP GJATË VITIT 2019

Numri i procedurave për dhënien me koncesion/PPP, të shpallura për t’u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të nënshkruara, të dërguara gjatë vitit 2019, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 54

Procedura për dhënien me koncesion /PPP	Numri i procedurave
Njoftime Kontratash për vitin 2019	6
Njoftime Fituesish	5

Nga totali prej 6 (gjashtë) njoftimeve të kontratave të shpallura për t’u zhvilluar në 2019, rezulton se:

- në 3(tre) raste është kryer shpallja e fituesve të procedurave koncesionare/PPP brenda vitit 2019,



- në 2(dy) raste procedurat e shpallura janë në proces shqyrtimi dhe vlerësimi të ofertave për shpalljen e fituesit.
- në 1(nje) rast procedura e publikuar në vitin 2019 është anuluar.

Nga totali prej 5 (pesë) njoftimeve fituesi të shpallura gjatë 2019, rezultojnë se:

- në 3(tre) raste është kryer shpallja e fituesve të procedurave koncesionare/PPP brenda vitit 2019,
- në 2(dy) raste janë shpallur fitues nga procedurat koncesionare/PPP të publikuara në vitin 2018.

2.12. STATISTIKA NË LIDHJE ME PROCEDURAT E ANKANDIT PUBLIK TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2019

Gjatë vitit 2019 janë shpallur në Buletin e Njoftimeve Publike edhe procedura të ankandit publik, procedura këto, të cilat zhvillohen vetëm në rrugë shkresore.

Konkretisht, të dhënat në lidhje me këtë procedurë paraqiten si më poshtë:

Tabela 55

Procedura të ankandit publik	Numri	Vlera e ofertuar në lekë
Njoftime Shpallje Ankandi	612	
Njoftime Fituesish Ankandi	146	3,564,831,169
Njoftime Kontratash të Nënshkruara Ankandi	72	3,544,559,685
Njoftime Anullimi Ankandi	183	

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, duhet mbajtur në konsideratë fakti që në shumë raste ka rezultuar se një subjekt është shpallur fitues në disa lote të procedurave të ankandëve, prandaj edhe numri i kontrave të lidhura është më i vogël se numri i njoftimeve të fituesit.

Gjithashtu, numri i lartë i njoftimeve për shpallje ankandi shpjegohet me faktin se autoritetet kontraktore dërgojnë për publikim në Buletin të njëjtin njoftim disa herë në periudha të ndryshme kohore.



3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2018

3.1. NDRYSHIMET LEGJISLATIVE

3.1.1. HARTIMI I PROJEKTLIGJIT “PËR PROKURIMIN PUBLIK”

1. Një nga synimet kryesore të APP gjatë vitit 2019, ka qenë hartimi i projektligjit të ri për prokurimin publik, në përputhje me Direktivat 2014/24/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, për prokurimin publik, 2014/25/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, për prokurimin nga entet që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare, si dhe 2007/66/BE mbi mjetet juridike dhe rishikimin administrativ.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 129, datë 29.08.2018, për rishikimin e ligjit për prokurimin publik, me synim përafrimin e tij me acquis përkatëse të BE-së, në kuadër të procesit të integritetit të vendit në BE, gjatë këtij viti është punuar në mënyrë intensive për draftimin e projektligjit të ri për prokurimin publik.

APP ka kryesuar grupin ndërinstitucional të punës të ngritur për rishikimin e ligjit, duke organizuar takime të përbashkëta, me përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse në këtë grup, ku janë diskutuar ndryshimet e nevojshme në ligjin aktual të prokurimit publik.

Gjithashtu, gjatë gjithë vitit, në APP ka funksionuar grupi institucional i punës, i cili ka hartuar projektligjin, pasi ka analizuar problematikat e dala në praktikë, propozimet e autoriteteve kontraktore, të operatorëve ekonomikë apo edhe aktorëve të tjerë në fushën e prokurimit publik, përfshi edhe rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe organizma të ndryshëm ndërkombëtarë.

APP përfundoi punën për hartimin e projektligjit të ri të prokurimit publik, në muajin nëntor, në bashkëpunim të ngushtë edhe me ekspertët e SIGMA/OECD, si dhe është ndarë e konsultuar edhe me ekspertë të DG Grow në Komisionin Evropian, të cilët kanë dhënë vlerësim maksimal për draftin.

Projektligji është shoqëruar me relacionin shpjegues dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit (RIA).

□ **Objektivat** konkrete që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektligji, janë:

- Të përmirësohet ndjeshëm kuadri aktual rregullator në fushën e prokurimit publik, klasik dhe utilitar;
- Të lehtësohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë, në procedurat e prokurimit;
- Të shmanget zvarritja e procesit të prokurimit, për shkak të afateve të parashikuara për ankimin administrativ;
- Prokurim i qëndrueshëm, në respektim të parimeve për mbrojtjen sociale dhe mjedisore;
- Lehtësi në prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike;
- Rritja e performancës në implementimin e kontratave, nëpërmjet forcimit të monitorimit të këtij procesi.

□ Projektligji për prokurimin publik sjell **risi** në disa drejtime, si në aspektin procedural, parashikimet për operatorët ekonomikë si dhe procesin e ankimit administrativ.

Sa i takon aspektit procedural, projektligji sjell disa parashikime të reja, siç janë kontratat e përziera të prokurimit, kontrata brenda sektorit publik, kontratat e rezervuara, njoftimet paraprake dhe periodeke të informacionit, si mjete që rrisin transparencën, dhe i japin mundësi operatorëve ekonomikë të njihen kohë më parë me të dhënat e një objekti konkret prokurimi të planifikuar dhe shkurtimin e procedurës së prokurimit, lloje të reja procedurash prokurimi si: Procedura Konkurruese me Negocim, Dialogu Konkurrues dhe



Partneriteti për Inovacion, legjislacioni I aplikueshëm kur procedurat përcaktohen në marrëveshje ndërkombëtare/organizatë ndërkombëtare ose kur kontratat financohen plotësisht nga një organizatë ndërkombëtare apo institucion financiar ndërkombëtar, si dhe përdorimi I kriterit për vlerësim “oferta ekonomikisht më e favorshme”, identifikuar në bazë të çmimit dhe koston, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston;

Sa i takon parashikimeve që lidhen me operatorët ekonomikë, projektligji nga njëra anë sjell disa lehtësi për pjesëmarrjen dhe ofertimin e tyre në procedurat e prokurimit, por gjithashtu me synimin për të rritur përgjegjshmërinë në ofertat e paraqitura, parashikohen edhe masa shtrënguese të tilla si sigurimi i ofertës, apo penalitet në rastet e tërheqjes nga nënshkrimi i kontratave publike të fituara prej tyre.

Projektligji parashikon rishikimin administrativ njëkohësisht në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, me të drejtën për t’u bashkuar në këtë proces të gjithë operatorët ekonomikë të interresuar, çka synon të sjellë shkurtim jo vetëm shkurtimin e afateve të procesit të ankimit, por dhe gjithë procesit të prokurimit, duke shmangur zvarritjet dhe finalizuar në kohë procedurën e prokurimit.

Në muajin dhjetor nisi procesi i konsultimit publik, për marrjen e komenteve, mendimeve dhe sugjerimeve, të cilat shërbejnë në përmirësimin e projektligjit.

Në kuadër të këtij procesi, projektligji u publikua në datë 24 Dhjetor në platformën e konsultimit publik, sipas parashikimeve të Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, si dhe në faqen zyrtare të APP: <http://www.app.gov.al>.

Gjithashtu, APP ia komunikoi draftin, organizmave ndërkombëtarë, institucioneve, me të cilat bashkëpunon ngushtësisht gjatë ushtrimit të detyrave të saj, si dhe të gjitha njësitë të qeverisjes vendore.

2- Në cilësinë e kryesueses së grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e projektligjit “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, APP ka bashkëpunuar me Ministrinë e Mbrojtjes, gjatë gjithë vitit 2019, për ndjekjen e procesit të konsultimit të këtij projektligji dhe trajtimin e komenteve të institucioneve të ndryshme, për çështje që i adresohen projektligjit.

Projektligji për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare synon krijimin e një baze të plotë rregullatore për procesin e prokurimit në këtë fushë, me përafrim të pjesshëm të Direktivës 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009 “Për koordinimin e procedurave për dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe që ndryshon Direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE”.

3.1.2. NDRYSHIME NË DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT

Duke marrë shkas nga problematikat e ndeshura në praktikë nga autoritetet kontraktore gjatë procesit të prokurimit, por edhe si rezultat i bashkëpunimeve që APP ka patur me institucione të tjera si, Autoriteti i Konkurrencës dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, gjatë këtij viti është punuar për ndryshimet e nevojshme në përmirësimin e Dokumentave Standarde të Tenderit (në vijim “DST”), për punë/mallra/shërbime.

Gjatë vitit 2019 ka pasur 3 (tre) vendime të APP për shtesa dhe ndryshime të DST, konkretisht: Vendimi Nr. 1, datë 01.02.2019, Vendimi Nr. 2, datë 08.03.2019 dhe Vendimi Nr. 6, datë 20.06.2019.

Këto shtesa dhe ndryshime janë bërë:

- në kuadër të reflektimit të ndryshimeve ligjore, lidhur me deklarin e gjendjes gjyqësore jo vetëm për operatorin ekonomik si subjekt juridik, por edhe për individët përfaqësues të subjekti,;
- shmangien e problematikave sa i takon procesit të vlerësimit të ofertave në marrëveshjet ku objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj/zëra;
- si rezultat i bashkëpunimit që APP ka patur me institucionin e Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim ndalimin e marrëveshjeve në oferta ndërmjet operatorëve ekonomikë, në formën e konsul-



timeve, komunikimeve, marrëveshjeve apo kontratave me ndonjë konkurrent, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve, të cilat lidhen me një procedurë prokurimi.

- si rezultat i bashkëpunimit që APP ka patur me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me qëllim garantimin e respektimit të kërkesave që rrjedhin nga dispozitat e Kodit të Punës dhe legjislacionit të punës në tërësi, si respektim të parimit të mos-diskriminimit dhe trajtimit të barabartë të meshkujve dhe femrave nga ana e bizneseve që operojnë në Shqipëri.

3.1.3. UDHËZIME, REKOMANDIME DHE NJOFTIME TË APP

Gjatë këtij viti, për t'i ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore, APP ka punuar për hartimin e 3 (tre) Udhëzimeve, 1 (një) Rekomandimi dhe 12 (dymbëdhjetë) Njoftimeve.

Tabela 56

Udhëzime	Rekomandime	Njoftime
3	1	12

Nëpërmjet këtyre udhëzimeve, rekomandimeve, dhe njoftimeve, APP ka pasur si qëllim asistimin dhe sqarimin e autoriteteve kontraktore hap pas hapi, sa i takon procesit të prokurimit, në kuadër të çdo reforme të ndërmarrë si në aspektin rregullator ligjor, ashtu edhe ato të lidhura me aspekte teknike të këtij procesi.

Në këtë kontekst përmendim, udhëzimet:

- për procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë;
- **për përdorimin e Marrëveshjes Kuadër.**

Ndërkohë, me qëllim rritjen e performancës së menaxhimit të fondeve dhe nevojave nga autoritetet kontraktore, si dhe mirëfunksionimin në tërësi të sistemit të prokurimit publik rekomandimet dhe njoftimet e vazhdueshme të APP, kanë konsistuar kryesisht:

- **nxitjen dhe orientimin e autoriteteve kontraktore, mbi shpalljen e procedurave të prokurimit,** për objektet (mall/punë/shërbim) të parashikuara për vitin 2020, përse kohë që fondet i kanë të parashikuara dhe në çdo rast brenda kufirit buxhetor për vitin 2020;
- **mbajtjen parasysh të kërkesave ligjore** për ndalimin e dhënies së kontratave publike, operatorëve ekonomikë, të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për një listë të veprave penale, sipas ligjit, qoftë si subjekt juridik, por edhe kur individët përfaqësues të subjektit kanë një dënim të tillë;
- mënyrën e kryerjes së procesit të verifikimit të subjekteve në regjistrin e gjendjes gjyqësore;
- **respektim i kuadrit rregullator** për disiplinimin e angazhimeve buxhetore, për moszhvillim të procedurave të prokurimit mbi kufirin e prokurimit me vlerë të vogël të parashikuar për t'u zhvilluar brenda vitit 2019, për të cilat autoritetet kontraktore i kanë patur fondet në fillim të vitit dhe nuk i kanë hedhur apo krijuar elementë/zë në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit deri në datë 15 tetor 2019;
- mbi gjetjet e evidentuara, në kuadër të procesit të raportimit mbi procesin e zbatimit të kontratave, me qëllim vlerësimin e tyre për minimizimin e problematikave që dalin gjatë ecurisë së këtij procesi;
- sjelljen në vëmendje të operatorëve ekonomikë për më tepër përgjegjshmëri në dhënien e ofertave gjatë fazës së përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, kur i kërkohet nga autoriteti kontraktor ;
- sjelljen në vëmendje të autoriteteve kontraktore, që të respektojnë që gjatë zhvillimit të prokurimit me vlerë të vogël, për shërbimet e mbikëqyrjes dhe/ose kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim, të mbajnë në konsideratë parashikimet ligjore të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, dhënë informacionin e nevojshëm mbi grupin tarifor respektiv, ku bën pjesë objekti për të cilin kërkohet shërbimi.



Gjatë këtij viti, APP ka bashkëpunuar me disa institucione si, Autoriteti i Konkurrencës, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në kuadër të memorandumeve dy palëshe me këto institucione.

Gjithashtu, APP ka adresuar pranë institucioneve kompetente edhe problematikat e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrave të saj, për të cilat ka kërkuar bashkëpunimin e tyre si, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj.

Më konkretisht:

- APP në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi, në muajin prill, me qëllim bashkëpunimin ndërmjet palëve, në funksion të rritjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në prokurimet publike, ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë në procesin e prokurimit për paraqitjen e ofertave në mënyrë të pavarur. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, është dakordësuar për përfshirjen e një deklarate “Për paraqitje oferte të pavaruar”, në DST për punë, mallra, shërbime, ashtu siç relatuam edhe më lart, janë përcjellë disa raste **për hetim pranë Autoritetit të Konkurrencës, sa i takon fushës së veprimtarisë së këtij institucioni**, si dhe është nxjerrë një njoftim i përbashkët për shmangien e rasteve kur gjatë procesit të përlllogaritjes së fondit limit operatorët ekonomikë japin oferta shumë herë më të larta se në krahasim me ofertat që ato dorëzojnë për këtë procedurë prokurimi;
- APP në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi, në muajin qershor, me qëllim bashkëpunimin për garantimin e respektimit të të drejtave të punonjësve femra dhe, jo vetëm, sikundër parashikuar nga Kodi i Punës dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij nga Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në kuadër të këtij memorandumi palët janë angazhuar për shkëmbimin në mënyrë reciproke të informacionit për çështje të veçanta, për të cilat institucionet kanë interes të përbashkët, në respektim të legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të punës dhe barazisë gjinore. **Nga komunikimi ndërmjet dy institucioneve kanë rezultuar raste të operatorëve ekonomikë të listuar si fitues në procedurat e prokurimit të penalizuar nga ky Inspektorati, për mosrespektim të legjislacionit të punës. Këto raste janë objekt verifikimi nga APP.**
- Në vijim të angazhimit të ndërmarrë nga **Marrëveshja e Bashkëpunimit me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit APP ka vijuar komunikimin periodik, (çdo tre muaj) për përcjelljen e të dhënave mbi njoftimet e fituesit në procedurat e prokurimit që kanë si objekt produktet ushqimore. Nga komunikimi ndërmjet dy institucioneve kanë rezultuar raste të operatorëve ekonomikë të listuar si fitues në procedurat e prokurimit me objekt produkte ushqimore të cilëve iu ishte hequr licenca përkatëse apo nuk plotësonin kushtet për ushtrimin e aktivitetit. Këto raste janë objekt verifikimi nga APP.**

Përveç bashkëpunimeve në kuadër të Memorandumeve me institucionet e sipërcituara, APP ka bashkëpunuar gjithashtu edhe me institucione të tjera, si:

- **Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, sa i takon** trajtimit me prioritet të kërkesave të autoriteteve kontraktore, në lidhje me procesin e verifikimit të personave që rezultojnë me historik dënimi, si dhe mundësimin e zgjidhjes nga këto institucione të problematikave dhe udhëzimin e drejtë të autoriteteve kontraktore, me qëllim lehtësimin e procesit të verifikimit;
- **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e institucionit kompetent për hartimin e dokumentave të ankandit, duke i kërkuar marrjen e masave për rregullimin e DST te ankandit, marrë shkas nga kërkesa të paraqitura në APP nga autoritete shitëse për problematikat e ndeshura në legjislacionin e ankandit publik;**



- **Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, lidhur me problematikat në prokurimin e objektit: “Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, sa i takon licencimit të subjekteve që operojnë në këtë fushë, të cilat janë bërë prezent në APP nga vetë autoritetet kontraktore;
- **Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, si autoritete kontraktore që, prokurojnë shpesh nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër kategori të caktuar mallrash dhe shërbimesh, edhe në cilësinë e organit qendror blerës. APP, në funksion të rolit të saj, si rregullator i sistemit të prokurimit publik, i ka kërkuar këtyre institucioneve një vlerësim të zbatueshmërisë së marrëveshjeve kuadër nga autoritetet kontraktore të varësisë gjatë kësaj periudhe, si dhe analizim të vazhdueshëm të problemeve gjatë zbatimit të minikontratave të prokuruarra me marrëveshje kuadër;
- **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë**, për rishikimin e Udhëzimit, nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e Buxhetit për vitin 2019”, sa i takon detyrave të lëna për APP, si dhe orientimin e degëve të thesarit nëpër rrethe për zbatimin e drejtë të këtij Udhëzimi, si dhe rekomandimit të APP, për lejimin e fillimit të procedurave nga autoritetet kontraktore për sa kohë që fondet i kanë në buxhetin 3 vjeçar të miratuar me ligj, pa i lidhur detyrimisht me kalimin e fondeve në llogaritë e autoriteteve kontraktore;
- **Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve**, në lidhje me vërtetimet që lëshohen nga Administrata Tatimore për operatorët ekonomikë, që kërkojnë të marrin pjesë në procedura prokurimi, duke kërkuar edhe konfirmim nga ky institucion, për sa i takon trajtimit të rasteve kur subjektet rezultojnë me gjoba në proces apelimi;
- **Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme**, së cilës i është përcjellë një informacion mbi kuadrin rregullator të prokurimit publik në fuqi dhe veçanërisht sa i takon pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë të huaj në procedurat e prokurimit publik, me qëllim dërgimin e tij pranë përfaqësive diplomatike të huaja, për t’i bërë me dije këto të fundit mbi sigurimin e transparencës së zhvillimit të procedurave të prokurimit publik në Shqipëri, si dhe integritetit të tyre;
- **Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik**, në cilësinë e institucionit që si mision ka garantimin e zbatimit të ligjshmërisë fondeve publike, duke i referuar për kompetencë raste të konstatuara, të cilat lidhen me probleme gjatë zbatimit të kontratës publike;
- **Ministrinë e Drejtësisë**, së cilës i është referuar problematika e ndërhyrjes së përmbaruesit gjyqësor privat për të kërkuar pagimin e shpenzimeve gjyqësore, pa lënë asnjë afat kohor për palën humbëse të shlyejë vullnetarisht pagesën, si dhe problematikën që lidhet me tarifat e larta të shoqërive përmbarimore private të cilat rëndojnë në mënyrë të pajustificuar buxhetin;
- **Task Forcën Ndërinstitucionale Antikorrupsion**, si dhe **Departamentin e Administrimit të Transparencës dhe Antikorrupsionit në Kryeministri**, duke i përcjellë për vlerësim dhe verifikim raste të denoncuar pranë APP, për të cilat kjo e fundit nuk ka kompetencë, referuar parashikimeve të legjislacionit të prokurimit publik;
- **Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit**, së cilës i është kërkuar bashkëpunim me qëllim përcaktimin (për aq sa është e mundur), të llojit të certifikatave të cilësisë të nevojshme për kategori mallrash/shërbimesh/punësh publike në procedurat e prokurimit publik që ndërmerren nga autoritetet kontraktore.



4. TREGUES TË VEPRIMTARISË KËSHILLUESE DHE PËRFAQËSUESE TË APP GJATË VITIT 2018

4.1. PRAKTIKAT E SHQYRTUARA PËR DHËNIE MENDIMESH, KËSHILLA APO UDHËZIMESH

APP, në zbatim të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fushën e prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore apo edhe të operatorëve ekonomike për përjashtimin e subjekteve të ndryshme nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe koncesioneve/ppp.

APP ka asistuar autoritetet kontraktore, duke trajtuar kërkesat e paraqitura prej tyre në rrugë shkresore, elektronike apo edhe në oraret zyrtare të caktuara për takim, nga dita e hënë në të enjte pranë zyrave të APP.

Problematikat e asistuara kanë pasur të bëjnë me çështje dhe paqartësi të ndryshme, gjatë procesit të prokurimit, të tilla si :

- mënyra e vlerësimit të ofertave në marrëveshjet kuadër, kur objekt prokurimi përbëhet nga disa zëra ;
- procedurën që duhet të ndjekin autoritetet për plotësimin e nevojave të tyre për mallra/shërbime, kur procedurat konkurruese të prokurimit vazhdojnë t'i kenë të pezulluara nga KPP dhe kontratat për mbulimin e objektit të prokurimit i kanë të përfunduara ;
- verifikimi në regjistrin elektronik i gjendjes gjyqësore, ku autoritetet kontraktore i duhet të bëjnë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave në cilësinë e administratorit, ortakut etj të operatorit ekonomik. Nisur nga shpeshtësia e kërkesave, APP ka adresuar problematikën, pranë Ministrisë së Drejtësisë ;
- ankesa nga operatorët ekonomikë lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, por edhe në lidhje me procedurat e tjera të prokurimit, në proces.

Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të VKM Nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, me të cilën u bënë ndryshime në pagën minimale, duke filluar nga data 01.01.2019, shumë autoritete kontraktore kanë kërkuar mendim, sa i takon reflektimit të këtij ndryshimi në kontratat e nënshkruara për ruajtjen e objekteve me roje private.

Kërkesa të shumta për mendim janë paraqitur, gjithashtu, në adresën elektronike të APP, edhe pas ngjarjes së tërmetit të datës 26.11.2019, lidhur me zbatimin e legjislacionit sa i takon plotësimin të nevojave emergjente të shkaktuara nga kjo ngjarje.

Në këtë kuadër janë shqyrtuar një numër i konsiderueshëm praktikash, për mendime, këshilla apo udhëzime në ndihmë të autoriteteve kontraktore/operatorëve, mendime për projektvendime të ndryshme, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore apo edhe të operatorëve ekonomike për përjashtimin e subjekteve të ndryshme nga e drejta për të përfituar fonde publike.

Gjatë vitit 2019, APP ka patur komunikime me institucione të ndryshme dhe kryesisht me:

- i) autoritete të ndryshme kontraktore dhe operatorë ekonomikë, të cilët kanë kërkuar mendime dhe sqarime për paqartësi mbi çështje në fushën e prokurimit publik dhe të ankandit publik;
- ii) institucione të qeverisjes qendrore (ministri), në kuadër të dhënies së mendimeve mbi projektvendime apo projektligje që kalojnë për miratim në Këshillin e Ministrave, në fushën e prokurimit publik/koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandeve publike;
- iii) Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, në lidhje me informacione të ndryshme të kërkuara nga ana e tyre



mbi procedurat e prokurimit të kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore, studio të ndryshme ligjore, të cilat në bazë të së drejtës për informim kanë kërkuar vënien në dispozicion të dokumentave të procedurave të prokurimit apo kanë kërkuar informacion mbi procedura të caktuara prokurimi, organet e medias vizive apo gazetarë të ndryshëm, etj... ;

- iv) operatorë të ndryshëm ekonomikë, të cilët kanë kërkuar të pajisen me vërtetime ku pasqyrohet gjendja e tyre, si operatorë që nuk janë përjashtuar me një vendim të APP nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, si dhe operatorë të cilët janë ankuar në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, por dhe procedura prokurimi në proces;
- v) Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrit, mbi verifikimin e kërkuar për operatorë ekonomikë të caktuar, nëse ka patur një vendim përjashtimi për to nga APP;
- vi) Komisionin e Prokurimit Publik, i cili ndërmjet të tjera në vendimet e dhëna i ka kërkuar APP nisjen e hetimit administrativ për procedura të caktuara prokurimi, dhe veçanërisht për cënimin e fshehtësisë së procesit, në kuptim të nenit 25 të LPP.
- vii) operatorët ekonomikë, të cilët janë ankuar në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël;
- viii) Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, pasi bazuar në Ligjin Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka kërkuar verifikimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe personave të lidhura me to, nëse kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues në prokurimet me fonde publike.

Konkretisht, **numri total i praktikave të paraqitura në APP, në rrugë shkresore, për mendim, sqarim apo informacione nga institucione të ndryshme**, për çështje që lidhen me procesin e prokurimit publik, koncesioneve/PPP-ve, dhe ankandeve publike gjatë vitit 2019 **është 347**.

Përveç trajtimit të kërkesave të paraqitura në rrugë shkresore, APP ka qenë e angazhuar maksimalisht për trajtimin e menjëhershëm të çdo kërkesë të paraqitur edhe në adresën e saj elektronike.

Duke ju referuar numrit të kërkesave elektronike të trajtuara gjatë këtij viti rezultojnë se, janë trajtuar rreth **380 të tilla**. Operativiteti i APP, në përgjigjet e shpejta të çdo kërkesë për paqartësi që autoritetet kanë gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, ka bërë që në vitin 2019 numri i tyre të jetë më i lartë krahasuar me një vit më parë, ku janë trajtuar rreth **250 kërkesa** elektronike.

Në formë tabelore, këto të dhëna janë si më poshtë:

Tabela 57

Praktikat e shqyrtuara, në kuadër të asistencës ligjore, gjatë vitit 2019	
Lloji i kërkesës	Numri
Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi/komunikim me institucione të tjera, në rrugë shkresore	142
Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi/komunikim me institucione të tjera, në rrugë elektronike	380
Kërkesa për dhënie mendimi mbi projektivendimet/projektligjet e paraqitura	9
Verifikime të kërkuara nga DSIK	25
Vërtetime të lëshuara për operatorët ekonomikë që nuk janë në proces përjashtimi	48
Kërkesa të paraqitura nga Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor/inst të ndryshme	35
Ankesa nga operatorë ekonomikë	88
TOTALI	727

**4.2. SHQYRTIMI I RASTEVE për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**

Një ndër detyrat kryesore të APP, është edhe vlerësimi i rasteve për përjashtim nga e drejta për të përfutur fonde publike e operatorëve ekonomikë, raste këto të evidentuara gjatë procesit të verifikimit apo shqyrtimit të raporteve të organeve të autdimit që kryen APP, ose si rezultat i propozimeve të autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, organeve të tjera audituese në ushtrim të funksioneve të tyre, të cilët kërkojnë përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi publik, koncensionit/partneriteti publik privat apo procedura ankandi publik, për një periudhë të caktuar kohore.

Sa i takon kërkesave të paraqitura gjatë këtij, siç do e analizojmë edhe në vijim, në një pjesë të mirë të tyre kanë qenë të paplota, në kuptim të kushteve ligjore që kërkon neni 13/3 i LPP, për përjashtimin e një operatori ekonomik nga e drejta për të përfutur fonde publike.

Gjatë vitit 2019, APP ka marrë në shqyrtim **50 raste për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**, nga të cilët:

- 4 raste janë evidentuar gjatë verifikimit të procedurave të prokurimit/shqyrtimit të raporteve të organeve audituese nga APP;
- 3 raste janë propozuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;
- 2 raste janë propozuar nga Autoriteti i Konkurrencës;
- 30 raste janë propozuar nga autoritete kontraktore;
- 11 raste janë denoncuar nga operatorët ekonomikë.

Në formë tabelore po i paraqesim si më poshtë:

Tabela 58

Rastet e shqyrtuara për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	
Raste të evidentuara gjatë verifikimit të zbatimit të procedurave/shqyrtimit të rekomandimeve të organeve audituese, nga APP	4 raste
Propozime të iniciuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit	3 raste
Propozime të iniciuara nga Autoriteti i Konkurrencës	2 raste
Propozime të iniciuara nga Autoritetet Kontraktore	30 raste
Propozime të iniciuara nga Operatorët Ekonomikë	11 raste
TOTALI	50 raste

Nga 50 rastet e shqyrtuara, ka rezultuar se:

- 30 raste** referohen për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme sipas parashikimeve të nenit 13/3/a të LPP;
- 18 raste** referohen për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale;
- 2 raste** referohen në vendimin e dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës për marrëveshje të fshehta në oferta.

Tabela 59

Rastet e shqyrtuara për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, me bazë ligjore neni 13/3 i LPP	
Propozime për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme, sipas nenit 13/3/a të LPP	30 raste
Propozime për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale, sipas nenit 13/3/ç të LPP	18 raste
Propozime të bazuara në vendim të formës së prerë, të dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës për marrëveshje të fshehta në oferta, sipas nenit 13/3/d të LPP	2 raste
TOTALI	50



Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të 50 rasteve gjatë këtij viti, APP ka filluar procedimin administrativ për nga e drejta për të përfutur fonde publike për **30** operatorë ekonomikë, ndërsa në **20 raste** është arritur në përfundimin se, kërkesat nuk kanë qenë të plota, apo dokumentacioni provues/plotësues i paraqitur nga autoritete kontraktore edhe pas verifikimeve të kryera prej tyre, ka rezultuar se nuk kanë qenë kushtet e parashikuara nga ligji për nisjen e procedimit administrativ.

Tabela 60

Vlerësimi i rasteve për përjashtim	
Filluar procedimi administrativ	30 raste
Mos nisje të procedimit administrativ	20 raste
TOTALI	50

Vendime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur për **30 operatorët ekonomikë** është marrë vendimi për **përjashtimin** nga e drejta për të marrë pjesë në prokurime, për **20** prej tyre, sipas parashikimeve të nenit 13/3 të LPP, nga këta:

- **10 operatorë ekonomikë**, janë përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimet publike për shkak të keqinformimit dhe paraqitjes në tender të dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme, sipas përcaktimeve të **nenit 13/3/a** LPP, përkatësisht
 - 5 operatorë ekonomikë janë përjashtuar për shkak se kanë keqinformuar për qëllime kualifikimi, autoritetin kontraktor;
 - 5 operatorë ekonomikë janë përjashtuar për shkak se kanë keqinformuar dhe paraqitur dokumentacion me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.
- **8 operatorë ekonomikë** janë përjashtuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas përcaktimeve të **nenit 13/3/ç** të LPP.
- **2 operatorë ekonomikë** janë përjashtuar për shkak të vendimit të dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës për marrëveshje të fshehta në oferta, sipas përcaktimeve të **nenit 13/3/d** të LPP.
-

Tabela 61

Përjashtime me bazë ligjore neni 13/3 i LPP	
Përjashtuar për keqinformimi për qëllime kualifikimi (neni 13/3/a)	5 raste
Përjashtuar për paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi (neni 13/3/a)	5 raste
Përjashtuar për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale (neni 13/3/ç)	8 raste
Përjashtuar për marrëveshje të fshehta në oferta (neni 13/3/d)	2 raste

Vlen të përmendet se, në rastet e përjashtimit të operatorëve ekonomikë **në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi** janë konstatuar raste, si:

- keqinformim sa i takon informacionit të dhënë në vetdeklarimin e operatorit ekonomik mbi mosangazhimin e inxhinierëve të stafit të tij në kontrata të tjera;



- paraqitja e vetdeklarimit nga operatori ekonomik, duke vetdeklaruar se ka paguar detyrimet e kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe detyrimet tatimore, ndërkohë që nga verifikimi i kryer pranë organeve tatimore ka rezultuar se subjekti ka patur detyrime të papaguara;
 - paraqitja e licensës së shoqërisë si një licensë e vlefshme, ndërkohë që drejtuesi teknik i saj ishte larguar për shkak se ishte paisur me licensë për mbikqyrje dhe kolaudim punimesh;
 - paraqitja si pjesë e ofertës, e fletës së të dhënave të sigurisë së materialit për produktet e kërkuar, regjistruar nga një kompani në Francë, ndërkohë që ka rezultuar se regjistrimi i këtyre produkteve ishte anuluar me vendimin dhënë nga Gjykata kompetente në vendin e regjistrimit të produktit;
- Si raste të **konstatimit të dokumentave me të dhëna të rreme**, përmendim:
 - paraqitja në përmbushje të kriterëve për kualifikim të deklaratës, që operatori ekonomik nuk ka asnjë lloj detyrimi të pa paguar ndaj asnjë institucioni shtetëror, si gjoba, punime të pa realizuara etj. Ndërkohë, nga verifikimet e kryera ka rezultuar e kundërta që operatori ekonomik ka patur gjoba nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe nuk i ka deklaruar ato;
 - paraqitja në përmbushje të kriterëve për kualifikim të kontratës së ngjashme, vërtetimit për realizimin e saj dhe faturat tatimore, ndërkohë që nga verifikimet e kryera ka rezultuar se puna e paraqitur si eksperimente e ngjashme nuk është konfirmuar të jetë realizuar nga pala tjetër si dhe faturat tatimore janë deklaruar në sistemin tatimor pas zhvillimit të procedurës së prokurimit duke ndryshuar edhe datat e tyre;
 - paraqitja e vërtetimit që operatori ekonomik nuk ka detyrimeve ndaj OSHEE, pra që ka paguar energjinë elektrike, ndërkohë që nga verifikimet e kryera ka rezultuar se vërtetimi i paraqitur në tender nuk është lëshuar nga OSHEE, si dhe në periudhën e ofertimit operatori ekonomik ka patur detyrime për pagimin e energjisë elektrike;
 - paraqitja e lejes së drejtimit sipas kategorisë së kërkuar për një nga anëtarët e stafit të operatorit ekonomik ndërkohë që nga verifikimet pranë institucionit kompetent për lëshimin e lejeve të drejtimit ka rezultuar se, leja e drejtimit nuk është lëshuar për kategoritë e kërkuar dhe sipas asaj të paraqitur në tender nga ofertuesi;
 - Paraqitja nga operatori ekonomik, si pjesë e ofertes se tij e lejes së manovrimit të kërkuar për një nga anëtarët e stafit, ndërkohë që nga verifikimet e kryera pranë institucionit kompetent për lëshimin e lejeve të manovrimit ka rezultuar se, ajo i përket një personi tjetër.
 - Sa i takon rasteve të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore rezulton se, ka patur **8 vendime** për përjashtime të operatorëve ekonomikë.

Vendimet e përjashtimit të dhëna në këto raste kanë qenë kryesisht për mospërmbushje të detyrimeve kontraktore gjatë kontratës të nënshkruar në përfundim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, apo si rezultat i denoncimit të bërë nga AKU për heqje të licensës së subjektit për mosplotësim të kushteve të ushtrimit të aktivitetit, autoriteti kontraktor përkatës ka ndërprerë kontratën me subjektin në fjalë, duke konstatuar mospërmbushje të detyrimeve të saj. Gjithashtu, ka patur edhe raste të përjashtimit për mospërmbushje të kontratës së nënshkruar pas zhvillimit të një procedure konkurrese prokurimi.

Vendime për mospërjashtimin e operatorëve ekonomikë

Për **3 (tre) operatorë ekonomikë** është vendosur mos përjashtimi i tyre për shkak se, nuk plotësoheshin kushtet e parashikuara në nenin 13/3 të LPP.



Në formë tabelore, të dhënat për vendimet e mospërfjashtimit:

Tabela 62

Vendime mospërfjashtimi nga pjesëmarrja në prokurimet publike	
Vendime për mospërfjashtim, të mbështetura në parashikimet e nenit 13/3/a të LPP (për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi)	2 raste
Vendime për mospërfjashtim, të mbështetura në parashikimet e neni 13/3/ç të LPP (mospërfbushje të detyrimeve kontraktuale)	1 rast

Nga procedimet administrative të nisura ndër vite nga Gjykata Administrative e Apelit gjatë këtij viti është mbyllur vetëm një çështje gjyqësore, ku, APP ka dalë me vendimin e saj përfundimtar, për mospërfjashtimin e operatorit ekonomik. Në vendimin e dhënë nga Gjykata është vendosur se operatori ekonomik nuk ndodhej në kushtet e mospërfbushjes së detyrimeve kontraktore.

Pezullimi i procedimeve administrative

- Gjatë procedimit administrativ të nisur për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, në mbështetje të Kodit të Procedurave Administrative, gjatë këtij viti, është vendosur pezullimi i procedimit të nisur për 4 (katër) operatorë ekonomikë.
- Vendimi për pezullimin e procedimit administrativ, është marrë në kushtet kur ka rezultuar se, mospërfbushja e detyrimit kontraktual të pretenduar, ka qenë objekt i kërkesë padisë së ngritur pranë Gjykatës.

Procedimet administrative të nisura janë **ende në proces për 3 (tre)** operatorë ekonomikë.

Në formë tabelore, paraqesim të dhëna mbi procedimet administrative, të cilat rezultojnë të pezulluara, i paraqesim më poshtë:

Tabela 63

Procedime administrative që mbeten të pezulluara për shkak të vijimit të procesit gjyqësor	4
Në total, procedime administrative të pezulluara gjatë viteve 2015-2018	8

Në mënyrë të përmblodhur, më poshtë paraqesim në formë tabelore, trajtimin e të gjitha rasteve (50) të evidentuara për përjashtim të operatorëve ekonomikë nga e drejta për të përfituar fonde publike, gjatë vitit 2019:

Tabela 64

Trajtimi i rasteve për përjashtim, të shqyrtuara nga APP gjatë vitit 2019	
Vendimi	Numri
Vendime përjashtimi	20
Vendime mos përjashtimi	3
Procedime administrative të pezulluara	4
Procedime administrative në proces	3
Kërkesa të paplota	20
TOTALI	50



5. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË VERIFIKIMIT TË PROCEDURAVE

Në zbatim të detyrave të ngarkuara nga legjislacioni i prokurimit publik, veprimtaria verifikuese e APP, fokusohet në dy drejtime kryesore:

- Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës, nëpërmjet hetimit administrativ;
- Shqyrtimi i raporteve të organeve audituese, ku pasqyrohen gjetjet për procedurat e prokurimit të audituara dhe rekomandimet përkatëse.

5.1. VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË

Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore, pas fazës së nënshkrimit të kontratës, është një proces i vazhdueshëm i veprimtarisë së APP.

Nëpërmjet këtij procesi synohet në ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore për zbatimin me rigorozitet të legjislacionit të prokurimit publik, në procedurat e prokurimit që zhvillohen prej tyre.

Në rolin e saj, si rregullator i sistemit të prokurimit publik në vend, APP fokuson procesin hetimor në evidentimin e problematikave, që lidhen me respektimin e kërkesave ligjore, si vijon:

Në rolin e saj, si rregullator i sistemit të prokurimit publik në vend, APP fokuson procesin hetimor në evidentimin e problematikave, që lidhen me respektimin e kërkesave ligjore, si vijon:

- *përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (në rastet kur procedura e prokurimit përdoret në rrethana të caktuara siç është procedura “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”), plotësimin e kushteve ligjore dhe administrimin nga AK, të dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim;*
- mënyrën e përlogaritjes së fondit limit, argumentimin përkatës, si dhe administrimin nga AK, të dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim;
- hartimin e specifikimeve teknike, argumentimin përkatës, si dhe administrimin nga AK, të dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim;
- hartimin e kriterëve të pranimit, argumentimin përkatës, si dhe administrimin nga AK, të dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim;
- shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, sipas kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, trajtimin e barabartë të ofertuesve në procedurë;
- trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë, sipas afateve kohore në dispozicion të operatorëve ekonomikë;
- veprimet e tjera procedurale, që ndiqen nga autoriteti kontraktor gjatë procesit të prokurimit.

Nëpërmjet procesit të verifikimit, APP nuk ka për qëllim vetëm evidentimin e parregullsive dhe problematikave, penalizimin e personave përgjegjës, të cilët rezultojnë të kenë kryer veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit, por edhe analizimin e situatave dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për shmangien e këtyre veprimeve, në të ardhmen.

Po kështu, analizimi i konkluzioneve të arritura në përfundim të procesit të verifikimit, mund të shërbejë si bazë për nxjerrjen e rekomandimeve përgjithësuese, të cilat i shërbejnë të gjithë autoriteteve kontraktore, dhe si bazë për përmirësime të mundshme në legjislacionin e prokurimit publik.



Gjatë vitit 2019, në verifikimin e procedurave të prokurimit, APP ka proceduar si vijon:

- *Hartimi dhe zbatimi i një Plani Verifikimi të nisur në muajin Prill, ku janë përfshirë procedura prokurimi të llojit “E hapur”, “Kërkesë për propozim” dhe “Procedurë prokurimi me vlerë të vogël”, të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore.*

Konkretisht, procedurat e përfshira në këtë plan janë të ndara si vijon:

- **6 procedura prokurimi “E hapur”** (një procedurë e hapur – marrëveshje kuadër).
- **2 procedura prokurimi “Kërkesë për propozim”.**
- **8 procedura prokurimi me vlerë të vogël.**

Përzgjedhja e procedurave të hapura dhe kërkesë për propozim në këtë Plan, të zhvilluara nga institucione qendrore, është bazuar në problematikat e evidentuara nga APP, të lidhura me kriteret e kualifikimit, pas publikimit të procedurës në sistemin e prokurimit elektronik. Në kuadër të rolit asistues, megjithë rekomandimet e APP për hartimin e kriterëve të pranimit, ka rezultuar se disa institucione nuk kanë reaguar.

Procedurat në fjalë u përzgjedhën nga ato autoritete kontraktore, të cilat nuk kanë reaguar ndaj rekomandimeve të dhëna nga APP, sa i takon kriterëve të kualifikimit, gjatë fazës së pritjes së ofertave, duke u bazuar kryesisht në:

shpeshtësinë e mungesës së reagimit për rekomandime të dhëna nga APP, mbi kriteret e vendosura të kualifikimit;

autoritetet kontraktore, të cilat nuk kanë qenë së fundmi subjekte verifikimi.

natyrën e kontratës, duke përfshirë të tre llojet: punë, mallra dhe shërbime;

llojin e procedurës së prokurimit, ku, procedura “E hapur” dhe “Kërkesë për propozim” janë procedurat më të përdorshme nga autoritetet kontraktore;

vlerën e fondit limit.

Ndërsa, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të përfshira në këtë Plan Verifikimi, kanë qenë alei denoncimi në APP nga operatorë të ndryshëm ekonomikë.

Subjekt i këtij plani verifikimi kanë qenë **14 Autoritete Kontraktore** me një total prej **16 procedurash prokurimi, alei hetimi.**

Verifikimi i procedurave të lartpërmendura ka përfunduar dhe APP ka dalë me vendimet përkatëse.

- Hartimi dhe zbatimi i një Plani Verifikimi të nisur në muajin Tetor, ku janë përfshirë procedura prokurimi të llojit “E hapur” dhe “Procedurë prokurimi me vlerë të vogël”, të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore.

Konkretisht, procedurat e përfshira në këtë plan janë të ndara si vijon:

- **2 procedura prokurimi “E hapur”.**
- **10 procedura prokurimi me vlerë të vogël.**

Në këtë plan u përfshin për verifikim, procedura prokurimi të denoncuar pranë APP nga operatorë ekonomikë. Gjithashtu, një procedurë prokurimi me vlerë të vogël është dërguar për kompetencë nga Departamenti i Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit në Kryeministri, si rezultat i paraqitjes pranë kësaj të fundit, të një denoncimi nga operator ekonomik.

Gjatë kësaj periudhe, në APP (në adresën elektronike dhe në rrugë shkresore) është paraqitur një numër i madh denoncimesh, kryesisht për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të cilat nuk kanë proces ankimi, ku janë pretenduar shkelje të legjislacionit të prokurimit publik gjatë zhvillimit të tyre nga autoritetet kontraktore përkatëse, dhe është kërkuar nga APP kryerja e hetimit administrativ.



Subjekt i këtij plani verifikimi kanë qenë **12 Autoritete Kontraktore** me një total prej **12 procedurash prokurimi, objekt hetimi**.

Në zbatim të planit në fjalë të verifikimit, APP ka përfunduar hetimin administrativ për **9 procedura prokurimi**, për të cilat ka dalë me vendimet përkatëse.

- Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, APP ka përfunduar zbatimin e një Plani Verifikimi të nisur në fund të vitit 2018, në të cilin janë përfshirë procedura prokurimi me vlerë të vogël, të denoncuar nga operatorë ekonomikë, gjatë vitit në fjalë.

Konkretisht, APP ka verifikuar denoncime për **8 procedura prokurimi**, të zhvilluara përkatësisht nga **7 Autoritete Kontraktore**, për të cilat ka dalë me vendimet përkatëse.

- Verifikimi i rasteve, sa i takon respektimit të afateve të dërgimit të njoftimeve të kontratave të nënshkruara, për publikim, duke marrë shkas nga vonesat e autoriteteve në dërgimin e njoftimeve përkatëse, të evidentuara nga Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit, gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj të përditshme.

Konkretisht, nisur nga një mangësi e evidentuar nga APP në Sistemin e Prokurimit Elektronik, filloi hetimi administrativ për **1 procedurë prokurimi** “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” (shtesë kontrate), hetim, i cili u mbyll si rezultat i zgjidhjes së kontratës së nënshkruar nga autoriteti përkatës kontraktor dhe mos ardhjes së pasojave.

Gjithashtu, duke marrë shkas nga kërkesat e dy autoriteteve kontraktore në APP për kryerjen e veprimeve në sistem, sa i takon rihapjes së fazës “Njoftimi i fituesit” dhe fazës “Njoftimi i kontratës së nënshkruar”, në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, pasi u konstatuan veprime të autoriteteve në mosrespektim të afateve ligjore të ankimit, APP filloi hetim administrativ për **2 procedura prokurimi** “Kërkesë për propozim”.

Në përfundim të hetimit, APP ka dalë me vendimet përkatëse.

- Verifikimi i drejtpërdrejtë i rasteve të reklamuar nga operatorët ekonomikë ose të përcjella për aleistra në APP, nga institucione të tjera ligjzbatuese.*

Sikurse është cilësuar më lart, gjatë vitit 2019, në APP (në adresën elektronike dhe në rrugë shkresore) janë paraqitur denoncime nga operatorë të ndryshëm ekonomikë, me të cilat janë kundërshtuar veprime të autoriteteve kontraktore, në procedura prokurimi, të cilat janë përfshirë në planet e verifikimit të zbatuara në këtë periudhë.

Përveç sa më sipër, APP ka përfunduar verifikimin e **një procedure të hapur prokurimi**, hetimi aleistrative ale cilës ka nisur nga një kërkesë e paraqitur nga një institucion epror për institucion varësie, në të cilën pretendoheshin shkelje të legjislacionit të prokurimit alei. Në përfundim të hetimit aleistrative, APP ka ale me vendimin përkatës.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019, APP ka kryer verifikim edhe për **një procedurë prokurimi** “Kërkesë për propozim”, të propozuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me konstatimet e pasqyruara në vendimin e tij.



Në formë tabelore, të dhëna mbi verifikimet e përfunduara gjatë kësaj periudhe:

Tabela 65

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi	35 (duhet patur në konsideratë që disa autoritete kontraktore kanë qenë subjekt verifikimi për dy procedura)		
Vendime të nxjerra nga APP, me masa penalizuese	30		
Tërheqje vëmendje dhe orientim i përgjithshëm/mbyllje hetimi	5		
Procedura prokurimi të verifikuara	Procedura për punë publike	Procedura për mallra	Procedura për shërbime
(Total 37)	6	22	9

Tabela 66

Lloji i procedures se prokurimit	Numri
Procedurë e hapur	9
Procedurë kërkesë për propozim	5
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	23
TOTALI	37

5.2. SHQYRTIMI I RAPORTEVE TË ORGANEVE AUDITUESE

Shqyrtimi i raporteve të organeve audituese, është një ndër aktivitetet kryesore të veprimtarisë së APP, të përcaktuara në Ligjin Nr. 9643/2006 “Për prokurimin publik”.

Mbi këtë bazë, gjatë vitit 2019, APP ka bashkëpunuar me institucionet audituese në vend, si: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Audite të Brendshme të institucioneve, duke marrë në shqyrtim raportet përkatëse të auditimit (*pjesët takuese, ku trajtohen gjetje për prokurimet e audituara*), të dërguara për kompetencë në APP, nga këto institucione.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, është komunikuar me këto institucione, në çdo rast kur ka patur nevojë për plotësim të materialit të dërguar për shqyrtim në APP.

Gjithashtu, në kuadër të këtij bashkëpunimi, përfaqësues nga APP kanë marrë pjesë në tryezën e punës me temë: “Mbi një bashkëpunim efektiv ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe organeve të zbatimit të ligjit”, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë.

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit të dhëna në funksion të detyrave audituese, vështirësitë e hasura në zbatimin e rekomandimeve dhe masat që duhet të merren për përmirësimin e tyre. APP u fokusua kryesisht në çështjet e lidhura me shqyrtimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të pasqyruara në raportet përfundimtare të kontrollit, me qëllim përmirësimin e problematikave të hasura gjatë këtij procesi.

Gjatë shqyrtimit të çdo raporti auditues, APP ka respektuar të drejtën e subjektit të audituar/personave të evidentuar si përgjegjës nga organet audituese, për të paraqitur në APP, kundërshtimet e tyre mbi gjetjet e pasqyruara në raportet përkatëse.

APP ka konkluduar në vendimmarrjen përfundimtare të trajtimit të raporteve audituese, pas shqyrtimit,



analizimit dhe vlerësimit me kujdes, të çdo gjetje të pasqyruar në raport, nga institucioni auditues, si dhe të kundërshtimeve dhe sqarimeve të dërguara nga autoritetet e audituara.

Gjatë vitit 2019, nga APP janë shqyrtuar **23 raporte auditimi** për **23 Autoritete Kontraktore**, për të cilat APP ka dalë me vendimet përkatëse.

Në formë tabelore, të dhëna mbi numrin e raporteve të shqyrtuara, sipas organeve audituese:

Tabela 67

Institucioni auditues	Numri i raporteve
Kontrolli i Lartë i Shtetit	13
Audite të Brendshme të Institucioneve	7
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	2
Drejtoria e Inspektimit Financiar	1
TOTALI	23

APP ka shqyrtuar gjetjet për **190 procedura prokurimi**, përfshirë prokurime me vlerë të vogël.

Në formë tabelore, të dhëna mbi llojet e procedurave të prokurimit të trajtuara në raportet e organeve audituese, gjetjet e të cilave janë trajtuar nga APP:

Tabela 68

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	18
Procedurë e hapur	89
Kërkesë për propozim	54
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	29
TOTALI	190

5.3. GJETJET DHE PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA GJATË PROCESIT TË VERIFIKIMIT

Gjatë procesit të hetimit administrativ dhe shqyrtimit të raporteve audituese janë konstatuar mangësi dhe shkelje të ndryshme të legjislacionit të prokurimit publik, nga autoritetet kontraktore që kanë zhvilluar procedurat e prokurimit objekt verifikimi.

- I) Konstatimet dhe gjetjet e evidentuara **gjatë hetimeve administrative** konsistojnë kryesisht në:
- mungesën e argumentimit të **specifikimeve teknike** dhe dokumentimin e tyre me procesverbal.

Në disa procedura prokurimi të verifikuara është vërejtur se autoritetet kontraktore hartojnë specifikime teknike, por nuk i argumentojnë këto specifikime, si dhe nuk e dokumentojnë këtë proces. Mosveprimet në fjalë vijnë në kundërshtim me rregullat e prokurimit, sipas të cilave, autoritetet kontraktore kanë detyrimin të argumentojnë teknikisht dhe ligjërisht specifikimet teknike të vlerësuara për objektin e prokurimit, si dhe të dokumentojnë këtë argumentim në një procesverbal.



- në lidhje me **përlllogaritjen e fondit limit**, mangësitë e konstatuara i përkasin kryesisht procedurave të prokurimit për lidhjen e kontratave për punë publike.

Në disa raste është evidentuar se, çmimet e përdorura në preventiv nuk përputhen me çmimet përkatëse në manualët zyrtarë, edhe pse si referenca shënohen numrat e analizave në këto manuale, çka sjell si pasojë rritje të fondit limit.

Kjo mospërputhje ka rezultuar edhe në situatat kur, preventivi është hartuar nga një subjekt i licencuar jashtë autoritetit kontraktor, pasi titullari i autoritetit nuk ka caktuar një person ose grup pune për të marrë në dorëzim preventivin e punimeve dhe për të verifikuar përputhshmërinë e çmimeve të përdorura.

APP ka sjellë në vëmendje se, çmimet njësi për efekt të përlllogaritjes së fondit limit për punimet e ndërtimit, përlllogariten në bazë të çmimeve zyrtare sipas VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 "*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*" dhe / ose analizave të çmimeve, të hartuara sipas parashikimeve të VKM Nr. 514, datë 15.8.2007 "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar.

- mungesën e argumentimit të **kritereve të kualifikimit**, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kjo mungesë është konstatuar në pjesën më të madhe të procedurave të prokurimit të verifikuara, ndërkohë që argumentimi dhe dokumentimi me procesverbal i kritereve të veçanta të pranimit është detyrë e autoriteteve kontraktore, për të gjitha llojet e procedurave të prokurimit. Gjithashtu, në disa procedura të tjera të verifikuara, përveç bazës ligjore referuese, autoritetet nuk kanë dhënë asnjë shpjegim konkret mbi përcaktimin e tyre.

APP ka sqaruar autoritetet kontraktore se, në argumentimin e kritereve të kualifikimit duhet të jepen arsye konkrete, të lidhura me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit që autoriteti merr në konsideratë, në vendosjen e tyre.

hartimin e kërkesave të veçanta të kualifikimit që nuk kanë rezultuar në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe vlerën e përlllogaritur të tij.

Gjatë verifikimit, sa i takon procedurave të prokurimit për punë publike, ka rezultuar se, autoritetet kontraktore kërkojnë si kriter kualifikimi që ofertuesit të zotërojnë kategori licencash, të cilat nuk përputhen me natyrën dhe me vlerën e punimeve objekt kontrate dhe janë në kundërshtim me parashikimet e VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*", i ndryshuar.

Në kërkesën e kategorive të licensave, autoritetet nisen nga vlera totale e preventivit dhe jo nga vlera e punimeve të së njëjtës natyrë, ndërkohë që, në çdo rast, kategoritë e licensave duhet të jenë në përputhje dhe në përpjesëtim me vlerën e punimeve të së njëjtës natyrë dhe jo me vlerën totale të preventivit. Një kërkesë e tillë mund të sjellë si pasojë kufizim në pjesëmarrjen e operatorëve të interesuar ekonomikë, në kundërshtim me qëllimin e LPP.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, të cilët vlerësohen të domosdoshëm për realizimin e objektit të prokurimit, autoritetet kontraktore nuk hartojnë analiza teknike, duke u nisur nga grafiku i punimeve dhe orët e punës që duhen për të realizuar secilin prej zërave të preventivit, por përcaktojnë një numër punëtorësh në mënyrë të paargumentuar.

Gjithashtu, edhe në përcaktimin e llojit dhe të numrit të makinerive dhe mjeteve të kërkuara, autoritetet kontraktore përcaktojnë këto të fundit, nisur nga emërtimi i zërave të punimeve, por nuk analizojnë secilin zë për të përcaktuar orët e punës dhe rrjedhimisht numrin e mjeteve dhe makinerive të domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës.



Sa i takon certifikatave ISO të kërkuara, është vërejtur se, autoritetet nuk argumentojnë nevojën për certifikatat e kërkuara, si dhe nuk kërkojnë variantet e përditësuara të tyre. Madje, në disa raste, emërtimi i vendosur i certifikatës nuk përputhet me vetë llojin e certifikatës së kërkuar.

Edhe në procedurat e prokurimit për mallra dhe shërbime janë konstatuar kritere të veçanta kualifikimi, të cilat nuk janë hartuar sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoritetet nuk mirë-përcaktojnë periudhën kohore, për të cilën kërkohet eksperiencë e ngjashme, duke lënë jashtë këtij përcaktimi periudhën e vitit, në të cilin zhvillohet procedura. Një kërkesë e tillë mund të ndikojë në pjesëmarrjen e operatorëve, të cilët kanë realizuar kontrata të ngjashme gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, ka rezultuar se, në hartimin e këtij kriteri, autoritetet nuk specifikojnë dokumentacionin që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë, në varësi të eksperiencës së tyre me sektorin publik dhe atë privat.

Gjithashtu, është konstatuar se, autoritetet kërkojnë autorizimin e prodhuesit për shitjen e mallrave objekt prokurimi, pa u dhënë mundësinë ofertuesve të paraqesin autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi apo kërkojnë në mënyrë të paargumentuar disponimin e pajisjeve prodhuese, në pronësi ose me qira, duke mos lejuar ofertimin nga operatorë ekonomikë që nuk janë domosdoshmërisht prodhues të mallrave objekt prokurimi.

- mosplotësimin e formularëve **mbi gjendjen e konfliktit të interesit**, nga personat e përfshirë në procesin e prokurimit.

Në çdo rast të konstatimit të kësaj mungese, APP ka sjellë në vëmendje të autoriteteve kontraktore parashikimet përkatëse në rregullat e prokurimit publik, nga i cili rrjedh ky detyrim, dhe Udhëzimin e saj Nr. 3, datë 24.10.2016 “Mbi Deklarimin e Konfliktit të Interesit nga Zyrtarët e Prokurimit”. Çdo punonjës i autoritetit kontraktor, që merr pjesë në procesin e prokurimit, duhet të nënshkruajë një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

- në lidhje me **procesin e vlerësimit**, është konstatuar në mënyrë të vazhdueshme kualifikimi i ofertuesve që nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit.

Kryesisht, një mangësi e përsëritur është konstatuar në rastet e ofertimit nga bashkime operatorësh ekonomikë, ku, autoritetet përkatëse nuk vlerësojnë kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike në përputhje me përqindjen e punëve/shërbimeve/furnizimeve të marrë përsipër nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve, por i vlerësojnë këto kërkesa, pa respektuar përqindjen përkatëse.

Në kushtet kur, operatorët që janë pjesë e një bashkimi të përkohshëm për qëllime të realizimit të një kontrate publike, veçanërisht në ato për punë publike, marrin përsipër të realizojnë një pjesë të caktuar të kësaj kontrate, duhet të zotërojnë kapacitetet përkatëse në përputhje me pjesën e punëve/shërbimeve/furnizimeve që kanë marrë përsipër të realizojnë.

Bazuar në legjislacionin e prokurimit publik, autoritetet kontraktore duhet të vlerësojnë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomikë, është në përputhje me të gjitha kriteret e kualifikimit.

- sa i takon **procedurave të prokurimit me vlerë të vogël**, në rastet e verifikuara, APP ka konstatuar shkelje dhe mangësi në zbatimin e LPP, rregullave të prokurimit dhe udhëzimeve të miratuara nga APP, për këtë lloj procedure. Konkretisht, në disa raste janë vërejtur mangësi lidhur me përllogaritjen e fondit limit, ku autoritetet kontraktore nuk pasqyrojnë referencat e çmimeve të marra për këtë përllogaritje.

Gjithashtu, në mënyrë të përsëritur, lidhur me objektin e prokurimit për “Blerje tonera”, është vërejtur kërkesë e autoritetit kontraktor për tonera origjinalë, pa specifikuar termin “ose ekuivalent”, duke iu referuar vetëm prodhuesve të pajisjeve, për të cilat kërkohen këto tonera. Mospërcaktimi i këtij termi sjell si pasojë shmangien e prodhuesve të tjerë, që nuk janë prodhues të pajisjeve përkatëse, por që ofrojnë tonera ekuivalentë me origjinalët.



Në këto lloj procedurash janë konstatuar mangësi të lidhura edhe me hartimin e kriterëve të veçanta. Konkretisht, autoritetet kontraktore kërkojnë nga ofertuesit të kenë një eksperiencë të gjatë në treg, përtej parashikimeve ligjore, të disponojnë një numër të madh punonjësish, çertifikata ISO apo staf teknik që nuk konsiderohen në përputhje me objektin dhe përmasat e kontratës.

Lidhur me klasifikimin e ofertave, është evidentuar në disa raste skualifikimi i operatorëve ekonomikë me arsyen e paraqitjes së ofertave anomalisht të ulëta. Ndërkohë, për këto procedura prokurimi nuk zbatohen parashikimet ligjore në lidhje me ofertat anomalisht të ulta. Gjithashtu, në raste të tjera të verifikuara, është evidentuar mungesë e përcaktimit në ftesën për ofertë, të afatit kohor për paraqitjen e ofertuesit të renditur në vend të parë apo kërkesë e autoritetit për paraqitjen e operatorit fitues, në të njëjtën ditë me atë të zhvillimit të procedurës së prokurimit. Kalimi nga një operator ekonomik në tjetrin pa respektuar afatin 1-ditor, të përcaktuar në ftesën për ofertë, për paraqitjen e operatorit ekonomik të renditur në vend të parë, është një tjetër mangësi e vërejtur në këto lloj procedurash.

Gjithashtu, në disa procedura prokurimi nuk rezultoi i dokumentuar verifikimi i dokumentacionit në formë të shkruar, të operatorit ekonomik fitues. Ky verifikim ka për qëllim jo vetëm kontrollin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori fitues përpara lidhjes së kontratës, por edhe kontrollin mbi formën (original apo i noterizuar) e paraqitjes së këtij dokumentacioni.

Shkeljet dhe mangësitë e evidentuara gjatë procesit të verifikimit janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të APP (www.app.gov.al), në përfundim të çdo plani verifikimi, me qëllim njohjen e të gjithë autoriteteve kontraktore me këto mangësi dhe orientimin e tyre mbi respektimin e kërkesave përkatëse ligjore.

II) Konstatimet dhe gjetjet e evidentuara **në raportet e auditeve**, të cilat i referohen kontrollit të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës 2014-2019, konsistojnë kryesisht në:

- Mungesën e argumentimit dhe dokumentimit të përgatitjes së specifikimeve teknike. Në disa procedura të audituara që kanë objekt sisteme elektronike, është konstatuar mungesë e dokumentimit të procesit të hartimit të projektit, si dhe evidentimit të grupit të punës që ka përgatitur dhe miratuar projektin përkatës.
- Mungesën e përlogaritjes së fondit limit dhe dokumentimit përkatës.
- Mungesën e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe hartimin e kriterëve për kategoritë e licencave, stafin teknik, çertifikata ISO, disponimin e lejeve dhe/apo licencave, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.
- Në disa procedura është vërejtur kërkesë e autoritetit kontraktor për posedimin e çertifikatave ISO nga secili operator ekonomik, në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ndërkohë, që duhet të disponohen sipas natyrës së punimeve që secili anëtar merr përsipër të realizojnë. Gjithashtu, është evidentuar kërkesë e autoritetit, sipas të cilës, çdo anëtar i bashkimit të operatorëve të disponojë mjekun e shoqërisë, pa specifikuar se mjeku është detyrim vetëm për shoqëritë e ndërtimit, që kanë mbi 15 punonjës të siguruar.
- Disa autoritete kontraktore të pushtetit vendor kërkojnë nga ofertuesit në kriteret e veçanta të kualifikimit vërtetim të lëshuar nga vetë këto autoritete, mbi shlyerjen e taksave vendore, për një periudhë të caktuar kohore. Ndërkohë, ekzistenca apo jo e detyrimeve të operatorëve ekonomikë është një informacion që disponohet dhe është lehtësisht i verifikueshëm nga vetë autoriteti kontraktor, duke e bërë të panevojshëm përcaktimin e një kriteri të tillë.
- Gjithashtu, në disa raste ka rezultuar e përfshirë në kriteret e veçanta të kualifikimit, kërkesë e autoriteteve kontraktore për organizmimin e një vizite në kantier dhe paraqitjen e vërtetimit për pjesëmarrje në këtë vizitë, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit. Ndërkohë, kërkesa e vizitës në kantier është një mundësi që u jepet operatorëve ekonomikë të interesuar, për të vëzhguar terrenin ku do të realizohet objekti i kontratës, por kurrësi detyrim i ofertuesve për të kryer këtë vizitë dhe për t'u pajisur me dokumentacion provues.



- Mos-plotësimin e kriterëve të kualifikimit nga operatorët ekonomikë të kualifikuar. Gjithashtu, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të audituara, skualifikimi i ofertuesve në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi ofertat anomalisht të ulëta.
- Mungesën e verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në formë të shkruar nga operatori ekonomik i shpallur fitues dhe dokumentimit të këtij procesi.

Gjithashtu, në disa raporte audituese, objekt i të cilave janë procedura prokurimi me vlerë të vogël, mangësitë kryesore të evidentuara i referohen veçanërisht zhvillimit të këtyre procedurave në rrugë shkresore, në tejkalim të kufirit monetar të lejuar për zhvillimin e tyre në këtë formë. Mangësi u evidentuan edhe në zhvillimin e këtyre lloj procedurash në rastet e emergjencës, megjithëse APP ka detajuar në udhëzimet përkatëse për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, rregullat e zbatueshme në këto raste, si dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Gjatë verifikimit të procedurave të prokurimit, nëpërmjet kryerjes së hetimit administrativ apo shqyrtimit të raporteve të institucioneve audituese, APP ka analizuar shkeljet e kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore dhe ka udhëzuar këto autoritete për veprimet në pajtim me legjislacionin e prokurimit publik, që duhet të kryejnë në procedura të ardhshme prokurimi.

- Sa i takon procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, nga rastet e verifikuara, gjetjet kryesore lidhen me:
 - mospërcaktimin e termit “ose ekuivalent”, në kundërshtim me përcaktimet e LPP. Në çdo rast që autoritetet janë të detyruara të përmendin markë në specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, përfshirja e këtij termi është detyrim ligjor.
 - përcaktimin e kriterëve të pajustificuara, të cilat nuk vijnë në linjë me parashikimet përkatëse të LPP. Konkretisht, autoritetet kontraktore kërkojnë nga ofertuesit të kenë një eksperiencë të gjatë në treg, përtej parashikimeve ligjore, të disponojnë një numër të madh punonjësish, çertifikata ISO apo staf teknik që nuk konsiderohen në përputhje me objektin dhe përmasat e kontratës.
 - mosrespektimin e kërkesave në rregullat e prokurimit publik, sa i takon përcaktimit të dokumentacionit që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për të provuar eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, sipas sektorit publik apo privat, me të cilin kanë realizuar këto eksperiencat.
 - përcaktimin në ftesën për ofertë, të afatit kohor për paraqitjen e ofertuesit të renditur në vend të parë. Në disa raste rezultoi mungesë e një përcaktimi të tillë, në ftesën për ofertë, apo kërkesë e autoritetit kontraktor për paraqitjen e operatorit të renditur i pari në të njëjtën ditë me atë të zhvillimit të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me udhëzimet e APP.
 - mosdeklarimit mbi gjendjen e konfliktit të interesit, nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.
 - vlerësimin e operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë. Problematikë e përsëritur u konstatua skualifikimi i operatorëve ekonomikë me arsyen e paraqitjes së ofertave anomalisht të ulëta.

II) Konstatimet dhe gjetjet e evidentuara **në raportet e auditeve** konsistojnë kryesisht në:

- Mungesën e argumentimit dhe dokumentimit të përgatitjes së specifikimeve teknike. Në disa procedura të audituara që kanë objekt sisteme elektronike, është konstatuar mungesë e dokumentimit të procesit të hartimit të projektit, si dhe evidentimit të grupit të punës që ka përgatitur dhe miratuar projektin përkatës.
- Mungesën e përllogaritjes së fondit limit dhe dokumentimit përkatës.
- Mungesën e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe hartimin e kriterëve jo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi që i referohen specifikisht objektit përkatës të prokurimit.
- Mos-plotësimin e kriterëve të kualifikimit nga operatorët ekonomikë të kualifikuar. Gjithashtu, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të audituara, skualifikimi i ofertuesve në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi ofertat anomalisht të ulëta.



- Mungesën e verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në formë të shkruar nga operatori ekonomik i shpallur fitues dhe dokumentimit të këtij procesi.

Gjithashtu, në disa raporte audituese, objekt i të cilave janë procedura prokurimi me vlerë të vogël, mangësitë kryesore të evidentuara i referohen veçanërisht zhvillimit të këtyre procedurave në rrugë shkresore, në tejkalim të kufirit monetar të lejuar për zhvillimin e tyre në këtë formë. Mangësi u evidentuan edhe në zhvillimin e këtyre lloj procedurash në rastet e emergjencës, megjithëse APP ka detajuar në udhëzimet përkatëse për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, rregullat e zbatueshme në këto raste, si dhe dokumentacionin e nevojshëm.

5.4. MASAT ADMINISTRATIVE DHE RAPORTIMI

5.4.1. MASAT ADMINISTRATIVE

Në përfundim të procesit të verifikimit dhe shqyrtimit të raporteve të organeve audituese, në rastet kur janë konstatuar shkelje të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, APP në varësi të llojit të shkeljes, fondit limit të procedurave të prokurimit, rolit të personit në këto procedura, si dhe pasojave të ardhura, ka marrë vendim për penalizimin e personave përgjegjës, me gjobë ose ka propozuar marrjen e masës disiplinore ndaj tyre, sipas parashikimeve të nenit 72 të LPP.

- **Gjatë vitit 2019, nga hetimet administrative të kryera**, APP ka konkluduar me vendime për masa penalizuese, konform parashikimeve ligjore, në **30 raste**.

Në **4 (katër) raste** është mbyllur hetimi administrativ, pasi në dy prej tyre nuk kanë rezultuar shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit, të cilat janë të penalizueshme me masa administrative sipas Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ndërsa në dy rastet e tjera është mbyllur hetimi si rezultat i zgjidhjes së kontratës të nënshkruar nga autoriteti kontraktor dhe moszbatimit të saj, duke mos sjellë ardhjen e pasojave që çojnë në kushtet e marrjes së masave administrative.

Në **1 (një) rast** është tërhequr vëmendje dhe është dhënë orientim i përgjithshëm, duke patur në konsideratë korrigjimin e shkeljeve nga autoriteti kontraktor dhe më pas anulimin e procedurës së prokurimit.

- **Të dhënat statistikore** mbi masat administrative të vendosura nga APP, në përfundim të procesit të verifikimit, paraqiten në vijim:

Tabela 69

Gjobë	Propozim për masë disiplinore
38 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi	72 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi

Nisur nga roli i personit në procedurën e prokurimit të verifikuar, **të dhënat sipas numrit të autoriteteve kontraktore**:

Tabela 70

Penalizime me gjobë	
Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	6 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	6 Autoritete Kontraktore
Specialist i fushës	2 Autoritete Kontraktore



Tabela 71

Propozim për masë disiplinore	
Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Njësisë së Prokurimit	1 Autoritet Kontraktor
Person përgjegjës për prokurimin	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Komisionit për përgatitjen e Specifikimeve Teknike	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	20 Autoritete Kontraktore

Nga raportet e organeve audituese të shqyrtuara nga APP, për **23 Autoritete Kontraktore**, është konkluduar për **masa administrative**, konform parashikimeve ligjore, në të gjitha Autoritetet Kontraktore, subjekt auditimi.

Të dhënat statistikore mbi masat administrative të vendosura nga APP, në përfundim të shqyrtimit të raporteve të organeve audituese, paraqiten në vijim:

Tabela 72

Gjobë	Propozim për masë disiplinore
146 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi	60 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi

Nisur nga roli i personit në procedurat e prokurimit të audituara, **të dhënat sipas numrit të autoriteteve kontraktore**:

Tabela 73

Penalizime me gjobë	
Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	6 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Njësisë së Prokurimit	16 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Grupit për Përlogaritjen e Fondit Limit	3 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit për përgatitjen e Specifikimeve Teknike	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	13 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave	1 Autoritet Kontraktor



Tabela 74

Propozim për masë disiplinore	
Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	6 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Njësisë së Prokurimit	7 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	5 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	5 Autoritete Kontraktore

5.4.2. RAPORTIMI I MASAVE

Sipas kuadrit rregullator të prokurimit publik, autoritetet kontraktore kanë detyrimin për të raportuar në APP, mbi veprimet e ndërmarra në zbatim të masave të dhëna nga kjo e fundit, në vendimet e hetimit administrativ të procedurave dhe vendimet e shqyrtimit të raporteve të auditimit.

Vlen të theksohet se, në mjaft raste, APP i është dashur të përsërisë kërkesën për informacionin përkatës, drejtuar autoriteteve kontraktore, në mënyrë të veçantë sa i përket vendimeve ku është propozuar dhënia e masës disiplinore, pasi vendimet për penalizim me gjobë, kryesisht janë kontestuar në rrugë gjyqësore.

Raportimi i gjobave

a) Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për dënimin me gjobë të personave përgjegjës, **në përfundim të hetimeve administrative të kryera prej saj**, nga informacioni i administruar ka rezultuar se:

- janë kontestuar në rrugë gjyqësore **5 vendime**;
- është informuar APP për ekzekutim të gjobave të vendosura në **3 vendime**;
- në pritje të informacionit nga autoriteti kontraktor në **1 vendim**.

b) Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për dënimin me gjobë të personave përgjegjës, **në përfundim të shqyrtimit të raporteve të auditimit**, nga informacioni i administruar ka rezultuar se:

- janë kontestuar në rrugë gjyqësore **9 vendime**;
- është informuar APP se janë njoftuar personat e penalizuar dhe autoriteti kontraktor ka nxjerrë urdhër ekzekutimi/ekzekutuar në **4 vendime**;
- në pritje të informacionit nga autoriteti kontraktor në **5 vendime**.

Raportim i propozimeve për masë disiplinore

a) Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për propozim mase disiplinore ndaj personave përgjegjës, **në përfundim të hetimeve administrative të kryera prej saj**, nga informacioni i administruar ka rezultuar se:

- është dhënë masë disiplinore këshillim/tërheqje vëmendje/vërejtje/vërejtje me paralajmërim për përjashtim nga puna në **16 autoritete kontraktore**;
- **1 autoritet kontraktor** ka konkluduar për mosfillim procedimi disiplinor;
- **2 autoritete kontraktore** kanë informuar për ndërprerje të procedimit disiplinor;
- nuk është dhënë masë në **1 autoritet kontraktor**;
- në pritje të informacionit nga **3 autoritete kontraktore**.



b) Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për propozim mase disiplinore ndaj personave përgjegjës, në përfundim të shqyrtimit të raporteve të auditimit, nga informacioni i administruar ka rezultuar se:

- është dhënë masë disiplinore këshillim/tërheqje vëmendje/vërejtje/vërejtje me paralajmërim/pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë/largim nga detyra në **9 autoritete kontraktore**;
- nuk është vlerësuar dhënia e masës nga titullari në **1 autoritet kontraktor**;
- në pritje të informacionit nga **2 autoritete kontraktore**.

Në formë tabelore, të dhëna të përmbledhura mbi raportimet:

Tabela 75

Vendime të APP për penalizim me gjobë	27 vendime total
Kundërshtuar në gjykatë	14 vendime
Janë njoftuar personat dhe autoriteti kontraktor ka nxjerrë urdhër ekzekutimi/ekzekutuar	7 vendime
Në pritje të informacionit nga autoritetet kontraktore	6 vendime

Tabela 76

Vendime të APP për propozim mase disiplinore	35 vendime (patur në konsideratë që ka vendime njëkohësisht me masa administrative gjobë dhe propozim për masë disiplinore)
Është dhënë masë disiplinore këshillim/tërheqje vëmendje vërejtje/vërejtje me paralajmërim për përjashtim nga puna/ pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë/largim nga detyra	25 autoritete kontraktore
Është informuar për mosfillim të procedimit disiplinor	1 autoritet kontraktor
Është informuar për ndërprerje të shqyrtimit të procedimit disiplinor	2 autoritete kontraktore
Nuk është dhënë masë nga titullari	2 autoritete kontraktore
Në pritje të informacionit nga autoritetet kontraktore	5 autoritete kontraktore



6. PUBLIKIMI I VENDIMMARRJES

Gjatë këtij viti, në programin e transparencës, në faqen zyrtare të internetit të APP, është publikuar për të gjithë të interesuarit, formati me të dhënat përkatëse të çdo vendimi. Formatit ka pasqyruar informacionin përkatës, si: numrin dhe datën e vendimit, autoriteti kontraktor, subjekt verifikimi, numri dhe lloji i procedurave të verifikuara, përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe masat e dhëna nga APP, konform ligjit për prokurimin publik.

Në rastin e vendimeve të shqyrtimit të kërkesës për përjashtim nga pjesëmarrja në prokurimet publike/koncesionet dhe partneritetin publik privat/ankandet publike, të operatorëve ekonomikë, numrin dhe datën e vendimit, operatorin ekonomik, arsyet dhe referencën ligjore përkatëse për procedimin administrativ, konkluzionin dhe vendimin e dhënë nga APP.



7. PËRFAQËSIMI I APP NË PROCESET GJYQËSORE

Gjatë këtij viti, APP është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur, nga zyrtarët e autoriteteve kontraktore të dënuar me gjobë në përfundim të procesit të verifikimit të ushtruar nga APP apo nga shqyrtimi i raporteve audituese, si edhe nga operatorët ekonomikë, ndaj të cilëve është dhënë vendimi i përjashtimit nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

Konkretisht, gjatë vitit 2019 janë ndjekur **66 çështje** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndërkohë që **12 çështje** gjyqësore kanë qenë në Gjykatat Administrative të rretheve, **41** çështje pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe **26** pranë Gjykatës së Lartë.

Tabela 77

Çështjet Gjyqësore të ndjekura nga APP sipas shkallës së gjykimit	
Shkalla e gjykimit	Numri
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	66
Gjykata Administrative e Apelit Tiranë	41
Gjykata e Lartë	26
Çështje gjyqësore në rrethe	12
TOTALI	145

Tabela 78

Çështjet Gjyqësore të ndjekura nga APP në shkallë të parë, Tiranë, sipas llojit të kërkesë padisë	
Lloji i padisë	Numri
Kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	11
Kundër vendimeve të APP për dënimin me gjobë	55
TOTALI	66

Çështjet Gjyqësore kundër **vendimeve të dhëna nga APP për përjashtimin e një operatori ekonomik**

Po të marrim në analizë vendimet e dhëna nga APP për përjashtimin e një operatori ekonomik, (20 të tilla) konstatohet se, 11 prej tyre janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Tabela 79

Vendime përjashtimi	Ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë
20	11

Nga këto 11 ankime, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur:

- në **5 (pesë)** çështje rrëzim i kërkesë padisë;
- në **4 (katër)** çështje pranim i kërkesë padisë;
- në **1 (një)** çështje është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesë padisë;
- 1 (një)** çështje është ende në proces.




Tabela 80

Çështjet Gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë sipas vendimit të Gjykatës

Vendimi i gjykatës	Numri
Rrëzuar kërkesë padia	5
Pranuar kërkesë padia	4
Pranim pjesërisht i kërkesë padisë	1
Në proces	1
TOTALI	11

Grafiku 31



Vlen të theksohet se, gjatë këtij viti është gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë edhe ankimi ndaj 1 (një) vendimi të dhëna nga APP për përjashtimin e operatorit ekonomik gjatë vitit 2018. Kjo Gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.

- Duhet theksuar se, **nga 11 ankimet** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë dhe Vlorë, këto të fundit kanë marrë në konsideratë kërkesë paditë për dhënien e masës së sigurimit të padisë ose dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm **5 raste**, duke sjellë që vendimi i dhënë nga APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë të mos zbatohet deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Ndërsa, **në 3 raste të tjera**, Gjykata ka rrëzuar kërkesën për dhënien e masës së sigurimit të padisë.

Tabela 81

Pranim Kërkesë Padie për dhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm	Rrëzim Kërkesë Padie për dhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm
5	3

Duke krahasuar me vitin që kaloi, konstatojmë se kemi një ulje të numrit të rasteve/kërkesave të administruara për përjashtim të operatorëve ekonomikë, por një rritje të numrit të operatorëve ekonomikë të përjashtuar, çka tregon se kërkesat dhe propozimet për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, kanë qenë të plota konform parashikimeve ligjore.



Tabela 82

Kërkesa për përjashtim gjatë vitit 2018	Kërkesa për përjashtim gjatë vitit 2019
55	50

Tabela 83

Vendime për përjashtim gjatë vitit 2018	Vendime për përjashtim gjatë vitit 2019
17	20


- Çështjet gjyqësore kundër vendimeve të dhëna nga APP, **për penalizim me gjobë të personave në Autoritete Kontraktore**

Nga çështjet gjyqësore kundër vendimeve të APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit apo të shqyrtimit të raporteve të auditimit, Gjykata ka vendosur:

Tabela 84

Çështjet Gjyqësore kundër vendimit të dënimit me gjobë, sipas vendimit të gjykatës	
Vendimi i gjykatës	Numri
Rrëzuar kërkesë padia	29
Pranuar kërkesë padia	13
Pranim pjesërisht i kërkesë padisë	5
Në proces	8
TOTALI	55

Grafiku 32



Në përfundim, theksojmë se nga **57⁷** çështje gjyqësore në total (për përjashtim të operatorëve nga pjesëmarrja dhe penalizim të personave me gjobë), të cilat kanë përfunduar me dhënien e vendimit, **45 (dyzetepesë)** vendime janë të fomës së prerë, dhe për **12 (dymbëdhjetë)** është ushtruar e drejta e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

⁷ Gjithsej janë gjykuar 66 çështje gjyqësore, nga të cilat 9 janë ende në proces dhe 57 kanë përfunduar me dhënien e vendimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë.



Në formë tabelore janë si më poshtë:

Tabela 85

Formë e prerë	Të ankimueshme
45	12

Në gjykatën Administrative të Apelit gjatë këtij viti kanë përfunduar me vendim **6 çështje**, nga të cilat **2 çështje** kanë qenë të formës prerë dhe për **4 prej tyre** është lejuar rekursi pranë Gjykatës së Lartë nga APP.

Ndërsa, **35 çështje** janë akoma në gjykim pranë kësaj Gjykate.

Nga **6 (gjashtë)** çështje të përfunduara, **3 (tre)** prej tyre kanë qenë ankimim ndaj vendimeve të dhëna nga APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit apo të shqyrtimit të raporteve të auditimit dhe **3 (tre)** kanë qenë ndaj vendimeve të dhëna për përjashtimin e një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

Tabela 86

Çështjet Gjyqësore në Gjykatën e Apelit	
Vendimi i Gjykatës	Numri
Rrëzuar kërkesë padia	4
Pranuar kërkesë padia	2
TOTALI	6

Përveç çështjeve gjyqësore pranë gjykatave administrative, sikurse analizuar më sipër, APP është palë edhe në **26 çështje në Gjykatën e Lartë**, nga të cilat **25 çështje** janë të mbartura nga vitet e kaluara dhe **1 çështje** është dërguar nga APP këtë vit.

Në rastin e fletëthirrjeve për t'u paraqitur si palë ndërgjyqëse në Gjykatat Administrative në Rrethe, APP iu është drejtuar këtyre të fundit me kërkesë për shpalljen e moskompetencës, sipas ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Konkretisht, kanë ardhur fletëthirrje për **12 (dymbëdhjetë) çështje gjyqësore në rrethe**, të cilave i është dërguar kërkesa për shpalljen e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e çështjeve për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Tabela 87

Çështjet Gjyqësore në rrethe, sipas vendimit të gjykatës	
Vendimi i gjykatës	Numri
Pranim kërkesë për shpallje moskompetence	9
Refuzim kërkesë për shpallje moskompetence	2
Në proces	1
TOTALI	12



8. TREGUESIT E VEPRIMTARISË KOORDINUESE DHE ASISTUESE TË APP DHE MONITORIMIT TË KONTRATAVE

8.1. VEPRIMTARIA KOORDINUESE DHE ASISTUESE

Në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, APP ka vijuar punën për asistimin/këshillimin e autoriteteve kontraktore në fazën e hartimit të dokumentacionit të tenderit, si dhe monitorimin e këtij dokumentacioni dhe kriterëve kualifikuese, menjëherë pas shpalljes së procedurës nga autoritetet kontraktore, për t'ju ofruar asistencën e duhur, me qëllim garantimin e mirëzbatimit të legjislacionit në fuqi, eliminimin e rasteve që çenojnë konkurrencën e ndershme dhe që sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.


Sa më sipër, nga 5216 procedura, APP, ka monitoruar/asistuar dokumentet e tenderave të publikuara nga autoritetet kontraktore për 2368 procedura prokurimi, që rezulton në masën 45% të numrit të përgjithshëm të tyre. Nga numri i përgjithshëm i procedurave të monitoruara/asistuar, 55 procedura janë asistuar përpara publikimit në SPE, si konsultim paraprak me AK, dhe 2313 procedura janë asistuar pas publikimit të tyre.

Theksojmë gjithashtu se numri i procedurave të asistuar nga sektori kundrejt atyre të publikuara është edhe më e lartë, pasi në numrin total të procedurave të shpallura në SPE, përfshihen lotet, secila të ndara veç, ndërkohë që në numrin e përgjithshëm të procedurave të asistuar/monitoruara nga Sektori i Koordinimit, lotet trajtohen si një procedurë e vetme, duke mos u raportuar të ndara, duke rritur edhe në përqindje numrin e procedurave të asistuar kundrejt atyre të publikuara.

Ndër 2368 procedurat e asistuar nga APP, gjatë periudhës që analizohet:

- 646 procedura, ose 27 % e procedurave të asistuar, kanë rezultuar përgjithësisht në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për prokurimin publik, apo me fushat specifike ku ekzekutimi i objektit të kontratës që prokurohet shtrin veprimtarinë e tij ;
- 1722 procedura ose 73 % e procedurave të asistuar, kanë rezultuar me konstatime në lidhje me përmbushjen e kushteve të legjislacionit të zbatueshëm dhe për të cilat janë dërguar rekomandimet përkatëse autoriteteve kontraktore.

Grafiku 33





Nisur nga të dhënat e analizuara, rezulton se ka një rritje të përqindjes së numrit të procedurave që rezultojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi, për vitin 2019, ku përqindja e procedurave pa problematika në raport me procedurat e asistuar është në nivelin 27 % dhe atyre me problematika, në nivelin 73%, ndërkohë që në vitin 2018 këto përqindje kanë qenë respektivisht në nivelet 24,6 % dhe 75,4 %.

Nga analizimi i reagimit të autoriteteve kontraktore kundrejt rekomandimeve që APP jep në lidhje me problematikën e konstatuar në hartimin e dokumenteve standarde, veçanërisht të kriterëve të veçanta për kualifikim, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrje/konkurim në prokurim, rezulton se për periudhën që analizohet, nga 1722 procedura, për të cilat APP ka dërguar rekomandimet:


- në 483 raste, ose 28 %, autoritetet kontraktore nuk kanë reaguar ose nuk kanë reflektuar rekomandimet.
- në 1239 raste, ose 72%, autoritetet kontraktore kanë reflektuar rekomandimet e APP.

Në një këndvështrim krahasimor në lidhje me vitin 2018, ku përqindja e reflektimeve ka qenë në nivelin 54,5 % dhe përqindja e mosreflektimeve në nivelin 45,5 %, rezulton se ka një rritje të ndjeshme të rasteve në të cilat autoritetet kontraktore reflektojnë rekomandimet e dhëna nga APP në lidhje me hartimin e dokumenteve të tenderit.

Tabela 88

Procedurat	Viti 2018	Viti 2019
Procedura për të cilat janë dërguar rekomandime nga APP	1835	1722
Procedura për të cilat AK kanë reflektuar rekomandimet	1001	1239

Grafiku 34



Raporti i reflektimeve/mosreflektimeve, kundrejt rekomandimeve të dërguara nga APP, rezulton i ndryshëm ndër institucionet, sipas tipologjisë së tyre. Konkretisht:


- Për institucionet qendrore, mesatarja vjetore e nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 90%, ndërkohë që mesatarja vjetore e nivelit të mosreflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 10%.
- Për insitucionet vendore , mesatarja vjetore e nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 57%, ndërkohë që mesatarja vjetore e nivelit të mosreflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 43%.



- Për shoqëritë anonime me kapital shtetëror, mesatarja vjetore e nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 73%, ndërkohë që mesatarja vjetore e nivelit të mosreflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 27%.
- Për institucionet e pavarura, mesatarja vjetore e nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 68%, ndërkohë që mesatarja vjetore e nivelit të mosreflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 32%.

Paraqitja grafike e këtyre të dhënave është si më poshtë:

Grafiku 35





Nga sa më lart, rezulton se institucionet e qeverisjes vendore, në mënyrë të dukshme (43%), nuk reagojnë/reflektojnë ndaj rekomandimeve të dhëna nga APP, ndërkohë që institucionet qendrore reflektojnë në masën 90%.

APP ka monitoruar periodikisht të dhënat të cilat reflektojnë ndikimin që procesi i asistencës ka në rritjen e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit dhe rritjen e konkurrencës.

Nga analizimi i të dhënave që lidhen me numrin e ofertave të kualifikuara në krahasim me ato të skualifikuara, në procedurat e asistuar nga APP, rezulton se përqindja e ofertave të kualifikuara është më e lartë në procedurat që rezultojnë pa konstatime dhe në ato që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelet 59% dhe 54% të ofertave të paraqitura, ndërkohë që në procedurat që nuk kanë reflektuar rekomandimet e APP, ose i kanë reflektuar ato pjesërisht, këto përqindje janë respektivisht 47% dhe 45%.

Grafiku 36





Si konkluzion, vlerësojmë se procesi i asistencës së dhënë autoriteteve kontraktore në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka ndikuar në ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore për mirëzbatimin e legjislacionit të prokurimit publik dhe fushave të tjera të zbatueshme nga këto autoritete, me qëllim nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe trajtimin e barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

8.2. TË DHËNA MBI ZBATIMIN E KONTRATAVE


APP, në kuadër të procesit të raportimit të ecursisë së zbatimit të kontratave, ka shqyrtuar formularët standard të raportimit të dërguar, nga autoritetet kontraktore në adresën elektronike monitorimi.kontratat@app.gov.al dhe në rrugë zyrtare, raportet përfundimtare të cilësisë së zbatimit të kontratës dërguar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, si dhe çdo praktikë tjetër.

Referuar numrit total të kontratave të nënshkruara të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2019 në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sipas tipit të kontratave, shërbim, mall, punë, i publikuar në faqen zyrtare të APP është **4538** (katërmijë e pesëqind e tridhjetë e tetë).

Grafiku më poshtë paraqet numrin e kontratave të nënshkruara, të ndara sipas tipit të kontratës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2019:

Grafiku 37

KONTRATAT E NËNSHKRUARA NGA AUTORITETET KONTRAKTORE GJATË VITIT 2019



**Kontratat e raportuara nga AK-të sipas tipit të kontratës, gjatë vitit 2019.**

Nga totali i **4538** (katërmijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019, **389** (treqind e tetëdhjetë e nëntë) AK kanë raportuar për **2565** (dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) ose **57%** kontrata gjithsej, të cilave ju përfundonte afati gjatë vitit **2019**.

Nga totali i **2565** (dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) kontratave të raportuara nga **389** (treqind e tetëdhjetë e nëntë) AK, rezulton se:

- **1577** (njëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) ose **61%**, janë kontrata të tipit *Mall*, të raportuara nga **265** (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) AK.
- **421** (katërqind e njëzet e një) ose **17%**, janë kontrata të tipit *Shërbim*, të raportuara nga **191** (njëqind e nëntëdhjetë e një) AK.
- **567** (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) ose **22%**, janë kontrata të tipit *Punë publike*, të raportuara nga **137** (njëqind e tridhjetë e shtatë) AK.

Gjithashtu nga totali i **2565** (dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) kontratave të raportuara gjatë vitit 2019, rezulton se:


- **108** (njëqind e tetë) janë *Marrëveshje kuadër*, të raportuara nga **56** (pesëdhjetë e gjashtë) AK.
- **738** (shtatëqind e tridhjetë e tetë) janë *Mini kontrata*, të raportuara nga **45** (dyzet e pesë) AK.

Tabela 89

NUMRI I KONTRATAVE TË RAPORTUARA SIPAS AUTORITETEVE KONTRAKTORE DHE TIPIT TË KONTRATAVE GJATË VITIT 2019			
Tipi i Kontratës	Kontratat e Nënshkruara	Kontratat e Raportuara	Numri i Autoriteteve Kontraktore që kanë Raportuar
Gjithsej	4538	2565	389
Mallra	1990	1577 ose (61%)	265
Shërbime	1441	421 ose (17%)	191
Punë Publike	1107	567 ose (22%)	137

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e kontratave të raportuara nga AK-të, të ndara sipas tipit të kontratës, për vitin 2019:

Grafiku 38





Masat e marra ndaj AK-ve, mbi mos dërgimin në kohë të formularëve standard të raportimit për kontratat e përfunduara gjatë vitit 2019.

Duke ndjekur sistematikisht trendin e raportimeve, sektori i monitorimit të kontratave nëpërmjet Memos Nr. 7535 Prot., datë 20.09.2019, ka evidentuar situatën dhe me anë të e-mailit zyrtar, ka vendosur të tërheqë vëmendjen e **248** (*dyqind e dyzetë e tetë*) AK-ve që zenë **59%** të AK-ve në total, të cilat nuk kishin raportuar mbi zbatimin e ecursisë së kontratave të përfunduara gjatë vitit 2019.

Gjithashtu, në mënyrë të përsëritur në fund të muajit Dhjetor 2019, me anë të e-mailit zyrtar u kemi tërhequr sërish vëmendjen rreth **99** (nëntëdhjetë e nëntë) AK-ve, të cilave ju lamë afat deri më **15.01.2020**, për dërgimin e formularëve të raportimit për kontratat e përfunduara gjatë vitit 2019, nga ku pjesa më e madhe e tyre reflektuan.

Problematika të evidentuara nga AK gjatë zbatimit të kontratave

Nga analizimi i formularëve standard të raportimit, nisur nga i gjithë informacioni i dërguar konstatohet se, **13** (trembëdhjetë) AK, kanë raportuar për **23** (njëzet e tre) kontrata me problematika.

Konkretisht:

- Në **17** (shtatëmbëdhjetë) kontrata është aplikuar penalitet nga ana e AK-ve, për shkak të mosrespektimit të afatit të zbatimit të kontratës dhe për mospërbushje të kushteve kontraktuale nga ana e kontraktuesve.
- Nga **5** (pesë) AK është raportuar zgjidhja e kontratës dhe konfiskim i sigurimit të kontratës, për **6** (gjashetë) kontrata të nënshkruara, të cilave ju përfundonte afati gjatë vitit 2019.

Për sa më sipër po vijojmë komunikimet me AK, për të nisur procedurat për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

Problematika mbi raportimet e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, për vitin 2019 ka dërguar pranë institucionit tonë, raportin përfundimtar për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës për **22** (njëzet e dy) kontrata, të nënshkruara nga **14** (katërmëdhjetë) AK.

Në raportimet e dërguara, kjo agjenci ka përcjellë problematikat dhe rekomandimet sipas rasteve respektive, gjatë zbatimit të kontratave të lidhura nga këto autoritete.

Përsa i përket, rekomandimeve të lëna nga grupi i monitorimit të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, kemi sjellë në vëmendje të AK-ve nëpërmjet shkresave zyrtare, të mbajnë në konsideratë rekomandimet e grupit të kontrollit gjatë zbatimit të kontratës.

Problematika të evidentuara nga analizimi i formularëve standard të raportimit të zbatimit të kontratave.

Nga shqyrtimi i formularëve standard të raportimit të zbatimit të kontratave evidentohet se, shumë prej AK-ve, dërgojnë me vonësë formularët e raportimit të zbatimit të kontratës dhe me mangësi në plotësimin e të dhënave për çdo seksion respektiv.

Në çdo rast të evidentimit të mangësive të formularëve standard, për çdo paqartësi është komunikuar me anë të e-mailit zyrtar (rreth 300 komunikime elektronike), ku kemi sqaruar AK mbi mënyrën e raportimit gjatë zbatimit të kontratës dhe njëkohësisht ju kemi sjellë në vëmendje, dërgimin në kohë të formularëve të raportimit të zbatimit të kontratave që përfundonin gjatë vitit 2019.

Gjithashtu shumë AK-ve, ju kemi nisur me anë të e-mailit zyrtar, formularin standart të raportimit të zbatimit të kontratës, në rastet kur shpreheshin se nuk kishin dijeni apo nuk mund ta gjenin atë, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.



8.2.1. MONITORIME NË KUADËR TË TASK FORCËS ANTIKORRUPSION

Në lidhje me kontrollet e përbashkëta me Task-Forcën Antikorrupsion, Sektori i Monitorimit të Kontratave, është përfshirë në urdhërat e ngritur për Task-Forcën Antikorrupsion, në mbështetje të gërmës “C”, të pikës 5 dhe të paragrafit 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 241 datë 20.04.2018, “Për Miratimin e Planit të Veprimit” 2018-2020 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, të pasaportës së indikatorëve, krijimin, funksionimin dhe detyrat e komitetit koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion. Gjatë këtyre kontrolleve janë monitoruar zbatimet e kontratave në 9 autoritete kontraktore dhe në përfundim janë rekomanduar masat përkatëse.

Hartimi i draftit për monitorimin e zbatimit të kontratave për autoritetet kontraktore.

Referuar realizimit të objektivave për vitin 2019, Sektori i Monitorimit të Kontratave punoi me përkthimin dhe përshtatjen e draftit teorik dhe praktik, kontratave ndërkombëtare FIDIC (*Federata Ndërkombëtare e Inxhinierëve Këshillues (Konsulentë)*), produkt i Bankës Botërore. Ky draft përfaqëson në terma të përgjithshëm, një guidë teorike dhe praktike të shoqëruar me shembuj dhe situata, për të orientuar dhe ndihmuar AK-të për monitorimin dhe menaxhimin e zbatimit të kontratave publike (*të punëve, shërbimeve dhe mallrave*). Ai synon të ndihmojë AK-të, që të kuptojnë rëndësinë e monitorimit të zbatimit të kontratave publike dhe të zbatojnë metodikat më efikase të monitorimit, në varësi të tipit të kontratës së nënshkruar. Drafti ofron metodika praktike duke filluar që me fazën e planifikimit të procedurave publike deri në përfundim të zbatimit të një kontrate dhe do të miratohet pas hyrjes në fuqi të kuadrit të ri ligjor që po përgatitet në fushën e prokurimit publik.



9. INTEGRIMI EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE TË TJERA

9.1. INTEGRIMI EUROPIAN

Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, si edhe harmonizimi i sistemit të prokurimit në Shqipëri me praktikën më të mira evropiane dhe ndërkombëtare është një nga drejtimit kryesorë të veprimtarisë së Agjencisë së Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, APP, në cilësinë e kryesuesit të punës për Kapitullin 5 të acquis-së: Prokurimi Publik ka marrë të gjitha masat e nevojshme për koordinimin e aktiviteteve të nevojshme në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ky kapitull.

Konkretisht, APP ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme duke raportuar në mënyrë periodike mbi zhvillimet e ndodhura në këtë kapitull.

Sipas raportit vjetor për 2019 të Komisionit Evropian, Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje në prokurimin publik. Gjithsesi, duke pasur parasysh nevojën për përditësimin e legjislacionit në kuadër të praktikave më të mira ndërkombëtare si edhe për përmirësimin e tij të metejshëm në përputhje me acquis-në e BE-së për prokurimin publik, Komisioni Evropian ka rekomanduar marrjen e një sërë masave nga ana e Qeverisë Shqiptare si më poshtë:

- Transpozimi i Direktivave të BE-së në fushën e prokurimit publik, të vitit 2014, përfshirë direktivat për utilitetet dhe koncesionet, si dhe i Direktivës për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të autoriteteve kontraktore dhe organeve audituese;
- Miratimi i një strategjie për prokurimin publik në përputhje me objektivat e strategjisë për menaxhimin e financave publike.

□ Përafrimi i legjislacionit:

Duke pasur në konsideratë rekomandimet e Komisionit dhe institucioneve të tjera evropiane për përafrimin e legjislacionit me direktivat përkatëse në këtë fushë, APP është angazhuar në mënyrë aktive në përgatitjen e akteve ligjore për këtë qëllim, konkretisht:

1. Në kuadër të përmirësimit të legjislacionit shqiptar të prokurimit publik dhe të përafrimit të tij me direktivat e BE në këtë fushë APP ka punuar në mënyrë intensive për të finalizuar projektligjin e ri duke transpozuar Direktivën 2014/24/EU, Direktivën 2014/25/EU, si dhe Direktivën 2007/66/EC.

Në këtë kuptim, janë skanuar të gjitha nenet e direktivave të mësipërme me qëllim identifikimin e dispozitave që do të përfshihen në legjislacionin shqiptar, duke marrë në konsideratë mjedisin ku do të aplikohet ky legjislacion sidomos në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe institucional dhe kapacitetet administrative të institucioneve ligjzbatuese dhe të operatorëve ekonomikë subjekt i këtij legjislacioni.

Projektligji i përgatitur pritet të miratohet brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2020.

2. APP ka punuar intensivisht në bashkëpunim me SIGMA/OECD për përgatitjen e një Strategjie Kombëtare për Prokurimin Publik, duke përfshirë të gjitha fushat që lidhen me prokurimet siç janë prokurimet klasike, prokurimet në sektorët utilitarë, koncesionet dhe PPP-të, prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, prokurimi elektronik dhe rishikimi administrativ.



Objektivat kryesore që synojnë të përfshihen në dokument janë:

Përmirësimi i planifikimit të prokurimit publik;

- Rritja e transparencës;
- Përmirësimi i efikasitetit në përdorimin e fondeve publike;
- Përmirësimi i menaxhimit të kontratës;
- Përmirësimi i Kuadrit Institucional;
- Profesionalizimi i funksionit të prokurimit publik - Rritja e kapaciteteve administrative brenda AK-ve;
- Përmirësimi i sistemit të prokurimit të qendëruar;
- Përmirësimi i kuadrit të mekanizmave të rishikimit;
- Rritja e kapaciteteve ndërmjet organeve të auditimit dhe mbikëqyrjes, KPP dhe Gjykatave Administrative;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor që përfaqëson legjislacionin përkatës të BE-së;
- Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik;
- Garantimi i qëndrueshmërisë së procedurave të prokurimit publik;
- Nxjitja e pjesëmarrjes së SME-ve në procedurat e prokurimit publik.

Përveç APP-së, institucione të tjera u përfshinë në përgatitjen dhe zbatimin e Strategjisë dhe planit të veprimit, përkatësisht: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, ATRAKO, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia Qendrore e Blerjeve etj.

Aktualisht, një draftstrategji është duke u finalizuar, dhe pritet të dërgohet në Këshillin e Ministrave për miratim, së bashku me planin e veprimit, brenda tremujorit të dytë të vitit 2020.

3. Sa i përket prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, është finalizuar drafti i projektligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë për të cilin APP ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm si institucion drejtues i grupit ndërinstitutional të punës të ngritur për këtë qëllim, jo vetëm si hartues i projektligjit, por edhe si garantues i përputhshmërisë së tij me Direktivën 2009/81/EC të BE-së.

□ Aktivitete dhe takime në kuadër të procesit të integritetit evropian:

Më datë 13-15 Maj 2019, janë zhvilluar në Tiranë takime midis ekspertëve nga shërbimet e Komisionit Evropian dhe përfaqësuesëve të. Ky takim u zhvillua në kuadrin e një analize që Drejtoria e Përgjithshme për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit e Komisionit Evropian (DG NEAR) do të kryente më pas për sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, duke përfshirë koncesionet dhe partneritetin publik-privat.

Më datë 21 Maj 2019, u zhvillua në Bukuresht një workshop me temën: Eksperienca e Rumanisë dhe e shteteve të tjera anëtare në përafrimin e *acquis-communautaire* në fushën e Prokurimit Publik-mësimet e marra. Në këtë takim u shkëmbyen përvojat dhe e shteteve të Ballkanit Perëndimor sa i takon prokurimit publik si dhe të shteteve anëtare të BE si Rumania, Bullgaria dhe Polonia në përafrimin e Direktivave të BE-së në këtë fushë si dhe u dhanë komente edhe nga organizatat ndërkombëtare të pranishme si SIGMA, Banka Botërore dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Në kuadrin e përgatitjes për procesin screening, më datë 11 Korrik 2019, u zhvillua në Tiranë një workshop i organizuar nga GIZ me Grupin Nderinstitutional të Punes për Integritetin Evropian (GNPIE) për Kapitullin 5. Në atë takim u diskutua rreth përgatitjes për takimin bilateral për procesin screening si dhe për përgatitjen e Planit Kombëtar për Integritetin Evropian 2020-2022 sipas hapave të përcaktuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në vijim të takimit të fundit në kuadrin e procesit Screening, më datë 10 Shtator 2019, u zhvillua në Tiranë një workshop nga GIZ me GNPIE për Kapitullin 5 në të cilin u kryen mock exercises/ushtrime me modele



prezantimesh për pjesët që mbulon ky kapitull. Në këtë takim prezantoi APP sa i takon prokurimeve klasike dhe utilitetet, KPP sa i takon rishikimit administrativ dhe ATRAKO sa i takon koncesioneve dhe PPP-ve.

Më datë 17 Shtator 2019, u zhvillua në Tiranë një workshop nga GIZ me temën: Komunikimi i procesit prescreening në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky takim kishte si qëllim të shërbente si platformë diskutimi dhe shkëmbimi këndvështrimesh mbi komunikimin sa i takon pre-screening, e më gjerë integritet në BE. Gjithashtu, ky workshop shërbeu për të mësuar nga praktikat dhe përvojat e vendeve fqinje në proces negociatash mbi mënyrën e ngritjes dhe administrimit të një linje të qendëruar komunikimi sipas qasjes “të folurit me një zë” lidhur me negociatat për anëtarësim.

Në vijim të vizitave të ekspertëve të pavarur nga KE në Maj dhe analizës së hartuar prej tyre si dhe në kuadrin e hartimit të draftligjit për prokurimin publik, më datë 30 Shtator 2019 u zhvillua në Tiranë një takim midis përfaqësuesve të APP dhe ekspertëve nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm, Industrisë, Sipërmarrjes dhe SME-ve (DG GROW) të KE të cilët shprehën vlerësimin e tyre për cilësinë e draftit si dhe dhane komentet dhe sugjerimet e tyre.

Më datë 3 Tetor 2019, u zhvillua në Brusel Takimi i njëmbëdhjetë i Nënkomitetit për Çështjet Ekonomike dhe Financiare dhe Statistikat. Takimi i përqendrua rreth përparimit të arritur në plotësimin dhe përafrimin e legjislacionit, zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues, forcimit të kapaciteteve administrative, si dhe masat e ndërmarra për kapërcimin e vështirësive, që nga takimi i Nënkomitetit paraardhës, zhvilluar më datë 27 shtator 2018.

Më datë 14 Nëntor 2019, u zhvillua në Bruksel Takimi i dhjetë i Komitetit të Stabilizim-Asocimit gjatë së cilit APP raportoi në mënyrë të detajuar mbi progresin e arritur, në drejtim të përafrimit të legjislacionit në këtë fushë. Në këtë takim, u rekomandua që të ndërmarren përpjekje të mëtejshme për t'i ndërgjegjësuar kompanitë në lidhje me mundësitë e rishikimit dhe efektivitetin e sistemit të rishikimit.

Në kuadër të përgatitjes për negociatat me BE dhe në vijim të VKM nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” dhe Urdhrit të kryeministrit nr. 113, datë 30.08.2019, Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe platformës së partneritetit për Integrimin Evropian”, APP, si kryesuese për Kapitullin 5, ka shpallur kërkesën për shprehje interesi për të marrë pjesë në Tryezat e Partneritetit për këtë kapitull. Këto Tryeza janë të natyrës diskutuese dhe këshilluese në lidhje me fushat specifike që mbulohen nga ky kapitull si dhe rekomandimet dhe asistencat e dhëna nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, duke pasur parasysh që numri i kandidaturave të paraqitura ka qenë i pamfjetueshëm për të zhvilluar këto Tryeza, procesi është pezulluar.

9.2. BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË HUAJA

Gjatë këtij viti APP ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me SIGMA/OECD dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë në kuadër të nismave të reja ligjore sa i takon fushës së të prokurimit publik në Shqipëri.

Konkretisht, SIGMA ka vijuar të jetë ndihmesë shumë e madhe gjatë procesit të hartimit të projektligjit për prokurimin publik duke ofruar komente dhe sugjerime nga ekspertët e saj nëpërmjet komunikimeve elektronike të vazhdueshme si dhe organizimit të takimeve.

Gjithashtu, sikundër është përmendur dhe më sipër, një ndihmesë shumë e madhe SIGMA ka dhënë edhe në hartimin e draftit të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik dhe Planit të Veprimit, vecanërisht sa i takon kostimit të saj.

APP ka patur një bashkëpunim shumë të mirë edhe me zyrën e OSBE në Tiranë në kuadër të mbështetjes me asistencë teknike për hartimin e një udhëzuesi për profesionalizimin e prokurimit publik në Shqipëri dhe një plani trajnimi të detajuar për këtë qëllim.



Në vazhden e përgatitjes së hapjes të negociatave me BE, APP ka pasur një bashkëpunim shumë të ngushtë me GIZ të cilat ofruan asistencën e tyre teknike për procesin screening përmes përgatitjes së dokumentave të nevojshme në këtë kuadër, si dhe organizimit të workshop-eve.

Ndërkohë, APP vazhdon bashkëpunimin e ngushtë edhe me institucione të tjera ndërkombëtare si Banka Botërore dhe EBRD sa i takon çështjeve që lidhen me fushën e prokurimit publik.

9.3. BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË TJERA NË SHQIPËRI

Gjatë vitit 2019, APP ka vijuar më tej me bashkëpunime shumë të ngushta me institucionet e tjera shqiptare të cilat janë finalizuar me nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit, konkretisht: APP ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës i cili ka si qëllim bashkëpunimin ndërmjet palëve, në funksion të garantimit të konkurrencës së lirë dhe të ndershme në prokurimet publike dhe ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë në procesin e prokurimit për paraqitjen e ofertave në mënyrë të pavarur.

Gjithashtu, në kuadër të një projekti të Bankës Botërore nëpërmjet të cilit synohet të garatohet zbatimi i rregullave të Kodit të Punës në respektim të parimit të mos-diskriminimit dhe trajtimit të barabartë të meshkujve dhe femrave nga ana e bizneseve që operojnë në Shqipëri, APP ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Prokurimi Publik është pjesë e rëndësishme e tre Strategjive ndërsektoriale kryesore të Qeverisë Shqiptare, konkretisht, (i) Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, (ii) Strategjia Ndërsektoriale për Luftën kundër korrupsionit dhe (iii) Strategjia për Reformën në Administratën Publike.

Në këtë kuadër, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet e përfshira në këto strategji dhe sidomos Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si institucionet koordinuese, duke raportuar rregullisht për zbatimin e masave të parashikuara në këto dokumenta.

Duhet theksuar se, sa i takon zbatimit të masave sipas këtyre strategjive, APP ka përmbushur të gjithë indikatorët e parashikuar në strategjinë antikorrupsion për këtë vit si më poshtë:

- A.2.a: Përqindja e elementëve të modifikuar në Planet Vjetore të Prokurimit- 15% nga 50% të parashikuar
- A.2.b: Përqindja e kontratave të dhëna përmes procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës-3.2% nga 20% të parashikuar
- A.2.c: Përqindja e kontratave të ndryshuara gjatë vitit-1.6% nga 20% të parashikuar

Përmbushja e objektivave të mësipërm është tregues i punës së jashtëzakonshme të ndërmarrë nga APP në drejtim të përmirësimit të sistemit të prokurimit në Shqipëri.

Gjithashtu, ashtu sikundër u përmend dhe më sipër, APP ka pasur një bashkëpunim shumë të ngushtë me institucionet të cilat janë pjesë e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik me të cilat ka zhvilluar takime si dhe janë marrë komente dhe sugjerime.

APP është institucioni përgjegjës për këshillimin e Autoriteteve Kontraktore dhe dhënien e asistencës së vazhdueshme për realizimin e procedurave të prokurimit. Në këtë kuadër, APP ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me Autoritetet Kontraktore, duke ofruar vazhdimisht asistencën e saj si edhe duke dhënë sqarimet e nevojshme për të gjitha kërkesat e dorëzuara prej tyre në institucion me qëllim zbatimin sa më korrekt të legjislacionit të prokurimit publik.

Gjithashtu, në kuadër të përmirësimit të zbatimit të legjislacionit nga ana e autoriteteve kontraktore, APP ka vijuar të ketë një bashkëpunim shumë të mirë edhe me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), për organizimin e trajnimeve për autoritetet kontraktore.



Sikurse në vitet e kaluara, në ushtrimin e detyrave të saj ligjore, APP ka vijuar bashkëpunimin me institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik sidomos për sa i takon njoftimeve të dërguara nga KPP në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim që ky vendim të pasqyrohet në sistemin e prokurimit elektronik për mosprocedimin e mëtejshëm nga ana e autoriteteve kontraktore siç parashikohet edhe në dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik. Ky bashkëpunim evidentohet edhe në rastin e pasqyrimit në sistemin e prokurimit elektronik të vendimeve të dhëna nga KPP, në përfundim të shqyrtimit të ankesave.



10. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE DHE PUBLIKIMIN

10.1. VEPRIMTARIA E PUBLIKIMIT

Sektori i Publikimeve gjatë vitit 2019 ka publikuar në total 53 Buletine të Njoftimeve Publike me një numër faqe në total prej 24.741, ose mesatarisht 467 faqe për javë.

Përveç punës për përmbledhjen e informacionit për publikimin e Buletinit të Njoftimeve Publike punonjësit e ngarkuar me kryerjen e publikimit kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në miratimin e njoftimeve të kontratave të hedhura nga Autoritetet Kontraktore, me qëllim publikimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik. Ky publikim kryhet ditën e nesërme të punës në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sikurse e kërkon legjislacioni i prokurimit publik në fuqi dhe në Buletinin vijues.

Konkretisht, gjatë vitit 2019 janë miratuar për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike:

Njoftime për Procedura:

- 7,384 Njoftime Kontratash të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit ;
- 1,033 Njoftime për Marrëveshje Kuadër;
- 5,703 Njoftime Fituesi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit ;
- 812 Njoftime për Marrëveshje Kuadër të perfunduara me fitues;
- 4,538 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedura të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik;
- 192 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake, përfshi këtu edhe shtesat e kontratave, për plotësimin e nevojave të vitit 2019;
- 2617 Njoftime Fituesi për Blerje bileta udhëtimi Ndërkombëtare (Blerje Dinamike) ;
- 2,168 Njoftime Anullimi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit.
- 2,248 Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit në faza të ndryshme, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit.

Të detajuara këto (2248) Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2019 janë:

- 645 pezullime fillestare të procedurave të prokurimit,
- 76 vendime anulimi,
- 1527 vendime modifikimi, pezullimi të ndërmjetëm, rivlerësimi dhe lejimi.



Njoftime për Ankande Publike

- 612 Njoftime për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 146 Njoftime Fituesish për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 72 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 183 Njoftime Anullimi për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 124 Njoftime për qera.

Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat

- 6 jane Njoftime Kontratash për Procedura Koncesioni;
- 5 jane Njoftime Fituesish për Procedura Koncesioni;
- 22 Njoftime për Procedura konkurruese për dhënie leje minerare;
- 902 Njoftime të tjera.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 janë përpunuar rreth 49629 elementë të regjistrave, për parashikimin e prokurimeve, realizimin e tyre dhe ndryshimet gjatë vitit nga 1511 Autoritete Kontraktore, nga të cilat rreth **39603** elementë janë miratuar dhe publikuar në funksion të përpunimit të të dhënave dhe nxjerrjes së statistikave përkatëse.

10.2. ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK

Gjatë vitit 2019, APP ka vijuar vijuar punën për përmirësime të disa funksionaliteteve të reja për Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Qëllimi i përgjithshëm është përmirësimi i ndjeshëm performances së sistemit duke rritur kapacitetet e tij si dhe duke ngritur në një shkallë më të lartë monitorimin dhe sigurinë e tij.

Gjatë vitit 2019, janë raportuar tek kompania e mirëmbajtjes 120 raste/ kërkesa për përmirësim në funksionet dhe ndërfaqet e roleve në sistem, analizimi të dhënave, verifikime, etj.

Gjatë këtij viti është realizuar me sukses:

- Përmirësime në ndërfaqet e Rolit e Administratorit;
- Përmirësime në ndërfaqet e Rolit e Publikuesit;
- Përmirësime në ndërfaqet e Rolit të Audituesit;
- Përmirësime në ndërfaqet e Rolit e Audituesit të Autoritetit kontraktor;
- Përmirësime në Raportet që gjenerohen gjatë procesit të procedurës për rolin e njësive së prokurimit dhe KVO.
- Përmirësime në Raportin e Regjistrave të Parashikimeve dhe Realizimeve
- Përmirësimie në Raportet Njoftim Fituesi, Njoftim i Lidhjes së Kontratës, etj.
- Përmirësime në proceset e kërimit dhe shfaqjes së informacionit në portal, etj.

10.2.1. OBJEKTIVAT E SEKTORIT TË ADMINISTRIMIT TË DHËNAVE DHE STATISTIKAVE

Sektori i Administrimit të të dhënave dhe Statistikave ka punuar maksimalisht në ofrimin e shërbimeve me siguri të lartë për të gjithë Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë, Audituesit, si dhe çdo Autoritet tjetër që, në përbushje të detyrave të tij, përdor Sistemin e Prokurimit Elektronik.



Objektivat kryesore për Sektorit të Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2019 kanë qenë si më poshtë:

- Garantimi në kohë dhe me cilësi i ecurisë së punës për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE).
- Zgjidhja e problematikave të ndryshme hardware dhe software, gjatë punës së përditshme duke garantuar ecurinë normale të prokurimit elektronik.
- Përmirësimi i vazhdueshëm dhe optimizimi i ndërfaqes, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së përdoruesve.
- Garantimi i sigurisë fizike të SPE dhe SAE në ambjentet e caktuara. Në këtë kuptim, të gjitha asetet e informacionit të APP mbrohen në shkallën më të lartë nga dëmtimet fizike. Rrjeti informatik u nënsh-trohet rregullave për sigurimin fizik të informacionit, të përcaktuara në Planin e Sigurisë së rishikuar.
- Garantimi i konfidencialitetit të ofertës ekonomike duke bërë enkriptimin dhe dekriptimin çka ka bërë që Informacioni me ndjeshmëri të lartë të jetë i përdorshëm vetëm për ata persona që janë të autorizuar ta shohin ose ta përdorin atë.
- Pasurimi i portalit të APP, me informacion të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit, nëpërm-jet publikimit të 53buletinëve javorë, publikimit të legjislacionit të përditësuar, vendimeve, udhëzi-meve, raporteve, moduleve të trajnimit, monitorimeve, regjistrave të parashikimeve, realizimeve, et-j, në total janë publikuar 127 materiale (dokumenta).
- Sigurimi i back-up ditor, javor dhe mujor i Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE), si dhe ruajtja tek AKSHI.
- Garantimi i asistencës teknike për çdo kërkesë (kërkesat për dekriptim dokumentash, kërkesat për zëvendësim të anëtarëve të KVO, kërkesat për sqarim, ankesat nga ana teknike), të mbërritur në APP.
- Garantimi i asistencës teknike për punonjësit e APP-së.
- Garantimi i asistencës teknike për telefonatat dhe e-mailët e mbërritura në APP.
- Hartimi i specifikimeve teknike për kontratat që APP ka lidhur me të tretët.
- Krijimi, azhornimi, si dhe mbyllja e llogarive të administratorit për Autoritetet Kontraktore. Për vitin 2019 janë shtuar 42 Autoritete Kontraktore të reja që përdorin Sistemin e Prokurimit Elektronik.
- Krijimi, azhornimi, si dhe mbyllja e llogarive të përdoruesit për Autoritetet Kontraktore si dhe Au-dituesit.
- Krijimi, azhornimi, si dhe mbyllja e llogarive të përdoruesit për Operatorët Ekonomikë.
- Monitorimi i procedurave të prokurimit të lëna pezull në sistem dhe tërheqja e vëmendjes ndaj per-sonave përgjegjës konform legjislacionit në fuqi.
- Monitorimi i sistemit të backup në tape në mënyrë që të rritet siguria e ruatjes së të dhënave si dhe hartimi dhe zbatimi me përpikmëri i protokollit të ruatjes së tape-ve.
- Pasqyrimi i përjashtimeve të operatorëve ekonomikë në portalin e APP.
- Arkivimi i të gjitha procedurave të lëna pezull nga Autoritetet Kontraktore. Ky proces bën të mundur që sistemi operacional, në të cilin kryhen të gjitha procedurat e prokurimit publik, të lehtësohet ndjeshëm duke ulur gjithmonë e më shumë numrin e procedurave që ndodhen në të dhe, për paso-jë, duke lehtësuar punën e përdoruesve të sistemit (Autoritete Kontraktore, Operatorë Ekonomikë, Auditues).
- Garantimi i asistencës teknike për llogari audituese për çdo auditues të Autoriteteve Kontraktore si dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Zbatimi i detyrimeve në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare.
- Garantimi i trajnimeve për institucionet qendore dhe vendore në fushën e prokurimit publik në fus-hën e IT.
- Ndjekja e kontratës së mirëmbajtjes për Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe të gjithë kompo-nentëve të saj.



10.2.2. GARANTIMI I ECURISË SË PUNËS PËR TË GJITHË PËRDORUESIT E SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK (SPE) DHE SISTEMIT TË ARKIVËS ELEKTRONIKE SAE).

Spektori i Administrimit të të Dhënave dhe Statistikës është përpjekur maksimalisht, për të mbajtur “online” Sistemin e Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës, përveç rasteve kur nxjerrja e tij “offline” për një periudhë shumë të kufizuar, ka qenë e nevojshme për kryerjen e shërbimeve përkatëse, apo shtimin e funksionaliteteve të reja dhe paralajmërohet me anë të një njoftimi, pa cenuar në asnjë moment afatet e procedurave të prokurimit të shpallura në sistem.

Rezultati i punës së Drejtorisë së Teknologjisë Administrimit të të dhënave dhe Publikimit ka qenë administrimi i sigurt i një totali baze të dhënash sipas tabelës së më poshtme:

- 3.83 TB (4,211,820,720,024byte) të Sistemit të Prokurimit Elektronik,
- 5.98 TB (5,988,595,204,096 byte) të Sistemit të Arkivës Elektronike të re.
- 11.68 TB (11,684,030,087,168 byte) të Sistemit të Arkivës Elektronike të vjetër.

Tabela e kapaciteteve të bazës së të dhënave për vitin 2019:

Tabela 90

Nr.	Viti	2019
1	Sistemi i Prokurimit Elektronik (në bytes)	4,211,820,720,024
2	Arkiva Elektronike e Re (në bytes)	5,988,595,204,096
3	Arkiva Elektronike e vjetër (në bytes)	11,684,030,087,168
	Totali (në bytes)	21,884,446,011,288
	Totali (në Terabyte)	21,88

10.2.3. DHËNIA E ASISTENCËS TEKNIKE BRENDË DHE JASHTË APP

Mbështetja teknike që u jepet të gjitha autoriteteve kontraktore, si dhe të gjithë operatorëve ekonomikë të huaj dhe vendas të cilët përdorin sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet e-mail-eve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambientet e APP, është një punë e përditshme për këtë drejtori. Këtu vlen të përmendet se numri i telefonatave të marra nga drejtoria ka qenë rreth 60-70 telefonata në ditë për shkak edhe të ndryshimeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme të funksionaliteteve të sistemit.

Gjatë vitit 2019, nga Spektori i Administrimit të të Dhënave:

Janë përgatitur **2680** shkresa në total, ku përfshihen:

- Krijim/ Mbyllje llogarie në rolin CA Admin dhe Operator Ekonomik, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjendje fillestare (**1700**);
- Shkresa sqaruese me Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë (750);
- Shkresa për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera (65);
- Memo të brendshme dhe memo për bashkëpunim me Drejtoria Juridike, Verifikimit dhe Integritetit në APP (165); etj



Tabela 91

Praktikat e shqyrtuara nga Sektori i Administrimit të të Dhënave dhe Statistikës gjatë vitit 2018 sipas llojit të kërkesës	
<i>Lloji i Kërkesës</i>	<i>Numri</i>
Kërkesa për mbyllje llogarie/ ndryshim fjalëkalimi	1700
Kërkesa për asistencë teknike/sqarime	750
Shkresa për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera	65
Shkresa për arkivim dhe persona përgjegjës	165
Totali	2680

Sic shihet edhe nga të dhënat e mësipërme numrin më të lartë të shkresave të dërguara dhe të trajtuara nga Drejtoria e Administrimit të të dhënave e zënë kërkesat për krijim llogarie përdoruesi, ndryshim fjalëkalimi, të cilat kryhen nga Administratori i Menaxhimit të përdoruesve.

Tabela 92

Kërkesat për ndryshim fjalëkalimi dhe pajisje me llogari përdoruesi në SPE	
Kërkesat për Ndryshim fjalekalimi	1211
Kërkesat për Krijim llogarie perdoruesi	355
Kërkesat të tjera (bllokim llogarie, riaktivizim, etj)	134
Totali	1700

Gjithashtu, janë dërguar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit **rreth 2800** e-maile në total, drejt:

- sqarime të përgatitura nga Drejtoria Juridike, Verifikimit dhe Integritetit për autoritetet kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik);
- operatorëve ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjendjen fillestare, për sqarime, udhëzime dhe ankesa);
- sqarime të përgatitura autoriteteve kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik);
- institucioneve të tjera (për dërgim të dhënash dhe informacionesh);

Dhënia e asistencës teknike nga ky sektor është bërë edhe nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, të organizuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Shkolla e Administratës Publike, ku specialistë të IT, kanë mbuluar sesionet mbi përdorimin e Sistemit Elektronik të prokurimeve.

Bashkëpunimi i Drejtorisë së Informacionit dhe Publikimit me Drejtorinë Juridike, Integritetit dhe Verifikimit ka qenë shumë produktiv edhe për sa i përket evidentimit të rasteve problematike dhe zgjidhjen e tyre, si dhe në përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.

Një nga detyrat e përditshme të Sektorit të Administrimit të të dhënave dhe Statistikës konsiston edhe në suportin e përdoruesve brenda APP, si dhe në menaxhimin e infrastrukturës së rrjetit të brendshëm kompjuterik dhe telefonik.



10.2.4. KRIJIMI I PËRDORUESVE TË RINJ PËR VITIN 2019

Për vitin 2019 në sistemin e prokurimit elektronik janë krijuar 5940 përdorues të rinj, dhe përkatësisht:

Nga Sektori i Administrimit të të Dhënave dhe Statistikës gjatë vitit 2019 janë krijuar 42 llogari të reja në rolin “Administrator i Sistemit” për Autoritetet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Ndërsa nga llogaritë e Administratorëve të Autoriteteve Kontraktore janë krijuar në total rreth 7387 përdorues të rinj.

Në tabelën e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, brenda Autoriteteve Kontraktore, të krijuar përkatësisht në vitin 2018.

Tabela 93

Roli i Llogarisë	Llogarive të Përdoruesve të krijuar gjatë vitit 2019
Administrator i Sistemit për AK	44
Njësi Prokurimi	2643
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave	3369
Auditues i AK	398
Auditues	33

Në tabelën dhe në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, të krijuar përkatësisht në vitin 2019, sipas muajve.

Tabela 94

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer-shor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Totali	736	650	635	552	581	411	508	388	413	483	370	213

Grafiku 39



Nga figura shihet qartë krijimi i llogarive të përdoruesve në sistem është më i lartë në periudhën Janar - Maj, e cila është dhe periudha kur shpallja e procedurave të reja në sistem është më e përqendruar.



Gjithashtu, në sistem rezultojnë rreth 36315 llogari përdoruesi në rolin e njësisë së prokurimit, anëtarët të KVO, auditues etj në statusin joaktiv dhe 23947 llogari përdoruesi në rolin e njësisë së prokurimit, anëtarët të KVO, audituesit në statusin aktiv. Ndërsa në rolin e Administratorit të Sistemit për autoritetin kontraktor janë 736 në statusin joaktiv dhe 1650 në statusin Aktiv.

Tabela e mëposhtme paraqet statusin i llogarive të përdoruesve nga Autoritet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit Elektronik:

Tabela 95

Roli i Llogarisë	Llogari përdoruesi Aktive	Llogari përdoruesi joaktive
Administrator i Sistemit për AK	1650	736
Njësi Prokurimi	10275	15319
Komisioni Vlerësimit të Ofertave	12602	18390
Auditues i AK	1056	2584
Auditues i KPP	14	22

Përsa i përket, llogarive të përdoruesve në rolin e operatorëve ekonomikë, për vitin 2019 në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë regjistruar 16081 operatorë ekonomikë të rinj, nga të cilët 89 janë operatorë ekonomikë të huaj.

Pajisja e operatorëve ekonomikë me llogari përdoruesi kryhet nga APP, si dhe falë shërbimit të ndërveprimit me sistemin e Qendrës Kombëtare e Biznesit, ku automatikisht çdo operator ekonomik i regjistruar në QKB pajiset me llogari përdoruesi në SPE.

Tabela 96

Operatorët ekonomikë të regjistruar në sistem gjatë vitit 2018	
Operatorët ekonomikë të regjistruar nga QKB	15992
Operatorët ekonomikë të huaj	89
Totali	16081

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i Operatorëve Ekonomikë të rinj të Sistemit të Prokurimit Elektronik, të ardhur nga QKB, si dhe të regjistruar nga APP sipas Muajve:


Tabela 97

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer-shor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dh-jetor
Totali	1831	1469	1375	1393	1421	1320	1361	1139	1269	1505	1131	955



Grafiku 40

Regjistrimi i Operatorëve Ekonomikë në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sipas Muajve



10.2.5. STATISTIKA TË TJERA NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK

10.2.5.1. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE

Në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për vitin 2019 në total kemi 547,733,519 klikime (krahasuar me vitin 2018 kemi 7,937,350 më shumë klikime), 454,045,979 shikime të faqes së internetit (krahasuar me vitin 2018 kemi 11,745,722 shikime të faqes së internetit) si dhe 1,702,402 vizitorë (krahasuar me vitin 2017 2,351,240 vizitorë).


Tabela 98

Përdorimi i sistemit të prokurimit elektronik	2018	2019
Klikimet Total	539,796,169	547,733,519
Klikimet sipas Vizitor	539,796,169	547,023,186
Mesatarja Klikimet ne dite	1,478,893	1,500,639
Mesatarja Klikimet per Vizitor	230	321.32
Shikimet e faqes Total	442,300,257	454,045,979
Mesatarja e Shikimeve te faqes ne dite	1,211,781	1,243,961
Mesatarja e Shikimevetefaqes per Vizitor	188	266.71
Total Visitors	2,351,240	1,702,402
Mesatarja Visitors per Day	6,441	4,664
Total Unique IPs	97,576	117,811




Në grafikun e mëposhtëm paraqitet shpërndarja e klikimeve, dhe vizitorëve për vitin 2019.

Grafiku 41



Grafiku 42



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është gjatë periudhës Shkurt– Qershor dhe Tetor- Nentor.



10.2.5.2. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS 24 ORËVE.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas 24 orëve:

Tabela 99

Shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas 24 orëve			
Orët	Hits	Page View	Visitors
00:00 - 00:59	2,640,555	1,768,049	14,418
01:00 - 01:59	2,031,754	1,282,022	9,802
02:00 - 02:59	1,791,126	1,083,619	8,599
03:00 - 03:59	1,762,698	1,060,507	13,401
04:00 - 04:59	1,780,036	1,065,882	8,570
05:00 - 05:59	2,107,025	1,293,938	12,756
06:00 - 06:59	3,664,220	2,453,487	31,354
07:00 - 07:59	19,263,842	14,700,315	117,286
08:00 - 08:59	44,432,465	35,924,954	169,281
09:00 - 09:59	60,531,307	50,662,625	148,940
10:00 - 10:59	63,222,590	53,779,243	130,603
11:00 - 11:59	60,080,407	51,531,506	122,133
12:00 - 12:59	56,598,733	48,614,457	122,566
13:00 - 13:59	53,759,232	46,047,239	142,284
14:00 - 14:59	50,332,890	42,965,812	131,247
15:00 - 15:59	38,814,694	32,915,475	99,524
16:00 - 16:59	23,606,143	19,770,566	75,850
17:00 - 17:59	14,964,502	12,189,013	66,927
18:00 - 18:59	11,464,862	9,045,166	61,197
19:00 - 19:59	9,564,506	7,325,177	57,204
20:00 - 20:59	8,305,248	6,203,658	52,868
21:00 - 21:59	7,299,842	5,378,461	45,941
22:00 - 22:59	5,769,356	4,206,968	35,798
23:00 - 23:59	3,945,486	2,777,840	23,853
Total	547,733,519	454,045,979	1,702,402



Grafiku 43



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është gjatë orarit 07:00-15:00.


10.2.5.3. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS DITËVE TË JAVËS.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas ditëve të javës:

Tabela 100

Aktiviteti sipas ditëve të javës			
Ditë	Hits	Page View	Visitors
E Hënë	106,376,833	88,186,499	319,706
E Martë	102,580,996	85,583,312	303,650
E Mërkurë	101,358,122	84,822,708	293,982
E Enjte	101,481,247	84,839,205	295,230
E Premte	91,480,472	76,421,078	266,367
E Shtunë	30,235,655	24,278,724	132,687
E Diel	14,220,194	9,914,453	90,780
Total	547,733,519	454,045,979	1,702,402

Grafiku 44



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjatë javës është nga e Hëna në të Premte.




10.2.5.4. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS MUAJVE TË VITIT.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas muajve:

Tabela 101

Aktiviteti sipas Muajve të vitit			
Muaji	Hits	Page View	Visitors
Janar	44,355,245	36,584,484	136,665
Shkurt	45,602,804	37,691,958	138,387
Mars	48,509,622	40,160,361	148,944
Prill	52,500,869	43,645,625	155,211
Maj	56,247,115	46,707,941	168,386
Qershor	47,505,975	39,402,302	141,019
Korrik	46,258,454	38,421,623	142,652
Gusht	35,504,758	29,254,120	120,091
Shtator	42,373,185	35,092,080	132,616
Tetor	50,860,234	42,370,459	154,823
Nëntor	43,532,002	36,161,476	144,198
Dhjetor	34,483,256	28,553,550	119,410
Total	547,733,519	454,045,979	1,702,402

Grafiku 45



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është periudha Prill - Maj dhe më pas periudha Shtator – Nëntor.




10.2.5.5. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS NDËRFAQEVE MË TË KLIKUARA NË PORTALIN E APP.

Tabela dhe Grafikët e mëposhtëm pasqyrojnë ndërfaqet më të kërkuara në internet për aksesimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik:

Tabela 102

Ndërfaqet më të kërkuara në internet	Visitors
http://www.app.gov.al/	1,014,889
http://www.app.gov.al/e-prokurim/	167,408
http://www.app.gov.al/njoftimi-i-kontratës-së-shpallur/	94,176
http://www.app.gov.al/të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik/	82,601
http://www.app.gov.al/prokurimet-me-vlere-te-vogel/	35,443
http://www.app.gov.al/njoftimi-i-fituesit/	33,651
http://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/ligji/	29,764
http://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/udhëzime/	25,034
http://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/vkm/	20,954
http://www.app.gov.al/të-tjera/trajtime/pyetje-të-shpeshta/	19,941
http://www.app.gov.al/njoftime/njoftime-2019/	18,370
http://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/dokumentet-standarte-të-tenderit/	12,877
http://www.app.gov.al/të-tjera/kontakte/	11,716
http://www.app.gov.al/legjislacioni/koncesionetppp/ligji/	7,026
http://www.app.gov.al/njoftimi-i-lidhjes-së-kontratës/	6,743
http://www.app.gov.al/regjistri-i-realizimeve/	5,602
http://www.app.gov.al/regjistri-i-parashikimeve/	4,359
http://www.app.gov.al/arkiva/	4,119
http://www.app.gov.al/të-tjera/trajtime/pyetje-të-shpeshta/	3,120
http://www.app.gov.al/GetData/DownloadDocument/	3,001

Grafiku 46





Grafiku 47



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, interesi kryesor është ndërfaqen e logimit në sistemin e prokurimit elektronik, arkivën e buletineve të prokurimit publik, VKM, Njoftim të kontratave të shpallura etj.

10.2.5.6. AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS FJALËVE KYC MË TË PËRDORURA PËR KËRKIMIN E PORTALIT TË APP.

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyron fjalët e përdorura më shpesh për të kërkuar në internet portalin e APP dhe Sistemin e Prokurimit Elektronik:


Tabela 103

Fjalët	Numri i kerkimeve
app.gov.al	162,731
www.app.gov.al	3,838
agjencia e prokurimit publik	3,598
app	919
app.gov.al-login	855
prokurimetpublike	379
app gov al	346
app.gov.al buletini	170
prokurimepublikevkm	170
buletiniinjoftimevepublike	84
apparkiva	64
app.arkiva	62
tendera online	56
prokurimetpublikeblerjet e vogla	54
vkm	31
ligji	29
vkm 914 prokurimipublikindryshuar	22
pdfmanualiprokurimitvleretevogel	18
procedura e pershpejtuar e prokurimeve	18
njoftime per tendera	11




Grafiku 48

Search Phrases



Grafiku 49



10.2.5.7. AKSESIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK SIPAS SHFLETUESVE DHE SISTEMEVE OPERATIVE.

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyron aksesimin e Sistemit e Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve të kërkimit:

Tabela 104


Most Used Browsers

	Browser	Hits	Visitors	% of Total Visitors
1	Google Chrome	407,853,123	1,770,051	70.26%
2	Firefox	54,518,758	210,655	8.36%
3	Mobile Safari	5,380,812	149,932	5.95%
4	Internet Explorer	33,089,330	135,480	5.38%
5	MobileSafari/604.1 CFNetwork/897.15 Darwin/17.5.0	59,679	59,643	2.37%
6	Microsoft Edge	14,159,552	48,989	1.94%
7	Others	3,493,362	20,399	0.81%
8	Opera	3,021,294	16,451	0.65%
9	Safari	853,587	13,322	0.53%
10	Android Browser	23,258	4,328	0.17%



Sic shihet nga të dhënat e mësipërme Sistemi i Prokurimit Elektronik, aksesohet dhe funksionon normalisht nga të gjitha llojet e shfletueve si GoogleChrome, MozillaFirefox, etj. Gjithashtu, vërehet se Google-Chrome mbetet shfletuesi më i përdorur për aksesimin e sistemit të prokurimit.


Grafiku 50



Grafiku 51

IE and Edge Versions

Daily Internet Explorer and Microsoft Edge Versions






10.2.5.8. AKSESIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK SIPAS SISTEMEVE OPERATIVE DHE LLOJIT TË PAJSJEVEMË TË PËRDORURA NGA PËRDORUESIT

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyron aksesimin Sistemit e Prokurimit Elektronik sipas sistemeve operative të përdorura nga përdoruesit:

Tabela 105

	Operating System	Hits	Visitors	% of Total Visitors
1	Windows 7	319,053,605	652,579	38.33%
2	Windows 10	154,776,276	346,953	20.38%
3	Android OS	14,549,564	344,193	20.22%
4	iPhone	7,884,790	182,589	10.73%
5	Others	50,758,950	176,087	10.34%
	Totali	547,023,185	1,702,401	100.00%

Grafiku 52



Grafiku 53






Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyrojnë aksesimin Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas llojeve të pajisjeve të përdorura nga përdoruesit:


Tabela 106

	Device Type	Hits	Visitors	% of Total Visitors
1	Desktop	524,435,592	1,172,423	68.87%
2	Mobile	21,675,796	505,777	29.71%
3	Tablet	911,798	24,202	1.42%
	Total	547,023,186	1,702,402	100.00%

Grafiku 54


Device Types

Daily Device Types



Grafiku 55

Device Types





Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, si rezultat i përmirësimeve të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është bërë e mundur aksesimi dhe funksionimi normal i të gjithave ndërfaqeve edhe nga pajisjet mobile me sistem iOS dhe Android.

10.2.5.9. PËRDORIMI I APLIKACIONIT MOBILE

Përdorimi i aplikacionit mobile për platformat kryesore iOS dhe Android dhe mundësimi i ofertimit për procedurat me blerje të vogël me anë të tij për operatorët ekonomikë, rezulton se është rritur gjatë vitit 2018.

Konkretisht, më poshtë është pasqyruar Aktiviteti i përdoruesve të aplikacionit sipas muajve.

Grafiku 56



Sikurse rezulton, nga grafiku i mësipërm periudha ku gjen përdorim më të madh aplikacioni është Prill - Maj dhe Tetor- Dhjetor, pasi gjatë kësaj këtyre 2 periudhave kohe autoritetet kontraktore shpallin më së shumti procedura prokurimi me vlerë të vogël.



11. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS

11.1. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

APP e ka ushtruar aktivitetin e saj ligjor me 3 (tre) drejtori dhe 1 (një) sektor në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm.

Gjatë vitit 2019, struktura dhe organika e APP-së ka ndryshuar 1(një) herë, konkretisht: Me Urdhrin Nr. 54, datë 15.03.2019 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, u miratua struktura dhe organika e re e APP e përbërë nga 3(tre) drejtori dhe 1 (një) sektor në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm, përkatësisht:

1. Drejtoria Juridike, e Verifikimit dhe Integritetit me 3 (tre) sektorë: Sektori Juridik, Sektori i Verifikimit të Procedurave dhe Sektori Integritetit,
2. Drejtoria e Koordinimit me 2 (dy) sektorë : Sektori i Koordinimit dhe Sektori i Monitorimit të Kontratave,
3. Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit me 2 (dy) sektorë: Sektori i Administrimit të të Dhënave dhe Statistikës dhe Sektori i Publikimit, si dhe
4. Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore.

Numri total i punonjësve të miratuar sipas strukturës së mësipërme është 44, nga të cilët 40 janë nëpunës civilë.

Njëkohësisht, me VKM nr.16, datë 16.01.2019, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore”, u miratuan 8 punonjës arkive (6 orë/në ditë), dhe në fund të muajin korrik u punësuan 4 praktikantë të nivelit specialist kategoria IV-b, sipas VKM Nr. 277, datë 16.05.2018 “Për ndryshim të VKM Nr. 395, datë 29.04.2015 për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike” i ndryshuar.

11.2. AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR KONFLIKTIN E INTERESIT

Autoriteti Përgjegjës Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në institucion, ka mbajtur korrespondencë në mënyrë korrekte me Inspektoriatin e Lartë Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dhe ka raportuar emrat e personave përgjegjës të cilët janë subjekt për deklarimin e pasurive dhe interesave private në institucion.

Gjatë këtij viti, APP në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga Ligji “ Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe nëpunësve publik”, ka depozituar sipas afateve ligjore, Deklarimin e Interesave Private Periodik/Vjetor dhe Deklarimin e Interesave Para fillimit në Detyrë sipas legjislacionit në fuqi.

11.3. KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Akresi në informacionin që prodhohet apo mbahet nga autoritetet publike është i një rëndësie thelbësore dhe ka për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individëve në praktikë. Me miratimin e Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, APP ka pasur një numër të konsiderueshëm kërkesash për informacion.

Në funksion të informimit të publikut, APP u ka kthyer përgjigje, brenda afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kërkesave të shumta për informacion të qytetarëve në formë të shkruar ose në formë elektronike, në varësi të përzgjedhjes që kanë bërë këta të fundit. Gjatë vitit 2019, janë trajtuar dhe u është përcjellë informacioni i kërkuar 19 kërkesave drejtuar koordinаторit për të drejtën e informimit, elektronikisht apo në rrugë shkesore. Në një vështrim krahasimor, rezulton të ketë një ulje të numrit të kërkesave për të drejtën e informimit, pasi gjatë vitit 2018, APP ka marrë në shqyrtim 27 kërkesa.



Pjesa më e madhe e kërkesave për të drejtën e informimit të paraqitura pranë APP, kanë qenë të iniciuara nga qytetarët, por vihet re një rritje e numrit të kërkesave të paraqitura nga OJF dhe media. Konkretisht, nga 19 kërkesa të paraqitura pranë APP për periudhën Janar-Dhjetor 2019, 6 janë kërkesa të paraqitura nga individë, 8 kërkesa janë paraqitur nga media apo gazetarë, si dhe 5 kërkesa janë depozituar nga OJF. Kërkesa e vazhdueshme për informacion është një tregues pozitiv, që ka të bëjë me ndërgjegjësimin lidhur me efektivitetin e ligjit për të drejtën e informimit.

Gjatë vitit 2019, nuk rezulton t'i jetë kufizuar apo refuzuar dhënia e informacionit ndonjë subjekti të caktuar.

Në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", APP mban dhe bën publik Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen zyrtare të APP.

Gjithashtu, me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.145, datë 13.03.2018 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit" është miratuar krijimi i Regjistrit Qëndror të Kërkesave dhe Përgjigjeve. Ky regjistër është instaluar dhe në APP.

Në mbështetje të transparencës, me qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion publik, APP ka vijuar punën për përmirësimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave për të drejtën e informimit duke bërë të mundur që informacioni i kërkuar, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë subjektet e interesuar.

11.4. AKTIVITETET NË DREJTIM TË FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË STAFIT TË APP DHE SPECIALISTËVE TË PROKURIMIT PUBLIK PRANË AUTORITETEVE KONTRAKTORE

11.4.1. PJESËMARRJA NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2019 përfaqësues të APP kanë marrë pjesë në një sërë takimesh dhe seminaresh të organizuar brenda dhe jashtë vendit dhe konkretisht si më poshtë:

- Në muajin janar 2019 përfaqësues të APP kanë marrë pjesë në Konferencën me temë: "Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore në zinxhirin e furnizimeve për prokurimit publik", të zhvilluar nga data 30.01.2019-31.01.2019 në Athinë, Greqi.
- Në muajin shkurt 2019, përfaqësues të APP morën pjesë në me rastin e vizitës studimore, që Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Asistencën Teknike (FP), zhvilloi në kuadër të Rishikimit dhe vlerësimit Afatmesëm të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) nga data 17.02.2019-03.03.2019 në Dublin, Irlandë.
- Në muajin prill 2019, përfaqësues të APP kanë marrë pjesë në Forumin e 15 mbi Prokurimin (PRIMO), nga data 10.04.2019-13.04.2019 në Tashkent, Uzbekistan.
- Në muajin maj 2019, përfaqësues të APP morën pjesë në konferencën "Eksperienca e Rumanisë dhe vendeve të tjera anëtare në Përafrimin e acquis-communautaire në fushën e prokurimit publik" të organizuar nga data 20.05.2019-22.05.2019 në Bukuresht, Rumani.
- Në muajin qershor 2019 përfaqësues të APP morën pjesë në Konferencën Rajonale për Vendet Europiane dhe të Azisë Qendrore dedikuar ngritjes së institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse, organizuar nga Banka Botërore, nga data 11.06.2019-12.06.2019 në Ankara, Turqi.
- Në muajin shtator 2019, përfaqësues të APP morën pjesë në kuadër të takimit shpjegues për procesin screening për Kapitullin 30: Marrëdhëniet me jashtë të organizuar nga data 24.09.2019-26.09.2019 në Bruksel, Belgjikë.
- Në muajin Nëntor 2019, përfaqësues të APP morën pjesë në Trajnimin e Prokurimit Publik në kuadër të programit Matra Rule of Law mbështetur nga qeveria Hollandeze, në datat 6 – 15 Nëntor 2019, në Hague, Hollandë.



- Në muajin dhjetor 2019, përfaqësues të APP morën pjesë në kuadër të Sesionit të Tretë të Grupit të Punës për Partneritetin Publik-Privat të komisionit Ekonomik për Europën e Kombeve të Bashkuara (UNECE) të organizuar nga data 03.12.2019-04.12.2019 në Gjenevë, Zvicër.

11.4.2. TRAJNIMET E PUNONJËSVE TË PROKURIMEVE PRANË AUTORITETEVE KONTRAKTORE

Agjencia e Prokurimit Publik, në ushtrim të detyrave të saj sipas parashikimeve të nenit 13, pika 2, germa “b” dhe “d” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, mbart detyrimin ligjor për nxitjen, organizimin dhe kualifikimin e punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në veprimtarinë e prokurimit publik ka organizuar disa sesione trajnimi.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me qëllim rritjen profesionale dhe kualifikimin e personave përgjegjës për prokurimet pranë Autoriteteve Kontraktore në fushën e prokurimit publik, janë organizuar trajnime të ndryshme mbi prokurimin të ndarë sipas niveleve të njohurive (bazik, mesatar, i avancuar).

Ndarja e moduleve të trajnimit sipas nivelit të njohurive krojon mundësinë për personat e përfshirë në procedurat e prokurimit që të thellojnë njohuritë e tyre në këtë fushë gradualisht dhe përbën një bazë të rëndësishme për krijimin e një databaze mbi profesionistët e prokurimit publik në Shqipëri.

Tabela 107

Trajnime Prokurimi Publik			Numri i Autoriteteve Kontraktore			Numri i Pjesëmarrësve		Numri i të Certifikuarve
Moduli	Kohëzgjatja në ditë	Numri i Trajnimeve	Qendror	Vendor	Pavarur	Meshkuj	Femra	
Niveli bazë	3	6	39	2	19	55	125	168
Niveli bazë	2	1	10	4	0	10	10	20
Niveli Mesatar	5	9	49	12	18	60	156	179
Niveli i Avancuar	3	4	8	9	5	46	64	81
		20	106	27	42	171	355	
Totali	20		175			526		448

Sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2019 janë zhvilluar **20 trajnime** në total nga të cilat 7 për nivelin bazë, 9 nivel mesatar dhe 4 nivel i avancuar.

Sa i takon pjesëmarrjes në total kanë marrë pjesë **526 persona** punonjës prokurimi në **175 autoritete kontraktore** (106 institucione qendrore, 27 institucione vendore dhe 42 institucione të pavarura).

Nga këta janë pajisur me certifikatën përkatëse 448 persona.

**11.5. GJENDJA FINANCIARE E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2019**

Institucioni I Agjencisë së Prokurimit Publik aktivitetin financiar për vitin 2019 e ka zhvilluar në bazë të Ligjit nr .99/2018“Për buxhetin e vitit 2019”. Situata buxhetore për periudhën Janar – Dhjetor 2019, paraqitet si vijon:

Tabela 108

Nr	Artiku- jt	Plani vjetor	Plani 12/ mujor	Fakti 12/ mujor	Mosreal- izimi si 12/mujor	Realizimi si 12/ mujor %	Numri i punonjeseve	
							plan	fakt
1	600	41 150 000	41 150 000	36 767 720	4 382 280	89.4		
2	601	6 350 000	6 350 000	5 997 944	352 056	94		
3	602	34 350 000	34 350 000	32 168 591	2 181 409	93.7		
4	606	85 000	85 000	70 000	15 000	82.3		
5	231	3 000 000	3 000 000	1 745 880	1 254 120	58.2		
	Totali	84 935 000	84 935 000	76 750 135	8 184 865	90.4	44	41

Nisur nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se për vitin 2019 realizimi i shpenzimeve në total është **76 750 135** lekë, nga **84 935 000** lekë të planifikuara ose **90.4%**. Pra kemi një mosrealizim të planit vjetor në shumën **8 184 865** lekë ose **9.6%**

600-601 Artikulli “Paga dhe sigurime shoqërore”

Në zërin paga dhe sigurime shoqërore për artikullin 600, realizimi i planit vjetor është **36 767 720** lekë nga **41 150 000** lekë të planifikuara ose **89.4%** me një mosrealizim prej **4 382 280** lekë ose **10.6%**, dhe për artikullin 601 realizimi është **5 997 944** lekë nga **6 350 000** lekë të planifikuara ose **94%**, me një mosrealizim prej **352 056** lekë ose **0.6%**.

Mosrealizimi i planit në zërin paga dhe sigurime shoqërore ka ardhur si rrjedhojë e vakancave të krijuara nga mosplotësimi i organikës me punonjës të rinj për shkak të afateve në procedurat e pranimit nga DAP.

602- Artikulli “Shpenzime për mallra e shërbime

Në zërin “Shpenzime për mallra e shërbime” realizimi i planit vjetor është **32 168 591** lekë nga **34 350 000** lekë të planifikuar ose **93.7%**, me mosrealizim prej **2 181 409** lekë ose **6.3%**.

Në përgjithësi u realizuan të gjithë zërat e shpenzimeve për mallra e shërbime të planifikuar për vitin 2019 me përjashtim të shpenzimeve për materiale pastrimi dhe ndricimi për të cilat procedura e nisur nuk u përfundua për shkak të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.21920prot., datë 2.12.2019 “Mbi prioritetet e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore” sipas pikës 2, “Autoritetet kontraktore ndalohen menjëherë të nënshkruajnë kontrata të reja që janë në proces prokurimi apo të ndërmarin procedura të reja prokurimi me fondet publike”. Një peshë të madhe në shpenzimet operative për vitin 2019 e zë shpenzimi për mirembajtjen e sistemit të prokurimit elektronik në shumën **28,095,335** lekë ose **87.33%** kontratë e cila për vitin 2019 u realizua **100%**.

231- Artikulli “Shpenzimet kapitale”

Buxheti i çelur, në fillim të vitit 2019 është **1 000 000** lekë për blerje pajisje kompjuterike dhe orendi zyre. Me Aktin Normativ Nr. 2 datë 02.10.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u miratuan **2 000 000** lekë për blerje pajisje kompjuterike dhe orendi zyre. Për rrjedhojë, fondi i miratuar për këtë zë shpenzimi u bë **3 000 000** lekë.



Realizimi planit për investime për vitin 2019 është 1 745 880 lekë ose 58.2% kundrejt planit të çelur, me një mosrealizim prej 1 254 120 lekë ose 41.8%.

Gjatë vitit 2019 ky fond u përdor; **1 590 600** lekë për blerjen e pajisjeve kompjuterike dhe **155 290** lekë për blerjen e pajisjeve të zyrave.

Mosrealizimi i fondit të planifikuar në këtë zë ka ardhur si rrjedhojë e gjëndjes së emergjencës të shpallur nga fatkeqesia natyrore. Për këtë arsye procedura e prokurimit e nisur për blerjen e orendive dhe pajisjeve të zyrës nuk u realizuar për vitin 2019.

Bazuar në treguesit e realizimit të buxhetit, mund të vëmë re se situata ekonomike gjatë vitit 2019, për institucionin tonë ka qenë e favorshme. Në përgjithësi të gjithë zërat e buxhetit janë realizuar duke bërë që puna të vijojë më me efektshmëri dhe duke plotësuar nevojat e punonjësve për një mjedis të përshtatshëm pune.

606-Artikulli “Shperblime personeli”

Me ligjin e Buxhetit 99/2018 “Per Buxhetin e vitit 2019” u çelën **85 000** lekë për përdorimin e fondit të veçantë. Bazuar në VKM Nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, fond i veçantë u përdor për shpërblim me rastim e daljes në pension pleqërie të specialistes së financës.



12. PRIORITETET E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2020

Natyrë dinamike e prokurimit publik kërkon angazhimin e vazhdueshëm për garantimin e mirëfunksionimit të procesit në respektim të parimi të transparencës dhe garantimit të konkurrencës.

Në këtë kuptim, APP në rolin e institucionit kryesor për përcaktimin dhe ndjekjen e reformave kryesore në këtë fushë, mbetet e angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të prokurimit në Shqipëri nëpërmjet objektivave të mwposhtëm:

I. Miratimi i ligjit të ri të prokurimit publik;

Gjatë vitit 2019 APP ka punuar intensivisht për hartimin e projektligjit të ri të prokurimit publik, i cili transponon direktivat europiane në këtë fushë, konkretisht, Direktiva 2014/24/EU, Direktiva 2014/25/EU dhe direktivat mbi sistemin e rishikimit.

Ligji i ri synon të përmirësojë ndjeshëm sistemin e prokurimit në Shqipëri nëpërmjet përmirësimit dhe plotësimit të mangësive të evidentuara në dispozitat ekzistuese dhe futjes së parashikimeve të reja për të plotësuar boshllëqet ligjore të evidentuara deri tani.

II. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik;

Me qëllim përmirësimin e Sistemit të Prokurimit në Shqipëri APP, gjatë vitit 2019, ka punuar intensivisht në bashkëpunim me SIGMA/OECD për përgatitjen e një Strategjie Kombëtare për Prokurimin Publik, duke përfshirë të gjitha fushat që lidhen me prokurimet siç janë prokurimet klasike, prokurimet në sektorët utilitarë, koncesionet dhe PPP-të, prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, prokurimi elektronik dhe rishikimi administrativ.

Miratimi i një strategjie të dedikuar për prokurimin publik në Shqipëri pritet të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e të gjithë sistemit në tërësi duke përcaktuar objektiva të qarta dhe të dedikuara për të gjitha aspektet e prokurimit.

III. Hartimi akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për implelementimin e dispozitave të tij;

Në vijim të miratimit të ligjit të ri për prokurimin, me qëllim impelmentimin e tij, është e nevojshme të hartohen dhe të miratohen një sërë aktesh nënligjore të cilat do të detajojnë më tej dispozitat e ligjit dhe do të orientojnë të gjitha subjektet zbatuese të tij në implementimin e duhur të tyre.

IV. Profesionalizimi i prokurimit publik

Profesionalizmi i prokurimit është një nga objektivat kryesore të përfshira edhe në Strategjinë e Prokurimit Publik nëpërmjet të cilit synohet përmirësimi i procedurave të prokurimit dhe njëkohësisht rritja e përgjegjshmërisë së personave të përfshirë në procesin e prokurimit. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2020 synohet të finalizohet një guidë e detajuar për profesionalizimin si edhe hartimi i planit të trajnimit dhe kurrikulave përkatëse për punonjësit e prokurimit, në bashkëpunim me zyrën e OSBE në Tiranë.

V. Ngritja e mekanizmave për monitorimin e zbatimit të kontratave

Projektligji i ri parashikon për herë të parë ngritjen e mekanizmave të posaçëm për monitorimin e zbatimit të kontratave me qëllim përmbushjen e të gjitha parashikimeve të tyre dhe garantimin e shpenzimit efektiv të fondeve publik. Në këtë kuadër, projektligji i ri parashikon gjithashtu edhe rritjen e rolit të APP në këtë drejtim.

Për sa më sipër, gjatë vitit 2020, APP do të fokusohet në hartimin e mjeteve dhe mekanizmave të nevojshëm monitorues për të lehtësuar edhe punën e AK-ve gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave.



VI. Përmirësime në kuadër rritjes së transparencës dhe vënien në dispozicion të interesuarve (OpenData), duke mundësuar shkarkimin nga portali të raporteve në lidhje me elementët e regjistrit të parashikimeve të procedurave publike apo mbi publikimet e njoftimeve të kontratave, etj.

VII. Përmirësime të sistemit të prokurimit elektronik mbi deklarin e bashkimit të operatorëve ekonomik në sistem apo nenkontraktimin.

VIII. Finalizimi i zhvillimeve të nevojshme për integrimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik me sistemin e AFMIS.

IX. Analizimi i të dhënave dhe kryerja e studimeve të ndryshme për përmirësime të tjera në sistemit elektronik të prokurimit në përputhje me gjetjet dhe risitë e sjella nga ndryshimi i kuadrit ligjor.